



NATIONAL ALBANIAN CENTER FOR SOCIAL STUDIES

**Vlerësim i shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijës dhe i
institucioneve për fëmijët pa kujdes prindëror
(Raport studimor i financuar nga UNICEF, Shqipëri)**

tetor 2005

**...Me qëllim zhvillimin e plotë dhe harmonik të personalitetit të vet, fëmija duhet të
rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi...**

Hyrje në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MPCSSHB**



NATIONAL ALBANIAN CENTER FOR SOCIAL STUDIES
Mailing Address: Str. "Sulejman Delvina", Pall. 8, Shk.1, Ap. 3, Tirane, Albania
Tel: ++ 355 4 26 16 46 ; Fax: ++ 355 4 2616 46

Përmbajtja

Falënderime

Shkurtime

I. Përmbledhje ekzekutive

II. Sfondi i studimit, objektivat dhe metodologjia

- II.1. Sfondi dhe qëllimi i studimit
- II.2. Objektivat dhe metodologjia e studimit
- II.3 Treguesit dhe instrumentatat
- II.3 Kufizimet e studimit
- II.4 Rezultatet e studimit
- II. 5 Përkufizimet e përdorura

Kapitulli i parë. Harta e institucioneve publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime shoqërore për fëmijët jashtë kujdesit prindëror në Shqipëri.

- 1.1 Përshkrim i shkurtër i gjendjes së fëmijëve pa kujdes prindëror
- 1.2 Institucionet rezidenciale publike dhe kategoritë e fëmijëve që vendosen në to
- 1.3 Institucionet rezidenciale jopublike
- 1.4 Çinstitucionalizimi
- 1.5 Harta e institucioneve të kujdesit social për fëmijë pa kujdes prindëror.

Kapitulli i dytë. Kuadri aktual ligjor dhe politik dhe sistemi i menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit

- 2.1 Kuadri politik dhe ligjor që sanksionon të drejtat e fëmijëve në Shqipëri
- 2.2 Kuadri ligjor që sanksionon mbrojtjen sociale të fëmijëve në Shqipëri.
- 2.3 Komente mbi legjislacionin ekzistues
- 2.4 Drejtime prioritare për përmirësime në legjislacion
- 2.5 Financimi, menaxhimi, administrimi dhe kryerja e shërbimeve të kujdesit social
- 2.6 Programet ekzistuese dhe shërbimet që realizohen
- 2.6.1 Programi i mbrojtjes, mbështetjes dhe integritetit të fëmijëve me aftësi të kufizuara
- 2.6.2 Mbrojtja, përkrahja dhe integrimi shoqëror i fëmijëve me probleme sociale ...
- 2.7 Monitorimi dhe Vlerësimi i Shërbimeve ...
- 2.7.1 Procesi i monitorimit dhe i vlerësimit
- 2.8 Çështje kritike lidhur me thelbin dhe zbatimin e programeve të shërbimeve sociale
- 2.9 Rekomadime mbi të ardhmen e sistemit të kujdesit për fëmijë pa kujdes prindëror

Kapitulli i tretë. Vlerësimi i standardeve dhe i cilësisë së shërbimeve që ofrohen nën programet e kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror

- 3.1 Shërbimet e kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror
- 3.1.1 Birësimi
- 3.1.2 Shtëpitë familjare
- 3.1.3 Kujdesi tutorial (foster care)
- 3.1.4 Institucionet rezidenciale
- 3.2 Standardet e institucioneve rezidenciale të kujdesit social.....

3.2.1 Kushtet fizike	
3.2.2 Shëndeti, ushqimi dhe edukimi	
3.2.3 Burimet e financimit dhe kostoja për fëmijë.	
3.2.4 Personeli dhe ofruesit e shërbimeve	
3.2.5 Pranimi	
3.2.6 Rrugët e largimit të fëmijëve nga institucionet rezidenciale të kujdesit social	
3.3 Kujdesi tutorial për fëmijët pa kujdes prindëror	
3.3.1 Kujdesi për foshnjat e braktisura në maternitetet e Tiranës dhe Shkodrës	
3.3.2 Qendrat të kujdesit ditor për fëmijë të shpërfillur.....	
3.3.3. Riatdhesimi i fëmijëve të pashoqëruar nga prindërit	
3.4 Përfundime	
3.5 Rekomandime	

Kapitulli i katert. Problematika të zhvillimit psikosocial të fëmijëve pa kujdes prindëror

4.1 Karakteri i ndryshuar i institucioneve të kujdesit social për fëmijë	
4.2 Raste të mosrespektit/keqtrajtimit/shfrytëzimit të fëmijëve në institucione ...	
4.3 Natyra e sistemit të institucioneve rezidenciale	
4.4 Ndikimi/mosndikimi i sistemit institucional mbi fëmijën	
4.5 Administrimi i ankesave	
4.6 Profili i personelit dhe zhvillimi profesional.....	
4.7. Monitorimi, hetimi dhe raportimi i trajtimit të fëmijëve	
4.8. Puna me fëmijët mbi bazën e planeve të zhvilluara individualisht	
4.9 Të drejtat e fëmijëve të institucionalizuar dhe të drejtat e fëmijëve të tjerë	
4.10 Kërkimet për kujdes alternativ për fëmijët në institucione ...	
4.11 Marrëdhëniet midis institucioneve, fëmijëve në institucione dhe familjeve/komuniteteve të tyre...	
4.12 Burimet materiale për nxitjen e zhvillimit të fëmijëve	

Shkurtime

BB	Banka Botërore
HIV/AIDS	Virusi i Pamjaftueshmërisë së Imunitetit Njerëzor (SIDA)
INSTAT	Instituti Kombëtar i Statistikave
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
KQ	Këshilli i Qarkut
KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimit
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MF	Ministria e Financave
MPÇSShB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MB	Ministria e Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJF	Organizatë jofitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
QKShSS	Qendra Kombëtare Shqiptare për Studime Sociale
QZH	Qendra e Zhvillimit Human
QSH	Qeveria Shqiptare
SKZHES	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik e Social
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Falënderime

Autorët ja dedikojnë këtë raport fëmijëve shqiptarë jashtë kujdesit prindëror dhe shërbimeve në ndihmë të tyre. Shumë ofrues shërbimesh kanë kontribuar në kryerjen e këtij studimi; me ndihmë gjatë hartimit të pyetësorëve, me pjesëmarrje në debate përgjatë mbledhjes së të dhënave dhe analizës së tyre; me ofrimin e komenteve në procesin e hartimit të raportit.

Shumë specialistë dhe organizata kanë kontribuar në realizimin e këtij studimi. Falenderime shkojnë për Qendrën Kombëtare Shqiptare për Studime Sociale (QKShSS) dhe Qendrën për Zhvillim Human (QZhH), të cilat mundësuan organizimin dhe realizimin e studimit.

Një falenderim i veçantë i bëhet znj. Genta Sulo, Asistente e Programit të Mbrojtjes së Fëmijëve, pranë UNICEF, lidhur me sugjerimet dhe ndihmën e dhënë. Falenderim i veçantë shkon edhe për znj. Natasha Hodaj, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror dhe z. Sadedin Mezuraj, ekspert pranë këtij institucioni, për pjesëmarrjen energjike dhe ko-ordinimin e punës në terren. Falenderohen gjithashtu të gjithë zyrtarët e nëpunësit e qeverisë qendrore dhe qeverive vendore, të cilët mbështetën nevojat e këtij studimi.

Shumë profesionistë punuan për përgatitjen e kuadrit konceptual që udhëhoqi këtë studim, në hartimin e metodologjisë, në analizën e të dhënave dhe shkruarjen e raportit. Prof. Dr. Dhori Karaj, Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale pranë Universitetit të Tiranës, Prof. Dr. Adem Tamo, pedagog në Fakultetin e Shkencave Sociale pranë Universitetit të Tiranës dhe Dr. Vali Bizhga, eksperte për fëmijërinë e herëshme, ofruan një ndihmë të çmuar në çështje kritike që lidhen me zhvillimin psikosocial të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror dhe të ndikimit të mungesës së prindërve në zhvillimin njohës të tyre. Mirela Muca, drejtor ekzekutiv i QKSHSS, ka kontribuar në vlerësimin e standarteve dhe të cilësisë së shërbimeve ekzistuese të përkujdesjes. Vilma Kolpeja, eksperte e studimeve sociale, pranë QKShSS ka ofruar ekspertizën e saj në hartimin e hartës së strukturave publike dhe jo-publike të përkujdesit shoqëror për fëmijë në Shqipëri dhe identifikimin e problemeve kritike me të cilat përballen ata. Irena Dona, eksperte e politikave sociale pranë QKShSS, kontribuoi në përshkrimin e kuadrit ligjor dhe atë institucional të shërbimeve për fëmijët jashtë kujdesit prindëror.

Një falenderim i veçantë u shkon znj. Pranvera Xhelo dhe znj. Natasha Pepivani jo vetëm për përkëthimin dhe editimin profesional, por edhe për ndihmën e ofruar gjatë hartimit të variantit final të studimit.

Në fund, shpresojmë që rekomandimet e dhëna nga ky studim, të merren në konsideratë dhe të mundësojnë realizimin e të drejtave bazë edhe për fëmijët jashtë kujdesit prindëror.

I. Përmbledhje ekzekutive

Ky studim ka për qëllim të identifikojë çështjet më kritike që kanë të bëjnë me sistemin social të mbrojtjes së fëmijës, me synimin që të hartohen rekomandime të efektshme për të ngritur një kuadër ligjor e institucional i cili do të siguronte ndërthurjen shoqërore të fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror. Studimi i vë vetes veçanërisht pesë objektiva:

- Të identifikojë institucionet rezidenciale të kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror si dhe modelet e tyre të përkujdesjes;
- të përshkruajë politikat dhe kuadrin ligjor që trajtojnë fëmijët pa kujdes prindëror;
- të përshkruajë dhe vlerësojë standardet e shërbimit social dhe cilësinë në institucionet e kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror;
- të vlerësojë zhvillimin psikosocial të fëmijëve që jetojnë në institucionet rezidenciale të kujdesit social si dhe
- të bëjë rekomandime lidhur me të ardhmen e sistemit të kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror.

Katër objektivat e parë trajtohen secili në një kapitull më vete, të plotësuar me gjetjet kryesore; ndërsa rekomandimet janë shpërndarë nëpër këto kapituj si të jetë rasti më i përshtatshëm.

Kapitulli 1 (Institucionet). Te dhënia e shërbimeve të kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror në Shqipëri) analizohet gjendja e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror, duke përfshirë problemet më kritike me të cilat përballen ata. Aty përshkruhen si institucionet rezidenciale të kujdesit publik ashtu edhe ato jo publike, po kështu dhe kategoritë e fëmijëve që kanë të drejtë të jetojnë aty. Një kujdes i veçantë i kushtohet ndikimit që ka mbi integrimin social të fëmijës çinstitucionalizimi, kthimi në familjen biologjike dhe birësimi.

Gjetjet kryesore janë:

a) Ka afërsisht 1200 fëmijë të privuar nga kujdesi prindëror të cilët ndodhen në një formë a ndonjë tjetër nën përkujdesje rezidenciale. Ndër këta 70 për qind janë në institucione rezidenciale që drejtohen ose nga sektori publik ose nga OJQ, ndërsa pjesa tjetër janë shtëpi familiare ose qendra të kujdesit ditor të drejtuara nga OJQ. Në krahasim me vende të tjera të rajonit përpjestimi i fëmijëve që jetojnë në institucionet rezidenciale të kujdesit social në Shqipëri është i ulët. Arsyet janë që një numër shërbimesh jepen nga sistemi joformal i kujdesit social; që kapacitetet e modeleve formale të kujdesit social janë të kufizuara; dhe që tradita familjare është ende mjaft e fortë.

b) 60 për qind e fëmijëve në institucionet e kujdesit social janë lënë aty nga familjet e tyre për arsye varfërie ose problemesh të tjera sociale. 35 për qind të tjerë fëmijë janë braktisur pas lindjes. Një faktor me rëndësi në vitet e fundit ka qënë emigracioni i detyruar nga varfëria i cili ka shpënë në rritje të shkurorëzimeve, shpërbërje të familjes dhe krijim të familjeve me një prind.

c) Dy rrugët mes të cilave fëmijët mund të largohen nga kujdesi në këto institucione për të jetuar në familje janë ose kthimi në familjen biologjike ose birësimi; kujdesi tutorial është shumë i pazakontë. Çdo vit rreth 30 deri 40 fëmijë largohen nga institucionet rezidenciale publike për t'u kthyer në familjet e tyre, ndërsa në gjithë vendin birësohen afërsisht 50 deri 70 fëmijë në vit. Pak a shumë gjysma e fëmijëve të birësuar janë katër e më shumë vjeç dhe kanë paaftësi të theksuara ose probleme mjekësore; të gjithë këta fëmijë janë birësuar jashtë shtetit.

d) Megjithë legjislacionin në fuqi dhe të drejtat ligjore të fëmijëve pa kujdes prindëror të cilët studiojnë në shkollë të mesme ose dhe të lartë (e drejta për strehim e për punë, nëse është mbushur mosha), ata jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe sociale. 3 për qind e këtyre fëmijëve që përfundojnë shkollën e mesme shkojnë në universitet, ndërkohë që thuajse të gjithë vazhdojnë të jetojnë në konvikte.

Kapitulli 2 (Kuatrri aktual ligjor e politik dhe sistemi i menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit) trajton kuadrin ligjor shqiptar dhe politikën që kërkon zbatimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre shoqërore. Ai shqyrton gjithashtu menaxhimin dhe financimin e shërbimeve të kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror, po ashtu edhe mekanizmat monitoruese dhe vlerësuese. Gjetjet kryesore këtu janë:

- Kuadrin ligjor është rishikuar tërësisht në dhjetë-pesëmbëdhjetë vitet e fundit duke u bërë, si përfundim, relativisht gjithëpërfshirës e i përputhur me standardet ndërkombëtare. Sfidat më të mëdha janë forcimi i aftësive institucionale për zbatimin e tij; forcimi i pushtetit vendor e qëndror për të identifikuar dhe referuar rastet e fëmijëve në rrezik apo në nevojë; decentralizimi i shërbimeve në mënyrë që ato t'u afrohen sa më shumë nevojtarëve si dhe zotërimi i një vështrimi të përgjithshëm dhe raportimi mbi zbatimin.
- Ka ende disa zbrazëti në kuadrin ligjor. Legjislacioni aktual nuk përkufizon sidomos jetesën e pranueshme minimale dhe standardet e edukimit për fëmijët; klasifikimi i paaftësisë nuk është përcaktuar mirë, ndërkohë që legjislacioni vazhdon ta shohë paaftësinë në një perspektivë thjesht e ngushtësisht mjekësore, pa përfillur përmasat e saj shoqërore; standardet gjithashtu nuk janë përkufizuar ligjërisht në lidhje me birësimin dhe kujdesin tutorial.

- Sistemi i shërbimeve sociale ka një rol parandalues shumë të kufizuar, duke u përqendruar në një masë të madhe në dhënien e kujdesit rezidencial nëpër institucione, vetëm pasi fëmija është ndarë nga familja e vet.
- Sistemi i drejtohet vetëm një pjese të nevojave të fëmijëve për shërbime mbrojtëse.
- Shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve të mbështetura mbi institucione mbisundojnë mbi metodat e integritit të fokusuar.
- Ndërhyrjet efikase pengohen nga mungesa e të dhënave të klasifikuara mbi kategoritë e fëmijëve të rrezikuar dhe shpërndarjen e tyre. Më tej, mungesa e koordinimit dhe e programeve ndërsektoriale ka kufizuar mundësitë për t'u njohur mirë me situatën, për të gjetur shkaqet themelore të shpërbërjes së familjes e për të zhvilluar politika dhe ndërhyrje të efektshme.

Kapitulli 3 (Vlerësimi i standardeve dhe cilësia e shërbimeve të kryera nën programet e kujdesit social të hartuara për fëmijët pa kujdes prindëror) vlerëson standardet dhe cilësinë e shërbimeve të programeve të kujdesit social të hartuara për fëmijët pa kujdes prindëror. Gjetjet kryesore këtu janë:

- Në dhjetë vitet e fundit ka patur zhvillime të shumta pozitive në politikën dhe praktikën e birësimit. Procesi menaxhohet nga një administratë e sigurtë dhe profesionale. Procedurat e birësimit janë të qarta e fokusohen në atë çka është më e mirë për fëmijët. Gjatë periudhës 1994 - 2005 u birësuan rreth 1000 fëmijë, pa pasur probleme në periudhën e pasbirësimit. Megjithatë
 - disa institucione të kujdesit social qëllimisht e mbivlerësojnë dëndurinë e kontakteve që kanë fëmijët me familjet e tyre, me qëllim që të pengojnë largimin e fëmijës prej institucionit nëpërmjet birësimit.
 - Birësimi është relativisht i vështirë për t'u arritur në rastet e fëmijëve që janë mbi 3 vjeç, të sëmurë ose të paaftë.
 - Kapacitetet monitoruese për mirëqenien e fëmijës mbas birësimit janë të kufizuara.
- Sigurimi i shërbimeve të kujdesit social përmes institucioneve rezidenciale përfaqësojnë formën më të përhapur të mbrojtjes që u jepet fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror.
 - Institucionet rezidenciale kanë infrastrukturë të përshtatshme përsa i takon hapësirës së banimit, mobilimit bazë, ujë e pajisjeve sanitare si dhe funksione të ndryshme, megjithëse disa institucione publike e kufizojnë ujët e ngrohtë dhe kanë ndërprerje të energjisë edhe në furnizimin me ujë. Në institucione janë të pakta burimet materiale (si lodra ose libra) që nxisin zhvillimin e fëmijëve.

- Institucionet shpenzojnë për ushqim nga 180 lekë për ditë për fëmijë të moshave 0 deri 6 vjeç në 202 lekë për fëmijë të moshave 6 deri 14 vjeç.
- Shpenzimi mujor në institucione luhetet nga një shumë prej 17.355 lekë për fëmijë në 41.500 lekë për fëmijë, ku shpenzimet administrative zënë 50 deri 70 për qind të shpenzimeve të përgjithshme.
- Në sektorin publik përpjesëtimi personel:fëmijë në institucionet rezidenciale për fëmijët nga mosha 0 deri 6 vjeç është 0,9 dhe në institucione për fëmijët nga moshat 6 deri 14 vjeç 0,31.
- Institucionet rezidenciale kanë një numër mangësish:
 - Ato i heqin fëmijës të drejtën për t'u rritur në një mjedis familjar. Më tej, institucionet e organizuara sipas grupmoshave nënkuptojnë të paktën tri lëvizje të fëmijëve gjatë rritjes së tyre dhe ndarjen e vëllezërve apo motrave.
 - Shpesh fëmijët vuajnë nga institucionalizimi, sikurse e dëshmojnë problemet zhvillimore të tyre, niveli i ulët i vetëvlerësimit dhe shanset e tyre të kufizuara për pavarësi mbas moshës së adoleshencës. Ekipi kërkimor gjeti se fëmijët në këto institucione janë apatikë, të zbehtë e shëndetligë dhe personeli i institucioneve tregon se fëmijët në përgjithësi kanë rezultate të dobëta në mësim.
 - Praktikantët e kujdesit social në këto institucione kanë ndryshuar shumë pak dhe vazhdojnë të kenë pasoja negative mbi zhvillimin psikosocial të fëmijës.
 - Institucionet rezidenciale bëjnë shumë pak për ta riintegruar fëmijën në familjen e tij biologjike.
- Profili i fëmijëve nëpër institucione ka ndryshuar në dhjetëvjeçarin e fundit. Më përpara shumica e fëmijëve që banonin në institucionet publike sociale ishin jetimë biologjike, ndërsa sot shumica e tyre janë jetimë socialë, megjithatë autoritetet lokale të shërbimeve sociale, sidomos administratorët socialë, bëjnë shumë pak për t'i identifikuar fëmijët e rrezikuar e për të ndër marrë veprime që parandalojnë braktisjen e tyre.
- Kujdesi tutorial (foster) është një model efikas në pikëpamje të shpenzimeve. Janë mundësitë për ta zhvilluar atë si një alternativë ndaj institucionalizimit. Megjithatë, implementimi i tij i suksesshëm kërkon që të realizohet një kuadër i përshtatshëm ligjor.
- Riintegrimi në familje duhet të ketë një peshë më të madhe si një alternativë që do të mundësonte mirëqenien e fëmijës. Sidoqoftë, ka rëndësi që të vëzhgohet nga afër rritja e fëmijës brendapërbrenda familjes.

Kapitulli 4 (Problemet rreth zhvillimit psikosocial të fëmijëve pa kujdes prindëror) shqyrton nevojat zhvillimore psikosociale të fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror. Duke pasur parasysh kompleksitetin e kësaj teme, kjo pjesë e studimit përqendrohet në analizën e disa

çështjeve të veçanta që kanë të bëjnë me ndërlidhjen mes sjelljes së fëmijës dhe mjedisit të tij (apo faktorëve rrezikues në këtë mjedis). Gjetjet kryesore këtu janë:

- Ekipi hulumtues vërejtë se fëmijët flisnin me zë të ashpër, kishin frikë nga të huajt, përdornin gjuhë të varfër, kishin sjellje agresive dhe kërkonin të tërhiqnin vëmendje me mënyra të papërshtatshme. Kishin gjithashtu një frikë të theksuar nga e ardhmja.
- Duke pasur parasysh ndryshimin e profilit të fëmijëve që pranohen në institucionet rezidenciale, nevojat psikologjike të fëmijëve janë më të ndërlikuara se ç'kanë qënë në të kaluarën ndaj dhe modelet e kujdesit social duhet të përshtaten në përputhje me këtë, duke asimiluar metoda dhe koncepte të reja. Sido që të jetë, institucionet rezidenciale nuk janë të përgatitura mirë për një ndryshim të tillë.
 - Metodatat e sigurimit të personelit dhe të profileve përkatëse nuk i përshtaten më siç duhen misionit të këtyre institucioneve; sidomos ka shumë pak personel që të jetë i specializuar në psikologjinë e fëmijës ose në punët sociale.
 - Në vitet e fundit ka patur njëfarë trajnimit të personelit shërbyes dhe kjo ka pasur efekte pozitive në praktikë. Megjithatë shumë pjestarë të personeleve nuk janë mbërritur dot, sidomos kujdestarë dhe personeli tjetër mbështetës. Më tej trajnimi i personelit në përgjithësi nuk hartohet sipas nevojave; nuk ka mundësi për këto personele që të shkëmbejnë përvojat e tyre me të ngjashmit në institucionet e tjera.
 - Institucionet nuk e kanë kapacitetin profesional që të hartojnë dhe të ndjekin plane trajtimi individuale për fëmijë me vështirësi në të sjellur. Ato zakonisht janë të paafta që të bëjnë diagnoza psikologjike profesionale, të kryejnë vlerësime shumëdisiplinore ose të diskutojnë lidhur me përparimin e trajtimit.
- Ndërkohë që institucionet ofrojnë shërbime të shumta të rëndësishme për fëmijët, fëmijët vetë përjashtohen nga pjesëmarrja në vendimmarrje dhe në menaxhimin e këtyre shërbimeve. Kjo ka pasoja negative në pavarësinë dhe iniciativën e tyre vetjake, tipare të rëndësishme këto nëse kërkohet që fëmija të integrohet me sukses në shoqëri.
- Nëpër institucione fëmijët kanë hapësira shumë të kufizuara për jetë private përveçse shkollës, pak shanse që të ndërveprojnë me anëtarët e komunitetit. Veç kësaj institucionet bëjnë përpjekje të pakta për të nxitur kontaktet mes fëmijës dhe familjes së vet.
- Nuk ka një sistem për të regjistruar dhe trajtuar ankesat e fëmijëve. Më tej, sistemi i monitorimit të pavarur të institucioneve përqendrohet në aspektet fizike të institucionit dhe fëmijëve, pa i kushtuar vëmendje të përshtatshme zhvillimit social e psikologjik të fëmijës e mirëqenies së tij.

Këto përfundime të çojnë në disa rekomandime, të cilat së bashku do të nxisnin shndërrimin e sistemit të kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror.

A. Për sa i takon legjislacionit dhe politikave

- Duhet të përkufizohen standardet minimale të pranueshme të jetesës dhe edukimit të fëmijëve.
- Në përputhje me legjislacionin për asistencën ekonomike, fëmijët duhet të kategorizohen si të tillë (dhe jo si "të rritur me nevoja të veçanta") në një ligj të veçantë që duhet hartuar, "Kodin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve";
- duhet të qartësohet legjislacioni lidhur me atë çka përbën një kontakt të pranueshëm midis fëmijës së institucionalizuar dhe familjes së vet, me qëllim që të parandalohet abuzimi institucional me kontaktin nominal si një mjet për të bllokuar procedurat e birësimit;
- Duhet specifikuar më mirë në legjislacion klasifikimet e ndryshme të paaftësive të fëmijëve dhe integrimi shoqëror i fëmijëve me paaftësi. Gjithashtu legjislacioni duhet të njohë përmasat jomjekësore të paaftësisë;
- -Standardet e shërbimeve duhet të përcaktohen në ligj për procedurat e birësimit të zbatueshme brenda dhe jashtë vendit, për kujdestarinë e shtirë të familjet e kujdesit tutorial dhe për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat edhe vendimet për tutorësinë mbi fëmijën;
- Duhet zhvilluar legjislacioni që do të mundësonte shërbimet e kujdesit tutorial dhe shërbimet e mbështetura mbi komunitet;
- Duhet hartuar një politikë sociale bashkëkohëse që të mbrojë interesat e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror, duke zhvilluar forma alternative të kujdesit për fëmijët, të cilat i sigurojnë fëmijës një përkujdesje të qëndrueshme në një mjedis familjar;
- Duhet të ngrihet një Gjykatë e të Miturve, e cila trajton rastet që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve;
- U duhet dhënë asistencë në të holla të afërmeve dhe familjeve që ofrojnë shërbime të kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror, me qëllim që këta të mbahen në një mjedis familjar.

B. Përsa u takon shërbimeve të kujdesit social

- Kërkohen qendra të ndryshme që ofrojnë shërbime të specializuara, me qëllim që të parandalohet institucionalizimi dhe të ofrohen alternativa ndaj tij. Këto përfshijnë:
 - Qendra të kujdesit ditor që mbështesin trajtimin psikosocial, edukimin dhe këshillimin për fëmijët që punojnë në rrugë, për fëmijët e keqtrajtuar ose të abuzuar dhe për fëmijët që e kanë lënë shkollën ose janë në atë rrugë;

- Qendra akomodimi (shtëpi), të cilat ofrojnë strehim të përkohshëm për fëmijët që rikthehen në atdhe, përfshirë fëmijët që kthehen pasi kishin migruar të pashoqëruar nga prindët si dhe për fëmijët viktime të prostitucionit;
- Qendra rehabilitimi të cilat bëjnë trajtim psikosocial, këshillim dhe trajnim profesional për të rinj dhe për fëmijë viktime të drogave dhe të alkoolit, duke mëtuar integrimin e tyre në jetën normale;
- Shtëpi familjare dhe qendra të kujdesit ditor të cilat i shtrijnë shërbimet e tyre edhe te fëmijë të paaftë ose jetimë të cilët kanë lëvizur prej institucioneve rezistenciale të kujdesit social dhe te fëmijë nga familje me probleme sociale;
- Qendra për këshillim ligjor, të cilat trajtojnë çështje ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve jetimë ose të fëmijëve me probleme sociale;
- Një zyrë që përgjigjet për gjetjen e familjeve tutore dhe për të rregulluar ruajtjen e fëmijëve në nevojë për periudha afatshkurtëra e afatmesme.
- Mbështetja për institucionet rezistenciale duhet reduktuar duke:
 - ndikuar tek opinioni publik dhe politikëbërësit për nevojën e zhvillimit të formave alternative të kujdesit dhe mbështetjes familjare si dhe të sistemit të kujdesjes informale;
 - konvertuar ose mbyllur qendrat rezidenciale dhe ritrajnuar personelin e tyre, njëkohësisht me sigurimin e punësimit për to në struktura sociale të komunitetit.
- Duhet të ngrihet cilësia e shërbimeve të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror duke:
 - vendosur e mbikëqyrur standardet (standardet mjedisore; standardet e cilësisë së jetës; standardet e rezultateve, profesionalizmit dhe angazhimit);
 - monitoruar cilësinë e shërbimeve (licensimin, akreditimin dhe certifikimin, mbikëqyrjen dhe matjen e treguesve, avokatin e popullit dhe avokatët ligjorë të fëmijëve),
 - përmirësuar kushtet dhe proceset e punës (duke përmirësuar motivimin, siguruar trajnimin, zhvilluar një Kod të Sjelljes, duke ngritur sistemet dhe format e menaxhimit e duke siguruar përfshirjen e përdoruesve dhe siguruesve të shërbimeve).
- Për sa kohë do të vazhdojnë veprimin institucionet rezidenciale, mund të bëhen përmirësime të veçanta që do të sjellin përmirësime të shërbimeve të tyre:
 - Institucionet dhe autoritetet përgjegjëse në administratën publike duhet të trajnohen, aftësohen dhe mbikëqyren që të përmirësohet monitorimi i familjeve të rrezikuara, kontaktet midis fëmijëve të institucionalizuar dhe familjeve të tyre dhe lidhjet midis institucioneve dhe komuniteteve.

- Fëmijët e institucionalizuar duhet të përfshihen në vendime dhe në menaxhimin e shërbimeve që ofrohen brendapërbrenda institucioneve.
- Profili i personelit që punon në institucione duhet të ndryshohet në mënyrë që të përfshijë psikologë të fëmijëve dhe punonjës socialë.
- Programet e trajnimit për personelin e institucionit duhet t'u përshtaten nevojave sociale dhe psikologjike të fëmijëve dhe duhen ofruar për gjithë personelin, përfshirë personelin kujdestar dhe mbështetës.
- Duhet të vendoset një sistem informimi i cili është në gjendje të masë mirëqenien sociale të fëmijëve, sidomos të atyre që bëjnë pjesë në grupe sociale të përjashtuara, e që do të jetë i aftë të identifikojë fëmijët e rrezikuar nga braktisja ose shpërfillja.

II. Sfondi i studimit, objektivat dhe metodologjia

- Sfondi dhe qëllimi i studimit
- Objektivat dhe metodologjia e studimit
- Treguesit dhe mjetet e përdorura për matjen e tyre
- Mangësitë e studimit
- Rezultatet e studimit
- Përkufizimet e përdorura

II.1. Sfondi dhe qëllimi i studimit

Shqipëria, një vend në tranzicion përmbi një dhjetëvjeçar, ka përjetuar shndërrime të mëdha politike, ekonomike dhe shoqërore. Përpjekjet e shoqërisë shqiptare për të siguruar rritje ekonomike dhe zhvillim shoqëror janë shoqëruar me një numër sfidash të panjohura më parë, përfshirë këtu varfërinë, papunësinë e skajshme, mungesën e shanseve për punë dhe mungesën e shërbimeve bazë sociale, përfshirë arsimimin dhe shëndetësinë si dhe valë masive emigracioni. Vëzhgimi i matjes së standardeve të jetesës, të cilin e kreu INSTAT më 2002, erdhi në përfundimin se 25 për qind e popullsisë jeton me më pak se 2 dollarë në ditë dhe se 4,7 për qind jeton me më pak se 1 dollar në ditë. Pabarazitë në kushtet ekonomike dhe kulturore kanë çuar në përjashtimin shoqëror të disa grupeve të popullsisë, duke i privuar ato nga të drejtat e tyre themelore. Fëmijët pa kujdes prindëror janë ndër grupet më të braktisura e më pak të dukshme shoqërisht. Sigurimi i mbrojtjes shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe i të drejtave të tyre janë sfida që i dalin përballë qeverisë shqiptare dhe shoqërisë civile, duke kërkuar vëmendje të veçantë.

Qeveria shqiptare zhvilloi politikën e vet sociale, si pjesë e ndryshimeve politike në vitet '90, duke i trajtuar çështjet e fëmijëve në përputhje të plotë me parimet e Konventës për të drejtat e fëmijës, e ratifikuar nga qeveria shqiptare më 1992. Qeveria shqiptare bëri përmirësimet e nevojshme në legjislacion me qëllim që t'u sigurojë fëmijëve shqiptarë një mjedis të shëndetëshëm mbrojtës. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Kodi i ri i Familjes përmbajnë përcaktime të veçanta që trajtojnë mbrojtjen e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror. Miratimi i Strategjisë kombëtare për shërbimet sociale shtrou rruqën për zhvillimin e politikave të përshtatshme në këtë fushë, ku fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror duhet t'u ofrohen shërbime të përshtatshme. Së fundi Plani Kombëtar i Veprimit për Fëmijët, i miratuar në qershor 2005, identifikon një paketë prioritetesh strategjike dhe përgjithësisht institucionale për monitorimin e realizimit të të drejtave të fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror.

Numri i studimeve dhe vlerësimeve lidhur me shërbimet e kujdesit social që ekzistojnë sot për fëmijët pa kujdes prindëror është i kufizuar. Kjo tregon mangësi të veçanta sistematike, sidomos lidhur me cilësinë e kujdesit dhe të riintegritit social, por ka gjithashtu

boshllëqe të mëdha në të kuptuarit e shtrirjes së kujdesit social që ekziston sot, natyrën e kujdesit që ofrohet dhe mirëqënien e fëmijëve që janë nën përkujdesje. Ky studim u nxit me qëllim mbushjen e këtyre zbrazëtive, si pjesë e një programi ndërshtetëror bilateral të bashkëpunimit mes qeverisë së Shqipërisë dhe UNICEF-it. Ai kërkon të sigurojë informacion dhe të japë rekomandime që do të ndërtonin një platformë ligjore dhe institucionale për integrimin shoqëror të fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror.

Për këtë raport punuan së bashku tri organizata. QKShSS ofroi ekspertizën e vet në analizimin e politikave sociale dhe të kuadrit ligjor si dhe kontribuoi për rekomandimet, në përmirësimin e tyre në këndvështrim të standardeve të synuara. Po kështu QKShSS identifikoi modelet dhe numrin e institucioneve ekzistuese në gjithë vendin. Ekspertët e QZhH siguruan informacionin e kërkuar dhe shqyrtuan shërbimet ekzistuese në krahasim me standardet, në modele të ndryshme të shërbimit social që zbatohen në institucionet rezidenciale. Shërbimi Social Shtetëror lehtësoi mbledhjen e informacionit e gjithashtu mundësinë e hyrjes së grupit në institucionet si në nivel qendror ashtu dhe në nivel lokal.

I gjithë studimi u krye nën drejtimin e UNICEF-it, i cili rekomandoi edhe treguesit që duheshin matur gjatë zbatimit të këtij studimi.

II.2. Objektivat dhe metodologjia e studimit

Metodologjia e përdorur këtu ju përshtat secilit nga objektivat e studimit, duke mbajtur parasysh mundësinë e mbledhjes së informacionit në terren dhe treguesit e dëshiruar.

U konsultuan disa burime informacioni për të mbërritur objektivin e parë (identifikimin e institucioneve të kujdesit rezidencial për fëmijët në gjithë vendin dhe modelet e tyre)

- U siguria informacion statistikor nga burime zyrtare, përfshirë INSTAT, departamentin e informacionit në ministrinë e punës, së çështjeve sociale dhe shanseve të barabarta dhe sektori i statistikave dhe informimit në Shërbimin social shtetëror.
- U hartua një pyetësor i thjeshtë, "një kartë identifikimi", për të identifikuar të gjitha institucionet rezidenciale që veprojnë në territorin e vendit. Grupi i ekspertëve punoi së bashku me 12 zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror për të siguruar mbledhjen e informacionit në të gjithë vendin.
- Baza e të dhënave e administruar nga Ministria e Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të barabarta, e cila identifikon të gjitha organizatat lokale e të huaja jo fitimprurëse që veprojnë në territorin e Shqipërisë, arriti të përdorej siç duhej.
- U konsultuan disa dokumente të disponueshme në Komitetin ndërshtetëror të Kulteve, me qëllim identifikimin e qendrave rezidenciale të kujdesit për fëmijë që veprojnë nën drejtimin e organizatave të ndryshme fetare.
- U konsultuan statistika nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencave për të identifikuar shkollat publike dhe jopublike (shkolla me konvikte), që ndiqen nga fëmijët që vijnë

prej institucionesh publike rezidenciale (*shih listën e institucioneve të identifikuara në aneksin 1 të këtij materiali*).

Për mbërritjen e objektivit të dytë (përshkrimi i politikave dhe i kuadrit aktual ligjor) grupi i ekspertëve analizoi politikat dhe kuadrin aktual ligjor që mbështet kujdesin social në Shqipëri si dhe një numër ligjesh e aktesh nënligjore që lidhen me birësimin, arsimimin dhe Kodin e Familjes. Përveçse shqyrtoi ligjet dhe aktet nënligjore grupi i ekspertëve mbledhi informacion me vlerë për zbrazëtitë dhe kundërthëniet ligjore që janë identifikuar nga aktorët e përfshirë në zbatimin e politikave të kujdesit social. Ky informacion u mbledh nga dy grupe ekspertësh të politikave sociale në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të barabarta, nga dy grupe të përbëra prej administratorësh të organizatave jofitimprurëse e prej tri grupesh të përbëra nga punonjës të sistemit të shërbimeve sociale në rrafsh qendror dhe lokal. (*Një listë e dokumenteve të shqyrtuara dhe një listë e personave të intervistuar gjendet në aneksin 2 të këtij materiali*.)

Me qëllim mbërritjen e objektivit të tretë të këtij studimi (përshkrimin dhe vlerësimin e standardeve dhe të cilësisë së shërbimeve sociale që ofrohen në institucionet e kujdesit për fëmijë pa kujdes prindëror) grupi i ekspertëve kreu intervista individuale të thëlluara me personelin e institucioneve rezidenciale të kujdesit për fëmijët (mësues, punonjës socialë, administratorë të institucioneve, psikologë, doktorë dhe infermierë) dhe me personelin e administratës publike, si në nivelin qendror ashtu dhe në atë lokal. Po kështu grupi i ekspertëve organizoi vizita në institucionet rezidenciale dhe kreu drejtpërdrejt studime për raste fëmijësh rezidentë. (*Pyetësori i hartuar për intervistat individuale gjendet në aneksin 3 të këtij materiali*.) Me qëllim mbërritjen e objektivit të katërt (vlerësimi i zhvillimit psikosocial të fëmijëve që ndodhen në institucionet rezidenciale të kujdesit për fëmijët) grupi i psikologëve krijoi disa instrumenta dhe ndoqi nga afër zhvillimin psikosocial të fëmijëve, gjithashtu mirërritjen e tyre nga një këndvështrim shëndetësor e edukativ; u hartua gjithashtu një inventar i të gjitha mjeteve dhe i kushteve fizike ekzistuese në institucione, që ndihmojnë në rritjen e fëmijëve gjatë periudhës që këta ndodhen në institucion. (*Instrumentat e përdorur për mbërritjen e këtij objekti gjenden në aneksin 4 të këtij materiali*.)

Me qëllim mbërritjen e objektivit të pestë (hartimin e rekomandimeve për të ardhmen e sistemit të kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror) grupi i ekspertëve vlerësoi dhe analizoi gjithë dokumentacionin e disponueshëm mbi politikat e strategjitë afatshkurtëra e afatmesme që ka zhvilluar shteti shqiptar. Gjatë kësaj pune grupi u konsultua me politikëbërësit dhe përfaqësues nga institucionet qendrore. Rekomandimet që erdhën si rezultat kanë të bëjnë: së pari me ato pjesë të legjislacionit që kanë nevojë për rishikim dhe riformulim; së dyti me boshllëqet dhe mospërputhjet ligjore që kanë nevojë për t'u ndrequr; dhe së treti me krijimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e politikave të favorshme sociale në përputhje me standardet për rritjen e fëmijëve pa kujdes prindëror.

II.3. Treguesit dhe instrumentat

Treguesit e situatës së fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror në institucionet e kujdesit social

- Numri i fëmijëve pa kujdes prindëror që jetojnë në sistemin formal të kujdesit social
- Numri i fëmijëve të vendosur në institucionet rezidenciale të kujdesit social për fëmijë pa kujdes prindëror
- Numri i birësimeve të fëmijëve që vijnë prej sistemit të kujdesit social

Instrumentat e përdorur

- Kartat e identifikimit
- Pyetësi
- Grupet e fokusimit
- Të dhënat dhe regjistrimet statistikore të marra prej institucioneve, përfshirë këtu rrafshin qendror dhe lokal

Politikat dhe kuadri aktual ligjor

- Kuadri ligjor për kujdesin institucional: hapat që ndërmerren me qëllim parandalimin e ndarjes së fëmijëve prej familjes së tyre; parapëlqimi i fëmijëve për të ndenjur nën kujdesin e familjes së tyre; përdorimi i institucionalizimit si zgjidhje e fundit dhe e përkohshme dhe përfshirja e fëmijëve në vendimmarrjen për vendosjen e tyre.

Qasja e përdorur

- Analizë e hollësishme e dokumentacionit

Treguesit e standardeve të institucioneve dhe shërbimeve të tyre

- Numri i fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror që janë vendosur në sistemin rezidencial të kujdesit social gjatë vitit 2004.
- Përqindja e fëmijëve në sistemin institucional të kujdesit për fëmijët, statusi i të cilëve u rishikua gjatë vitit 2004
- Numri i fëmijëve të hequr prej sistemit institucional të kujdesit për fëmijët, të cilët janë vendosur nëpër familje gjatë vitit 2004
- Përpjesëtimi midis personelit të kualifikuar dhe fëmijëve të vendosur në sistemin rezidencial të kujdesit për fëmijët
- Shpenzimet mujore për çdo fëmijë

- Kuotat vjetore të ushqimit
- Treguesit e cilësisë së ushqimit
- Përqindja e fëmijëve të vendosur në sistemin institucional të kujdesit për fëmijët, të cilët shkojnë në shkolla të afërme
- Shpeshtësia e sëmundjeve dhe numri i vdekjeve ndër fëmijë të vendosur në institucione rezidenciale të kujdesit për fëmijë
- Numri i fëmijëve me të cilët punojnë institucionet rezidenciale të kujdesit për fëmijët të mbështetur mbi plane të përkujdesjes të zhvilluara individualisht
- Treguesi i vlerësimit të së ardhmes së fëmijëve

Instrumenta dhe teknika të përdorura

- Pyetësor individual
- Vëzhgime
- Studime të rasteve
- Skeda të fëmijëve të vendosur në institucione
- Regjistrimet e institucioneve

Treguesit e buxhetit

- Shpenzimet buxhetore për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e ndarjes së fëmijëve prej familjeve të tyre biologjike
- Shpenzimet buxhetore për kujdesin rezidencial, kujdesin tutorial dhe paskujdesin.

Instrumentat dhe teknikat e përdorura

- Të dhënat që gjenden në Shërbimin Social Shtetëror dhe institucionet rezidenciale
- Pyetësi 1

II.4. Kufizimet e studimit

Gjatë zhvillimit të këtij studimi grupi i ekspertëve u ndesh me disa vështirësi. Ka mungesa informacionesh paraprake lidhur me institucionet rezidenciale të kujdesit social të cilat nuk kanë marrë licencën prej Ministrisë së Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të barabarta ose të cilat nuk kanë lidhur kontratë me Shërbimin Social Shtetëror dhe autoritetet vendore.

Punonjësit e administratës publike rajonale dhe administratorët e institucioneve të kujdesit social nuk ishin gjithmonë të disponueshëm ose të gatshëm t'i plotësonin tërësisht

pyetësorët. Nuk gjendej dokumentacioni për disa institucione, nganjëherë adresat që gjëndeshin në Ministrinë e Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të barabarta dhe në Shërbimin Social Shtetëror nuk ishin të sakta, çka çoi në vonesa në vendosjen e kontaktit me personelin e institucionit.

Ky studim u krye brenda një periudhe të kufizuar kohore, si për arsye të situatës parazgjedhore në vend ashtu dhe për arsye të pushimeve verore. Veç kësaj një numër institucionesh u zhvendosën në kampet verore, duke e bërë më të vështirë për grupin e ekspertëve që të gjenin administratorët e institucioneve e të kryenin intervista si me personelin e institucioneve ashtu edhe me fëmijët.

II.5. Rezultatet e studimit

Gjatë zhvillimit të këtij studimi u vendosën një numër procesesh e u plotësuan produkte që do të vazhdojnë ta ruajnë vlerën e tyre edhe në të ardhmen.

Më së pari në Ministrinë e Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të barabarta dhe në Shërbimin Social Shtetëror u ngrit një grup ekspertësh për politikat sociale. Ai i ndoqi të gjitha etapat e këtij studimi duke siguruar që: I) procesi të ishte transparent; II) gjetjet të ishin të mirëpeshuara; dhe III) rekomandimet e bëra nga grupi i ekspertëve të ishin të realizueshme dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Së dyti procesi i menaxhimit të këtij studimi përfshiu si grupin e ekspertëve ashtu edhe personelin nga Shërbimi Social Shtetëror, ku ky i fundit u bë subjekt i këtij studimi. Kjo e ndihmoi personelin administrues të ShSSH që të fitojë një përvojë të çmuar në monitorimin e punës së institucioneve rezidenciale dhe të kuptojë standardet e shërbimeve që ofrojnë këto institucione. Kjo përputhet me misionin që vë statusi i ri i Shërbimit Social Shtetëror.

Së treti grupi i ekspertëve zhvilloi një bazë të dhënash të tipit GIS (hedhje në hartë) për gjithë institucionet rezidenciale të kujdesit për fëmijët, përfshirë ato që nuk ishin identifikuar më përpara.

Së kartëti ky raport përmban gjetje, analiza dhe rekomandime për të ardhmen e kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror në Shqipëri.

II.6. Përkufizimet e përdorura

- **Fëmijët pa kujdes prindëror** janë ata fëmijë që nuk jetojnë me prindët e tyre për arsye se: të dy prindët kanë vdekur; është hequr kujdesi prindëror; janë braktisur; prindët janë të paafte përkohësisht ose përherë që të kujdesen për fëmijët e tyre (janë të sëmurë ose në burg); fëmijët kanë hyrë me vullnetin e tyre (përkohësisht) në strukturat e kujdesit për fëmijët; fëmijët janë vendosur në institucionet e kujdesit për

fëmijët nga shërbimet sociale; fëmijët kanë ikur prej Shqipërisë të pashoqëruar nga prindët e tyre; ose kanë qenë trafikuar. Në këtë përkufizim nuk përfshihen fëmijët që nuk jetojnë me prindët e tyre për arsye se ndjekin shkolla që janë larg prej vendbanimeve të tyre (shkolla me konvikt); fëmijë që vuajnë dënimin në institucionet përkatëse dhe fëmijë që janë ndarë prej familjes së tyre për shkak lufte.

- **Fëmijë të shpërfillur** janë ata fëmijë që vuajnë dëmtime në zhvillimin e tyre për shkak mungese të ushqimit, veshmbathjes, të ngrohtit, edukimit, kujdesit, sigurisë, lidhjes afektive me të rriturit, kujdesit mjekësor si dhe varfërisë dhe abuzimit.
- **Fëmijë me paaftësi** (mendore ose fizike) janë ata fëmijë që përshfaqin vonesa të rënda në zhvillim, përfshirë vonesën mendore dhe çrregullimet psikosociale dhe fizike.
- **Institucione rezidenciale të kujdesit social** janë ato struktura që ofrojnë kujdes për fëmijët pa kujdes prindëror. Në to jeta nuk zhvillohet sipas linjës së familjes, fëmijët jetojnë në grupe dhe për ta kujdeset një personel me rrogë. Këto struktura mund të jenë të ngritura mbi komunitetin, që u siguron strehë fëmijëve pa kujdes prindëror ose mund të jenë institucione rezidenciale që ofrojnë kujdes për fëmijët që vijnë prej më shumë se një bashkie ose komune.
- **Kujdes informal** do të thotë vendosje e fëmijëve prej prindërve të tyre nën kujdesin e të afërmeve ose miqve të tyre; ose kujdesi që u ofrojnë fëmijëve pa kujdes prindëror të afërmit ose miqtë mbi bazë vullnetare. Kujdestarët mund të jenë gjyshi a gjyshja ose një i afërm tjetër gjaku apo një mik i ngushtë i familjes.
- **Ruajtja formale** shënon kujdesin brendapërbrenda një familjeje, rregulluar me marrëveshje formale. Kujdestarët mund të jenë të afërm të fëmijës ose persona të tjerë. Vendimi për ruajtjen i rezervohet një gjykate ose strukturave administrative të autorizuara për një vendim të tillë. Kujdesi mund të ushtrohet për një periudhë të shkurtër ose të gjatë, sipas vendimit të gjykatës ose të strukturave administrative.

Kapitulli i parë.

Institucionet që ofrojnë shërbime sociale për fëmijët pa kujdes prindëror në Shqipëri

- Përshkrim i shkurtër i situatës së fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror.
- Institucionet publike rezidenciale dhe kategoritë e fëmijëve të vendosur në to
- Institucionet rezidenciale jopublike
- Çinstitucionalizimi; kthimi në familje; birësimi; ndërthurja në jetën shoqërore
- Harta e institucioneve

1.1 Përshkrim i shkurtër i gjendjes së fëmijëve pa kujdes prindëror

Shqipëria, një vend në tranzicion, ka kaluar në 15 vitet e fundit shndërrime të rëndësishme politike, ekonomike dhe shoqërore e këto kanë pasur pasoja si pozitive ashtu edhe negative mbi kategori të ndryshme të popullsisë.

Janë bërë të zakonshme dukuri që më parë nuk ishin dëgjuar ose nuk ishin njohur, përfshirë këtu varfërinë, papunësinë, problemet sociale brenda familjes dhe emigrimin masiv. Meqë këto janë shoqëruar me shërbime sociale të papërshtatshme, janë shfaqur kategori të reja sociale personash të rrezikuar ose në nevojë, përfshirë këtu sidomos fëmijët pa kujdes prindëror.

Numri në rritje i fëmijëve që punojnë ose lypin, i fëmijëve që kanë ikur nga Shqipëria të pashoqëruar nga prindët e tyre si dhe i fëmijëve që janë braktisur ose janë lënë përkohësisht nën kujdesin e të afërmeve, kërkojnë që këto probleme të trajtohen me shpejtësi.

Sistemi i kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror është një sistem si *formal* ashtu edhe *informal*, me një numër modelesh të ndryshme:

a) *Birësimi*

b) *Kujdesi i ofruar nëpër familje*

c) *Kujdesi tutorial*

d) *Kujdesi institucional i tipit rezidencial*

e) *Kujdesi ditor i ofruar në qendrat për fëmijët me probleme sociale (lypësa, fëmijë rrugësh)*

f) *Shërbimet e riatdhesimit dhe të ribashkimit familjar për fëmijët që kanë ikur nga Shqipëria*

Shërbimi Social Shtetëror vlerëson se në vitin 2004 ishin 1198 fëmijë të privuar nga kujdesi prindëror të përfshirë nën kujdesin e sistemit formal: 448 fëmijë ishin në institucione rezidenciale publike (350 fëmijë në shtëpitë e fëmijës në moshat 0 deri 3, 3 deri 6 dhe 6 deri 14 përkatësisht dhe 98 fëmijë në qendrat rezidenciale të zhvillimit), ndërsa pjesa e

mbetur ishte nën kujdesin e organizatave jofitimprurëse (581 fëmijë në institucione të vogla rezidenciale ose të kujdesit ditor dhe 169 fëmijë nëpër shtëpi familjare). Këtë vit u birësuan 54 fëmijë që jetojnë me familje të reja.

Në krahasim me vende të tjera të rajonit Shqipëria ka një numër jashtëzakonisht të vogël fëmijësh që jetojnë në institucione rezidenciale (shih tabelën 1), por dukuria ka prirje në rritje, ndërkohë që kanë ndryshuar edhe kategoritë e fëmijëve.

Më 1994 numri i fëmijëve në kujdes rezidencial ishte rreth 400 dhe shumica e tyre ishin fëmijë të braktisur qysh prej lindjes dhe jetimë biologjikë. Të dhënat në vitin 2004 tregojnë se numri i fëmijëve në institucionet e kujdesit për fëmijë është rritur plot tri herë në krahasim me vitin 1994 dhe se shumica e fëmijëve janë "jetimë socialë" dhe "fëmijë me probleme sociale".

Tabela 1. Numri i fëmijëve nën kujdesin e institucioneve rezidenciale¹ (2002)

<i>Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale të kujdesit social, për çdo fëmijë të grupmoshës 0-17 vjeç</i>	
Shqipëria	83.2 ²
Bullgaria	831.3
Rumania	909.4
Kroacia	280.5
Maqedonia	160.2
Moldavia	726.3

Burimi i informacionit: Social Monitor 2004, UNICEF

Arsyet përse ka një numër kaq të vogël fëmijësh në institucionet e kujdesit social janë së pari, sistemi informal i kujdesit për fëmijët (për fëmijët jetimë, fëmijët e braktisur ose fëmijët nën kujdes të përkohshëm); së dyti numri dhe kapacitetet e kufizuara të institucioneve rezidenciale; së treti tradita familjare dhe lidhjet e forta që ende ekzistojnë midis familjes së gjerë.

1.2 Institucionet rezidenciale publike dhe kategoritë e fëmijëve të vendosur në to

Legjislacioni shqiptar i përkufizon jetimët si persona në moshat nga 0 deri në 25 vjeç të cilët: (I) kanë lindur jashtë martese; (II) nuk kanë prindër të gjallë; (III) janë deklaruar jetimë me vendim gjyqi; ose (IV) janë braktisur nga prindër të pidentifikuar. Kjo është kategoria e parë e fëmijëve të destinuar të rriten pa kujdes prindëror. Maternitetet e spitalet dhe shtëpitë publike e jopublike për fëmijët janë pararoja e institucioneve publike dhe jopublike që japin asistencë për këta fëmijë, së bashku me anëtarë të familjes së tyre të origjinës ose të afërmit.

¹ Të dhënat në tabelë kanë të bëjnë vetëm me fëmijët e vendosur në institucionet rezidenciale të kujdesit social më 2004.

² Shifra për Shqipërinë është korigjuar nga autorët, me të dhënat më të fundit të ShSSH.

Tabela 2. Numri i fëmijëve në shtëpitë e fëmijës, sipas vitit, grupmoshës e seksit

Viti	Total	F	M	0-3 vjeç	3-6 vjeç	6-14 vjeç	Me familje	Pa familje
2000	465	208	257	168	61	236	253	212
2001	459	215	244	165	51	245		
2002	406	187	219	154	44	208	245	161
2003	435	185	230	159	51	205	265	150
2004	350	182	168	118	41	191	232	118

Burimi: Statistika të Shërbimit Social Shtetëror, 2004

Maternitetet ose spitalet. Fëmijët e braktisur në maternitete ose spitale (rastet kur prindët nuk mund të identifikohen) janë nën kujdesin e personelit mjekësor derisa të vendosen në njërin nga institucionet publike të kujdesit social për fëmijë të moshave 0 deri 3 vjeç. Një vëzhgim mbi disa maternitete erdhi në përfundimin se aty ku maternitetet nuk disponojnë punonjës socialë, dokumentacioni për fëmijën që duhet të vendoset në një institucion përgatitet nga stafi mjekësor në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror. Materniteti i Tiranës është i vetmi maternitet që ofron shërbime për fëmijët e braktisur; personeli i tij përfshin mami, punonjës socialë, doktorë dhe infermiere. Duhet theksuar se këto shërbime jepen si rrjedhim i vullnetit të mirë të personelit dhe të një donacioni nga një bamirës që ndihmoi të viheshin në jetë këto shërbime. Në përgjithësi maternitetet nuk ruajnë informacion mbi numrin e fëmijëve të braktisur dhe në institucionet ku këta vendosen. Materniteti i Tiranës filloi të mbajë një bazë të tillë të dhënash më 2002 por ato përdoren vetëm prej këtij materniteti.

Institucionet publike rezidenciale për fëmijë të moshave 0 deri 3 vjeç. Më 2004 në institucionet rezidenciale publike jetonin 118 fëmijë të moshave 0 deri 3 vjeç (shih tabelën 2); 16 ishin në Durrës, 18 në Korçë, 10 në Shkodër, 29 në Vlorë dhe 45 në Tiranë. Më 2004 në këto institucione u vendosën 48 fëmijë; 13 ishin fëmijë të braktisur me nëna që njiheshin, 14 ishin fëmijë të braktisur me prindër të panjohur dhe 21 fëmijë u ishin hequr familjeve të tyre.

Institucionet rezidenciale publike për fëmijë parashkollorë të moshave 3 deri 6 vjeç. I vetmi institucion rezidencial publik për fëmijë të moshave 3 deri 6 vjeç ndodhet në Shkodër; ai strehonte më 2004 41 fëmijë. Më 2004 10 nga 16 fëmijët e vendosur rishtas në këtë institucion vinin nga Shtëpia e Foshnjes, ndërsa 6 u ishin hequr familjeve të tyre biologjike.

Institucionet rezidenciale publike për fëmijë të moshave 6 deri 14 vjeç. 191 fëmijë të moshave 6 deri 14 vjeç janë vendosur në tri institucione rezidenciale: 48 fëmijë në

Sarandë, 83 fëmijë në Shkodër dhe 60 fëmijë në Tiranë. Fëmijët në këto institucione përgjithësisht vijnë nga familje të varfra dhe nga familje me probleme sociale; pak fëmijë janë jetimë biologjikë. Më 2004 në këto institucione u strehuan 55 fëmijë të rinj; 28 vinin nga familjet e varfra ose familje me probleme sociale, 2 ishin fëmijë të braktisur, 23 vinin nga institucione për fëmijë parashkollorë dhe 2 ishin jetimë.

Tabela 3. Dinamika e vendosjes së fëmijëve në institucione rezidenciale publike, sipas vitit

VITET	2001		2002		2003		2004		2004	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Të vendosur të rinj në inst. sipas arsyes										
Të sjellë në institucion nga për arsye të varfërisë ose problemeve shoqërore	83	61%	92	68%	53	58%	79	63%	49	41%
Të braktisur	50	38%	23	16%	28	30%	40	33%	37	31%
Të ardhur nga institucione për shkak të moshës	5	1%	21	16%	11	12%	8	4%	33	28%

Të dhënat mbi numrin dhe arsyet për vendosjen në institucione tregojnë se mesatarisht 60 për qind e fëmijëve vijnë nga familje të varfra e familje me probleme sociale, 30 për qind kanë qenë braktisur pas lindjes dhe vetëm 10 për qind e tyre janë vendosur në institucione për arsye të tjera, përfshirë këtu riatdhesimin, pasi kanë qenë trafikuar dhe pasi kanë qenë fëmijë rrugësh.

Në bazë të regjistrave të institucioneve problemet kryesore sociale që çojnë në vendosjen në institucione janë mungesa e njërit prind (kjo është arsyeja për 30 për qind të vendosjeve), braktisja në lindje dhe shkurorëzimi; natyrisht varfëria është një faktor ndihmës në secilën prej këtyre kategorive. (Shih tabelën 4).

Tabela 4. Profili social i fëmijëve nën kujdes të institucioneve gjatë vitit 2004


Arsyet e vendosjes në institucione	
Jetimë biologjike (vdekur të dy prindërit)	
Jetimë socialë	

Prindër të shkurorëzuar
Me një prind
Prindër në burg
Prindër me sëmundje mendore
Fëmijë romë (familje të varfra në ekstrem)

Burimi: ShSSH „Statistikat 2004

Numri i fëmijëve të vendosur në institucione nga prindër kur ka munguar partneri është rritur në vitet e fundit. Këta fëmijë, në qoftë se janë 6 deri 14 vjeç, prirën të kalojnë një kohë më të gjatë në institucione sesa kategori të tjera fëmijësh.

Diagrami 1 Numri i fëmijëve nën kujdesin e institucioneve publike të kujdesit social, sipas grupmoshave



Vetëm 3 për qind e 350 fëmijëve që jetonin në institucione publike në vitin 2004 ishin *jetimë biologjikë*; përqindja e këtyre fëmijëve është më e lartë për grupmoshën 6 deri 14 vjeç sesa për grupmoshat e tjera.

Fëmijët e braktisur në lindje (jetimë socialë) përbëjnë 16 për qind të të gjithë fëmijëve që jetonin në institucione më 2004; ata përbënin 60 për qind të fëmijëve në moshat 0 deri 3 dhe 3 deri 6 vjeç. Fëmijët e moshave 0 deri 3 vjeç që janë të braktisur përgjithësisht kanë lindur jashtë martesë prej personash që kanë pasur lidhje jashtëmartesore, prej personash që për arsye të ndryshme nuk kanë mundur të krijojnë familje dhe prej personash me paaftësi mendore.

Mbi 1/5 e fëmijëve që jetojnë në institucione janë vendosur atje në prag të një shpërbërje të familjes. Shkaqet e drejtpërdrejta përfshijnë divorcin, sëmundjen, vdekjen e një prindi, burgosjen e një prindi dhe rimartesën e njërit ose të të dy prindërve.

Shpërbërja e familjes shoqërohet gjithashtu me uljen e të ardhurave, përkeqësimin e kushteve të jetesës si dhe probleme strehimi, papunësi dhe varfëri. Të dhënat e mbledhura për këtë studim tregojnë se dy janë arsyet kryesore që i çojnë prindët ose kujdestarët ta vendosin fëmijën në një institucion: e para është varfëria e skajshme e familjes dhe e dyta mundësia që fëmija të mund të marrë arsimim gjatë kohës që është në institucion.

Fëmijët me prindër alkoolikë ose me të meta mendore përbëjnë 5 për qind të fëmijëve të vendosur në institucione. Në shumicën e rasteve këta fëmijë shfrytëzohen prej prindëve të tyre ose prej kujdestarëve. Një numër i këtyre fëmijëve shfaqin deformime fizike dhe probleme zhvillimi, ata nuk marrin ndonjë kujdes shëndetësor ose rehabilitues. Pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve vjen nga komuniteti rom. Këta fëmijë në përgjithësi jetojnë gjatë ditës në institucione dhe kthehen në mbrëmje te familjet e tyre. Ata janë të shpërfillur, megjithëse deri-diku përfitojnë nga të ardhurat që fitojnë prindët e tyre.

Kutiza 1 Fëmijët e familjes Zyberi në komunën Gjinaj (rrethi i Kukësit)

Mungesa e formimit, informacionit, shpërfillja e administratorit shoqëror, mungesa e një rrjeti shërbimesh shoqërore komunitare treguan se ajo që ndodhi me fëmijët e një familjeje në Kukës gjatë dimrit 2003, është vetëm maja e ajtërgut dhe një fenomen që mund të ndodhë kudo në Shqipëri.

Në Komunën Gjinaj të rrethit të Kukësit në shkurt të vitit 2003 ndodhi një ngjarje tragjike, e cila mund të ishte mënjtuar. Një nënë me probleme të shëndetit mendor dhe e vetmuar jetonte në varfëri të plotë me 12 fëmijët e saj, më i madhi 16 vjeç, ndërsa më i vogli 3 vjeç. Familja jetonte në një kasolle gjysmë të rrënuar dhe pa orëndi shtëpiake. Seksioni i ndihmës ekonomike dhe kujdesit social në komunë, i akordonte familjes së madhe në numër të Hanife Zyberit ndihmë ekonomike, por ajo ishte e pamjaftueshme për të përballuar nevojat e saj. Përveç ushqimit që ishte i pamjaftueshëm, fëmijëve u mungonin veshjet dhe mbulesat për të përballuar dimrin e ftohtë të kësaj zone. Mëngjesi i një dite të ftohe shkurti të vitit 2003 solli një tragjedi për familjen Zyberi: njëri nga vogëlushët nuk mundi t'i rezistonte të ftohtit dhe vdiq i ngrirë. Trupi i tij u gjend pa veshje dhe i mbështjellë me një qilim të hollë lecke. Për të shpëtuar fëmijën më të vogël nga ngrirja, Hanife Zyberi (nëna e fëmijëve) kishte tentuar ta ngrohte duke ia afruar duart e këmbët afër zjarrit të sobës, duke i shkaktuar djegie. Edhe Arditi i rrezikohej jeta për shkak të djegieve të gradës së dytë, por falë ndërhyrjes së shpejtë nga Tirana, atij iu shpëtua jeta.

(...nga kronika e kohës)

Sot 11 fëmijët e mbijetuar janë larguar nga kujdestaria e nënës, e cila nuk është e aftë të përkujdeset e t'u shërbejë fëmijëve të saj. Disa prej fëmijëve janë vendosur tek të afërmit dhe disa të tjerë në institucione të ndryshme rezidenciale dhe në Fshatin SOS.

Një vlerësim më i kujdesshëm i këtij rasti nga administratori social ose ekzistenca e një strukture identifikuese apo mbështetëse në nivel komune do të kish mundur ta shmangte tragjedinë. Fëmijët e familjes Zyberi kishin jetuar për vite të tëra në mjerim dhe ishin shpërfillur nga nëna e tyre e sëmurë. Por askush nuk ishte shqetësuar të gjente një zgjidhje për këta fëmijë. Por as zgjidhja e gjetur nuk i përgjigjet parimeve të interesit më të mirë të fëmijëve. Sado që këta fëmijë tani janë jashtë rreziku dhe

tani marrin arsimim, ato përsëri jetojnë në institucione të ndryshme rezidenciale, të ndarë nga njëri-tjetri.

Përveç institucioneve të sipërpërmendura një numër fëmijësh jetimë e me aftësi të kufizuara janë vendosur nën kujdesin e 6 **qendrave të zhvillimit** të cilat janë qendra rehabilitimi për fëmijët me aftësi të kufizuara. Këto qendra ndodhen në Tiranë, Durrës, Berat, Vlorë, Korçë dhe Shkodër. Gjatë vitit 2004 qendrat e zhvillimit ofruan trajtim për 289 fëmijë me të meta, prej të cilëve 51 frekuentonin këto qendra në mënyrë ditore.


Tabela 5. Numri i fëmijëve nën kujdesin e qendrave të zhvillimit, sipas moshës

<i>Viti</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Femra</i>	<i>Meshk</i>	<i>3-16 vjeç</i>	<i>Mbi 16 vjeç</i>
2000	206	-	-	-	-
2001	216	93	123	103	113
2002	279	112	167	132	147
2003	264	115	149	114	150

Burimi: ShSSH, Sektori i statistikave

Afërsisht 2/3 e fëmijëve nën kujdesin e qendrave të zhvillimit kanë familje; këto zakonisht kthehen në familje për fundjave. Pjesa tjetër e fëmijëve janë të privuar nga kujdesi prindëror, për pasojë rrinë në institucion për gjatë gjithë kohës (shih grafikën 1).

Grafika 1



1.3 Institucionet rezidenciale jopublike

Me përmirësimin e legjislacionit vitet '90 panë krijimin e kushteve për të zgjeruar shërbimet alternative të kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror. Në fillim ofruesit e këtyre shërbimeve ishin më së shumti organizata ndërkombëtare jofitimprurëse. Njëri prej këtyre shërbimeve **shtëpitë familjare**, janë një nga format më të përhapura e me cilësi më të lartë. Modeli i familjeve lindi qysh më 1995, rregulluar në bazë të një marrëveshjeje të lidhur më 1992 midis SOS - Kinderdorf International dhe Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

Tabela 6. Institucionet rezidenciale të drejtuara nga organizata jofitimprurëse

Emërtimi	Vendndodhja
Vatër e ngrohtë	Gjirokastrë
Fshati i Paqes	Shkodër
Betania	Fushë Krujë
Fëmijët e Tij	Tiranë
Shtëpia e shpresës	Durrës
Brez i zgjedhur	Komuna Kodër Thuman
Fillimet e reja	Berat

Christian Relief Mission	Tiranë
Shtëpia e Zemrës	Tiranë
Eden	Tiranë
Rreze dielli	Tiranë
Orët fatlume	Elbasan
Shtëpia e shpresës	Elbasan
Nënë Tereza	Shkodër
Të rinjtë me një mision	Burrel

Në Shqipëri ka rreth 25 shtëpi familjare që veprojnë në qytetet e Shkodrës, Tiranës dhe Elbasanit (fshati i fëmijëve SOS me 13 shtëpi familjare dhe *Sunray* me 1 të tillë); 9 shtëpi familjare në Shkodër (*Madonnina del Grappa* dhe projekti "Speranza") japin përkrahje për 68 fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara që kanë ikur prej institucioneve rezidenciale publike në moshën 14-vjeçare; në Elbasan ka 2 shtëpi të tilla për fëmijë të braktisur e jetimë. Me rrjetin e vet prej 13 shtëpish familjare fshati i fëmijëve SOS është komuniteti më i gjerë i shtëpive të tilla në Shqipëri.

Katërmbëdhjetë **institucione rezidenciale me kapacitet të vogël** veprojnë në qytetet e Shkodrës, Beratit, Elbasanit dhe atë të Fushë Krujës, si dhe në komunën e Thumanës.

Në Tiranë ka **dy qendra ditore**³ dhe një **qendër rezidenciale** të krijuara për fëmijë të shpërfillur e të shfrytëzuar nga prindët e tyre (lypës).

Gjatë viteve '90 një numër fëmijësh ikën nga Shqipëria të pashoqëruar nga prindët e tyre.⁴ Një numër **institucionesh ndërkombëtare dhe shqiptare si dhe organizata jofitimprurëse janë përfshirë** në veprimet që kanë për qëllim riatdhesimin e këtyre të miturve dhe riintegrimin e tyre në jetën normale, duke u ofruar atyre arsim, trajnim profesional dhe mbështetje për të filluar veprimtari prodhuese në shkallë të vogël.⁵

Tabela 7. Fëmijët në institucionet e kujdesit social, sipas tipit të kujdesit, grupmoshës dhe seksit

	Gjithsej	Femra	Fëmijë me aftësi të kufizuar	Grup mosha			
				0-3 vjeç	3-6 vjeç	6-14 vjeç	Mbi 14 vjeç
Gjithsej	1198	479	353	158	137	583	320
Sipas formës së kujdesit :							
	849	331	244	150	102	366	231
	169	64	68	8	31	46	84

³ Kjo u referohet institucioneve të cilat vetëm u vizituan. Gjatë zhvillimit të këtij studimi doli se një numër i qendrave ditore për lypës të mitur kishin ndërruar adresa.

⁴ Shih Child Trafficking - the People Involved, 2005

⁵ Institucionet shqiptare bashkëpunojnë me organizata të huaja dhe vendase për një numër çështjesh që kanë të bëjnë me antitrafikimin, përfshirë këtu IOM, UNICEF, UNHCR dhe ILO-IPEC. Ambasadat e SHBA, Britanisë së Madhe dhe Hollandës në Tiranë kanë dhënë ndihmesa të rëndësishme në sigurimin e riatdhesimit dhe integrimin të fëmijëve shqiptarë që kanë qenë të trafikuar jashtë Shqipërisë; Child Trafficking - the People Involved, 2005.

○ Institucione rezidenciale	180	84	41	0	4	171	5
○ Shtëpi familjare	0	0	0	0	0	0	0
○ Qendra ditore							
○ Kujdesi tutorial (foster care)							

Burimi i informacionit: Intervista dhe statistika nga Shërbimi Social Shtetëror, 2004

Vlerësohet se janë gjithsej rreth 16 000⁶ fëmijë jetimë në Shqipëri për të cilët kujdesen të afërmit e tyre. Nga ana tjetër janë edhe 1198 fëmijë të cilët për arsye të ndryshme nuk gëzojnë kujdesin e prindërve ose të afërmve dhe ndodhen aktualisht nën kujdesin e institucioneve të kujdesit social për fëmijët. (Tabela 7).

1.4 Çinstitucionalizimi

Tri janë aktualisht rrugët kryesore nëpër të cilat mundet të largohet një fëmijë nga institucioni i kujdesit social: kthimi në familjen e mirëfilltë, birësimi dhe integrimi në shoqëri me mbërritjen e moshës madhore.


Në 2004 ishin 184 fëmijë (Departamenti i statistikave, Shërbimi Social Shtetëror) që u larguan nga institucioni përkatës që kujdesej për ta. Prej tyre 66 ishin të moshave 0 deri 3 vjeç dhe këta janë larguar nga Shtëpia e Foshnjes e sektorit publik; 50 u birësuan e 16 u kthyen në familjet e tyre. 23 fëmijë të tjerë u zhvendosën në një institucion tjetër. (Shih grafikën 3).

Kthimi i fëmijës në familjen e mirëfilltë (biologjike)

Kthimi i një fëmije në familjen e vet të origjinës është një nga përparësitë e institucioneve rezidenciale, si publike ashtu dhe të atyre jopublike. Ai realizohet në një masë të madhe duke mbajtur dhe forcuar lidhjet midis fëmijëve dhe familjeve të tyre. Në çdo vit afërsisht 1/5 e fëmijëve që largohen nga kujdesi i institucioneve të kujdesit social kthehen në familjen e tyre. Shih tabelën 8.

Grafika 3

⁶ Shërbimi Social Shtetëror, Statistikat sociale-ekonomike, 2004. Këto të dhëna janë marrë nga regjistrimet që gjenden në shoqata të ndryshme për jetimët.



Birësimi

Siç tregohet në tabelën 8 birësimi është rruga më e zakonshme për fëmijët që të largohen nga kujdesi institucional. Raporti i fëmijëve që janë larguar prej institucioneve për arsye birësimi ka rënë në vitet e fundit (46,5 për qind më 2000 ndaj 32 për qind më 2004).

Tabela 8. Largimet nga institucionet

Vitet	2000		2001		2002		2003		2004	
Larguar gjithsej / në %	146	%	142	%	134	%	118	%	184	%
Nga këto:										
Në familje	38	26	24	17	35	26	25	21	41	22
Të birësuar	68	46,5	71	49	49	37	48	41	58	32
Në institucione/ konvikte	9	6	19	14	16	12	19	16	41	22
Në shkolla	21	18	14	8	14	10	19	16	27	14,6
Arsye të tjera	8	5,4	14	8	18	13	5	4	14	7,6

Të dhënat e siguruara nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve tregojnë gjithashtu se numri i birësimeve ka rënë gjatë periudhës 2001-2004 (tabela 9). Shkaku i drejtpërdrejtë i rënies duket se ka qënë një rënie paralele në numrin e fëmijëve të regjistruar siç duhet për birësime.

Tabela 9 Të dhëna mbi birësimet përgjatë viteve

	2001	2002	2003	2004
Numri i fëmijëve të regjistruar për birësime	76	37	62	52
Numri i fëmijëve të birësuar	88	47	54	54
<i>prej tyre jashtë Shqipërisë</i>	47	26	26	26
Numri i fëmijëve të sëmurë, me paaftësi apo të rritur të birësuar	56	19	15	17
<i>prej tyre jashtë Shqipërisë</i>	56	19	15	17

Përpjesëtimi i birësimeve midis vendasve dhe të huajve flet në favor të këtyre të dytëve. Kjo mund të shpjegohet nga fakti se të gjithë fëmijët që ishin të sëmurë, me aftësi të kufizuara ose më të moshuar u birësuan nga familje që jetojnë jashtë Shqipërisë.

Tabela 10 Shpërndarja e fëmijëve sipas seksit dhe tipit të institucioneve publike rezidenciale

Viti	1996		1997		1998		1999		2000		2001		2002		2003		2004		Totali
Institucioni / Seksi	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	
<i>Qendra e zhvill. Vlorë</i>	-																		
<i>Qendra e zhvillimit rezidenc. Korçë</i>	-																		
<i>Qendra e zhvillimit Durrës</i>	-																		
<i>Qendra e zhvillimit Berat</i>	-																		
<i>Qendra e zhvillimit Shkodër</i>	-																		
<i>Qendra e zhvillimit Tiranë</i>	-																		
<i>Shtëpia e Foshnjës Tiranë</i>	15	1	9	3	0	4	1	5	5	7	1	0	8	7	1	7	0	0	154
<i>Shtëpia e Foshnjës Durrës</i>	1	0	5	9	8	9	9	16	0	1	2	5	4	6	8	7	3	1	134
<i>Shtëpia e Foshnjës Vlorë</i>	10	4	12	6	6	7	0	5	8	8	8	8	3	0	0	3	1	1	110
<i>Shtëpia e Foshnjës Shkodër</i>	4	7	6	2	6	2	8	3	5	1	5	2	4	6	1	2	0	3	67
<i>Shtëpia e Foshnjës Korçë</i>	1	1	2	2	3	6	7	2	4	3	2	3	2	2	6	2	0	0	48
<i>Shtëpia e fëm. parashk. Shkodër</i>	0	0	0	2	0	2	1	3	1	1	1	1	2	1	2	3	0	0	20
<i>Shtëpia e Fëmijës shkollore. Shkodër</i>	2	0	0	3	0	0	2	0	0	0	0	0	2	0	1	0	1	0	11
<i>Shtëpia e fëmijëve shkoll. Sarandë</i>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	2
<i>Shtëpia e fëmijës Shkoll. Tiranë</i>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	3	0	0	0	0	1	0	0	6
TOTALI	33	33	34	37	3	0	8	34	3	3	2	9	5	2	0	6	5	5	552

Integrimi në shoqëri me mbërritjen e moshës madhore

Me kryerjen e arsimit themelor (tetëvjeçar) shteti garanton bursa të plota për fëmijët jetimë në institucionet e kujdesit social, në mënyrë që ata të marrin arsimin e mesëm në një shkollë me konvikt. Ata fëmijë që janë të aftë dhe të gatshëm të ndjekin studime të larta, marrin përsëri bursa dhe banim falas në konviktet e universiteteve. Kujdesi për fëmijët që studiojnë në shkollat e mesme dhe të larta është një përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencave, meqë konviktet e këtyre shkollave janë nën juridiksionin e kësaj ministrie.

Pavarësisht nga të drejtat që u jep atyre statusi që kanë si jetimë (e drejta për banesë, për punësim në përputhje me profesionin e tyre), fëmijët që mësojnë në shkollat e mesme ose të larta vazhdojnë të jetojnë në kushte shumë të vështira sociale dhe ekonomike.

Kur mbarojnë shkollën e mesme, shumë nga këta fëmijë vazhdojnë të jetojnë në konviktet e shkollave që kanë ndjekur për arsye se nuk zgjidhet çështja e banimit të tyre. Në 2004 ishin 291 persona të tillë (tani në moshën mbi 18 vjeç) që jetonin në konvikte. 3 për qind e jetimëve që mbaron shkollën e mesme shkon në universitet.


Tabela 11. Numri i jetimëve mbi moshën 18 vjeç që ende jetojnë në konvikte

<i>Emërtimi</i>	<i>Numri i të rinjve jetimë</i>	<i>Rrethi</i>
QFP4	56	Tiranë
Shkolla Teknologjike	37	Tiranë
Politeknikumi	16	Tiranë
Shkollat e Ndërtimit, Mekanike dhe Pedagogjike	45	Shkodër
Shkollat Teknologjike dhe të Ndërtimit	32	Korçë
Shkolla Tregtare	30	Vlorë
Shkolla Bujqësore	20	Lezhë
Shk. Mekanike, Bujqësore, Kursi i shoferëve	45	Durrës
Shkolla Bujqësore	10	Berat
TOTALI	291	

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

1.5 Harta e institucioneve të kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror

INSTITUCIONET E PERKUJDESIT SHOQEROR PER FEMIJET JASHTE KUJDESIT PRINDEROR



Kapitulli 2.

Kuadri aktual ligjor e politik dhe sistemi i menaxhimit, monitorimit dhe i vlerësimit

- Kuadri politik dhe ligjor që sanksionon të drejtat e fëmijëve në Shqipëri
- Kuadri ligjor që sanksionon mbrojtjen sociale për fëmijët në Shqipëri.
- Komete mbi legjislacionin aktual
- Drejtime prioritare lidhur me përmirësime në legjislacion
- Menaxhimi i shërbimeve të kujdesit social, sistemi i financimit dhe i administrimit
- Programet aktuale dhe shërbimet e kryera
- Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve sociale që shtrihen te fëmijët pa kujdes prindëror
- Çështje kritike që kanë të bëjnë me thelbin dhe zbatimin e programeve të shërbimeve sociale për fëmijët pa kujdes prindëror
- Rekomandime për të ardhmen e ndihmës sociale dhe sistemit të kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror

Shërbimet sociale shtrihen te fëmijët pa kujdes prindëror nëpërmjet programeve të reduktimit të varfërisë dhe programeve të kujdesit social. Legjislacioni që rregullon lidhjet midis institucioneve dhe mundëson zbatimin e programeve të sipërpërmendura është pjesë e politikës sociale që qeveria shqiptare ka ndjekur qysh prej viteve '90. Programi social u zhvillua në përputhje me konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga qeveria dhe parlamenti shqiptar, përfshirë Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve. Megjithëse janë ruajtur elemente të politikës sociale të zbatuar në të kaluarën, politika sociale qysh prej fillimit të viteve 90 është reformuar në një masë të madhe që t'i përshtatet programit për shndërrimet sociale dhe ekonomike që po zbatohen në Shqipëri.

Ligjet, vendimet, rregullimet dhe vijat orientuese që do të shqyrtohen më poshtë ndihmojnë të zbatohet politika sociale për mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijëve pa kujdes prindëror. Sidoqoftë në bazë të tyre janë disa dokumenta themelore të shtetit, përfshirë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe konventa ndërkombëtare. Ndaj dhe kapitulli aktual është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përqendrohet në aktet themelore juridike të shtetit, të cilat kanë të bëjnë me politikën sociale në përgjithësi, ndërsa pjesa e dytë trajton aktet juridike ndërsektoriale që merren me elementet teknike të programit të kujdesit social.

2.1 Kuadri politik dhe ligjor që sanksionon të drejtat e fëmijëve në Shqipëri

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e miratuar me ligjin nr. 8417 datë 21 tetor 1998, dhe hyrë në fuqi me dekret nr. 2260, datë 28 nëntor 1998, është ligji themelor që sanksionon mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi e të atyre pa kujdes prindëror në veçanti. Kushtetuta e re e Republikës së Shqipërisë përmban një kapitull të veçantë mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të qytetarëve si dhe një kapitull mbi objektivat sociale. Këta kapituj sanksionojnë detyrimin e shtetit për të siguruar kujdesin dhe ndihmën për fëmijët pa kujdes prindëror përgjatë gjithë procesit të rritjes, zhvillimit dhe arsimimit të tyre (neni 59/e). Në mbështetje të Kushtetutës janë miratuar ose janë duke u shqyrtuar disa ligje dhe vendime që vënë bazat mbi politikën e kujdesit social për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror.

Konventa ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF), e ratifikuar nga qeveria shqiptare në shkurt 1992, hyri në fuqi në mars 1992. Detyrimet që rrjedhin prej kësaj konvente përsa u takon respektimit të të drejtave të fëmijës udhëhiqen prej parimit të respektimit të "interesave më të mira të fëmijës". Sipas KDF fëmija ka të drejtë të gëzojë një standard të pranueshëm jetese, sigurimi i të cilit është përgjegjësi e shtetit dhe e prindërve. Ratifikimi i KDF ishte një hap i parë në vendosjen e sistemeve institucionale që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror. Zbatimi i KDF kërkon hyrjen në fuqi të ligjeve dhe akteve nënligjore të veçanta, si dhe ngritjen e institucioneve në nivel politik, ekzekutiv dhe monitorues/mbikëqyrës.

Më tej sipas vendimit nr. 134, datë 5 maj 2000, të Këshillit të Ministrave, u ngrit një grup ekspertësh i ngarkuar me detyrën që "të përgatisë raporte mbi zbatimin e konventave në Shqipëri". Ky grup u ngarkua gjithashtu me përgatitjen e një raporti mbi zbatimin e KDF, i cili u përfundua në qershor 2005 dhe iu paraqit Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve të OKB. Komiteti e pa si një arritje progresin që është bërë në reformën legjislativë lidhur me të drejtat e njeriut në Shqipëri në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti.

Karta sociale europiane (DCM), rishikuar me vendimin nr.458, datë 27 prill 1998 të Këshillit të Ministrave, njeh dhe mbron të drejtat e njerëzve për të gëzuar shërbime sociale. Sidoqoftë duhet theksuar se vetë qytetarët pak njohuri kanë se cilat janë përfitimet e tyre. Do shënuar gjithashtu se ratifikimi duhet shoqëruar me hyrjen në fuqi të një numri ligjesh dhe udhëzimesh që do të mundësonin zbatimin.

Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës nr. 138 "lidhur me moshën minimale për lejim të punësimit"* u ratifikua më 1998, ndërsa konventa nr. 182 "Mbi ndalimin dhe veprimin e menjëhershëm për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijës" u ratifikua më 2001.

Konventa e Hagës (1993) "Mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në birësimet ndërkombëtare" u ratifikua me ligjin nr. 8624, datë 15 qershor 2000.

Kodi i ri i Familjes (ligji nr. 9062, datë 8 maj 2003) specifikon detyrimet institucionale të shtetit për fëmijët pa kujdes prindëror dhe mënyrën se si duhet të trajtohen ato. Në Kodin e Familjes "fëmijë pa kujdes prindëror"⁷ konsiderohen të gjithë këta fëmijë:

- prindët e të cilëve kanë vdekur,
- prindët e të cilëve janë shpallur të panjohur,
- prindët e të cilëve janë shpallur të humbur,
- që janë braktisur nga prindët,
- prindët e të cilëve janë privuar nga e drejta e tyre prindërore në bazë të një vendimi përfundimtar gjykate.

Në këto rrethana shteti përmbush detyrimin e tij nëpërmjet një gjykate, e cila vendos për formën e kujdesit që duhet zbatuar:

- familje me lidhje gjaku, ku njëri nga anëtarët e familjes do të jetë kujdestari;
- një familje e huaj tutore
- një person që caktohet si tutor
- një familje që caktohet si tutore
- një institucion i kujdesit social (shtetëror ose privat)

Në marrjen e vendimit gjykata mban parasysht rekomandimet dhe këshillat e departamentit për ndihmën sociale dhe të shërbimeve sociale në bashkinë ose komunën përkatëse e çdo informacion tjetër mbi zhvillimin dhe personalitetin e fëmijës, si dhe konsideratën se cila formë kujdesi do të ishte më e mira për fëmijën. Gjykata merr një vendim për ta vendosur fëmijën nën mbikëqyrje. Përveç së drejtës për të caktuar një tutor të kualifikuar, bordi i mbikëqyrjes mundet gjithashtu ta vendosë fëmijën në një institucion të veçantë.

Nenet 351/1 dhe 352 të **Kodit të Procedurës Civile** miratuar me ligj nr. 8116, datë 29 mars 1996, përcaktojnë që "Kërkesa për vendosjen e kujdestarisë i paraqitet gjykatës nga të afërmit e fëmijës së mitur dhe nga cilido që merr njoftimin për mbetjen e fëmijës pa prindër, për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur dhe për çdo rrethane tjetër që ligji kërkon vendosjen e kujdestarisë si dhe ushtrimin e kësaj të drejte nga vetë i mituri kur ai ka mbushur moshën 16 vjeç. Gjithashtu, sipas nenit 356/1 "gjykata, përpara se të procedojë për emërimin e kujdestarit, duhet të pyesë edhe të miturin, kur ai ka mbushur moshën 10 vjeç".

⁷ Këtu e më pas do të përdoret termi "fëmijët".

Ligji nr. 7650, datë 17 dhjetor 1992 "mbi birësimin e të miturve nga qytetarë të huaj dhe disa përmirësime në Kodin e Familjes." Ky pararendi hyrjen e Shqipërisë në Konventën e Hagës "Mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin lidhur me birësimin ndërshtetëror." Sipas këtij ligji birësimi lejohet vetëm kur ai është në interesat më të mira të fëmijës. Ligji specifikon procedurat që e shpallin ligjërisht një fëmijë si të braktisur. Ligji përcakton se fëmija shpallet i braktisur kur prindët nuk kanë treguar në mënyrë të dukshme interesimin e tyre në një periudhë njëvjeçare përpara dorëzimit të kërkesës tek një gjykatë për të shpallur aktin e braktisjes. Për fëmijët e vendosur në institucione qysh në lindje periudha që paraprin deklarimin e braktisjes është 6 muaj. Në bazë të legjislacionit gjykata merr vendim duke u mbështetur mbi një shqyrtim të plotë të rrethanave që kanë çuar në braktisje. Krahas shpalljes së fëmijës të braktisur, gjykata vendos për strehimin e tij. (Kryesisht ajo vendos që fëmija të hyjë në një institucion).

Ligji nr. 8153, datë 31 tetor 1996, "Mbi statusin e jetimit" përcakton kriteret e vendosjes së fëmijëve në institucione të kujdesit social. Ky status u jepet disa kategorive fëmijësh siç përkufizohen në Kodin e Familjes (ligji nr. 9062, datë 8 maj 2003).⁸

Ky status jepet nga një komitet i krijuar enkas në Shërbimin Social Shtetëror, në të cilin një anëtar është përfaqësues i Shoqatës së fëmijëve jetimë. Legjislacioni administron gjithashtu mënyrën se si vepohet me fëmijët pa kujdes prindëror që vendosen në institucione të kujdesit social. Në bazë të përcaktimeve të ligjit aktual dhe akteve normative të miratuara nga Ministria e Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të barabarta, këta fëmijë mund të qëndrojnë në institucione shtetërore ose private të kujdesit social deri në moshën 14 vjeç e në raste të veçanta deri në moshën 17-vjeçare.

2.2 Kuadri ligjor që sanksionon mbrojtjen sociale të fëmijëve në Shqipëri

Ligji nr.9355, datë 10 mars 2005, "Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore", u hartua mbi bazën e ligjit nr. 7710, datë 18 maj 1993, "Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror", përmirësuar nga ligji nr. 7886, datë 8 dhjetor 1994 dhe ligji nr. 8008, datë 5 tetor 1995 si dhe prej aktesh nënligjore që u mbështetën mbi to (vendimi nr. 307 i Këshillit të Ministrave, vendimi nr. 510 i Këshillit të Ministrave). Ky ligj (9355) i kapërcen ligjet e mëparshme (7710, 7886 dhe 8008) dhe përcakton sistemin për asistencë ekonomike dhe kujdes social për qytetarët shqiptarë, përfshirë fëmijët pa kujdes prindëror. Ligji paracakton:

- strukturën dhe tipologjinë e shërbimeve të kujdesit social;
- organizimin, funksionimin dhe financimin e tyre;
- kategoritë e përfituesve të shërbimeve institucionale;

⁸ Kodi i Familjes (2003) fut një teknologji të re, bashkëkohëse. Këtu përdoret termi "fëmijë pa kujdes prindëror" në vënd të termit "jetim". Ky përkufizim e zgjeron grupin e fëmijëve që përfitojnë, duke përfshirë këtu edhe fëmijët që janë pa kujdes prindëror ndonëse prindët e tyre jetojnë.

- kriteret për të pasur të drejtën e përfitimeve;
- rregullat për pranimin / vendosjen në institucione dhe dokumentacionin me rëndësi;
- monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve.

Ky ligj (nr.9355) përkufizon sistemin e shërbimeve sociale dhe sanksionon që: „Shërbimet shoqërore përfshijnë tërësinë e shërbimeve që iu ofrohen individëve dhe grupeve në nevojë dhe që sipas natyrës ndahen në shërbime të përkujdesit shoqëror dhe të përkujdesit shoqëror e mjekësor”. Nën këtë ligj, ndërsa shërbimet e kujdesit social mbulojnë shërbimet që u ofrohen individëve, familjeve, grupeve në nevojë dhe komuniteteve për t'i ndihmuar ato që të plotësojnë nevojat e tyre jetike, shërbimet e kujdesit social dhe mjekësor përfshijnë ato shërbime që ofrohen prej personeli të specializuar e që kanë për synim rehabilitimin shëndetësor.

Ky ligj përkufizon gjithashtu disa terma që kanë rëndësi për zbatimin e sistemit të kujdesit social, përfshirë jetimët⁹, persona me aftësi të kufizuara¹⁰, shërbimet sociale¹¹ dhe familjet e huaja tutore.¹² Ligji më tej specifikon kategoritë e përfituesve në përputhje me tipin e asistencës ose kujdesit që ofrohet. Ndër këto kategori janë fëmijët (përfshirë fëmijët pa kujdes prindëror), të rinj deri në moshën 25 vjeç, persona me aftësi të kufizuara dhe ata që bëjnë pjesë në grupet në nevojë.

Ligji paracakton tipet e shërbimeve, në lidhje me organizimin dhe funksionimin e tyre, dhe i grupon ato në shërbimet të kujdesit rezidencial dhe komunitar. Ndërkohë që shërbimet në institucionet rezidenciale u ofrohen individëve për të cilët është i pamundur kujdesi në shtëpi, shërbimet e mbështetura mbi komunitet ofrohen në qendra të kujdesit ditor, shëpti vetjake ose familje të huaja, në përshtatje me nevojat e veçanta të personave përfitues.

Në lidhje me financimin shërbimet e kujdesit social grupohen në shërbime publike dhe private. Shërbimet publike financohen nga buxheti i qeverisë qendrore dhe buxhetet e administratave vendore. Ato menaxhohen nga ministria e punës, çështjeve sociale dhe

⁹ Me termin “Jetim” kuptohet fëmija pa prindër deri në moshën 25 vjeç, sipas përcaktimit të bërë në statusin e jetimit.

¹⁰ Me termin “Person me aftësi të kufizuar” kuptohet individi, të cilit i është kufizuar aftësia si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, të intelektit, psikiko-mendor, të lindura apo të përfutuara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme apo të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin.

¹¹ Me termin “Shërbime shoqërore” kuptohet tërësia e shërbimeve që u ofrohen individëve dhe grupeve në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të përballojnë me burimet që kanë, nevojat e tyre jetësore për ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente ato kronike.

¹² Me termin “Familje kujdestare” apo tutore kuptohet një familje alternative, sipas përkufizimit të dhënë në nenin 266 të ligjit nr.9062 datë 08.05.2003 “Mbi Kodin e Familjes”.

shanseve të barabarta, ku shërbimet ofrohen nëpërmjet institucionesh kombëtare (institucione të përcaktuara për më shumë se një "rajon"); prej bashkive/komunave, ku i ofrojnë institucione që i shërbejnë një qyteti ose një komune dhe nga rrethi, ku shtrihen në individë që vijnë prej njësisë të ndryshme vendore në këtë rreth. Shërbimet sociale private nuk ndryshojnë në natyrë apo në tipologji nga shërbimet publike por nga që financimi i tyre është privat.

Në bazë të legjislacionit personat juridikë, publikë dhe privatë kanë të drejtë të menaxhojnë shërbime sociale pasi të jenë licensuar nga Ministria e Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të barabarta. Kontrata midis institucionit shtetëror dhe institucionit joshetëror përcakton lidhjen ligjore midis tyre. MPÇSShB harton një kontratë model, regjistron statusin e institutit menaxhues dhe përcakton se çfarë raportimi e çfarë pasqyrash kërkohen e ofrohen. MPÇSShB është përgjegjëse për zhvillimin e standardeve të shërbimit social. Legjislacioni parashikon pagesa për paaftësi në përputhje me vendimet e komitetit përgjegjës. Ai parashikon asistencë ekonomike për familjet që kujdesen për një ose më shumë anëtarë familjeje të cilët nuk janë në gjendje të kujdesen për vetveten për shkak të paaftësisë së tyre fizike ose mendore. Legjislacioni përcakton gjithashtu kushtet në të cilat një familje, përfshirë fëmijët pa kujdes prindëror, mund të përfitojnë nga asistencë ekonomike. Në vështrim të përfitimit të asistencës ekonomike, legjislacioni nuk trajton fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror si një kategori më vete por si "fëmijë të rritur".

Ligji 9355 pasqyron ndryshime të rëndësishme lidhur me decentralizimin dhe modernizimin e shërbimeve të veçanta sociale. Në veçanti:

1. Ai parashikon që shërbimet sociale të decentralizohen, duke rritur kështu **pjesëmarrjen e pushtetit vendor dhe shoqërisë në planifikim, financim e zbatim**. Kjo specifikohet në nenin që trajton "mënyrën e financimit":

"Financimi i programeve të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror bëhet nga buxheti i shtetit dhe buxheti i pushtetit vendor. Burimet e financimit për shërbimet e përkujdesit shoqëror që realizohen nga institucionet publike dhe jo publike, në nivel qarku ose bashki/komunë, në institucione residenciale, në qendrat ditore, në familje apo shërbime të lëvizshme në komunitete, përbëhet nga:

- Fondet e deleguara të buxhetit të shtetit
- Fondet e caktuara nga taksat dhe tarifat vendore

Të ardhura e caktuara nga pasuritë dhe aktivitete të tjera të bashkisë apo komunës si dhe dhurime, sponsorizime etj

2. Ai parashikon Fondin Social që do të financojë asistencën sociale dhe sistemin e shërbimeve. Ai financohet me para publike të caktuara për shërbime të kujdesit social; financim jashtëbuxhetor nga organizata, persona fizikë ose juridikë ose individë të tjerë; të ardhura të tjera që vijnë nga zbatimi i marrëveshjeve bilaterale ose multilaterale; si dhe nga burime dhe asetet e ministrisë.

3. Ai i transferon shërbimet rezidenciale të kujdesit social te pushteti vendor; vendos shërbimet e reja sociale të përcaktuara nga pushteti vendor, duke përdorur asetet të zhvendosura nga pronësia e qeverisë qendrore në pronësinë e pushtetit vendor; dhe transferon kujdestarinë shtëpiake në shërbime të mbështetura mbi komunitet, e nëse është e pamundur, në shërbim social shtëpiak të përmirësuar.

Ligji nr. 8652, datë 31 korrik 2000, i organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor krijon kushtet e nevojshme për decentralizimin e shërbimeve sociale. Sidoqoftë duhet nënvizuar se për shkak të burimeve të kufizuara financiare lokale, decentralizimi financiar ende nuk është zbatuar në secilën njësi të pushtetit vendor.

Vendimi nr. 307, datë 24 maj 1994, i Këshillit të Ministrave¹³ "Për shërbimet e përkujdesit shoqëror u hartua dhe u miratua në mbështetje të ligjit nr. 7710. Ai përcaktoi që shërbimet e kujdesit shoqëror të financohen nga buxheti shtetëror si më poshtë:

- Shërbime "jashtëinstitucionale", përfshirë ato që ofrohen në qendra të kujdesit ditor (për fëmijë rrugësh e individë të paaftë), shtëpi dhe shërbime emergjente;
- shërbime institucionale që jepen në institucione rezidenciale.

Në institucione shërbimet shtrihen në fëmijë jetimë dhe të braktisur si dhe në fëmijë me paaftësi të ndryshme. Pushteti qendror, pushteti vendor, organizata joqeveritare dhe persona privatë japin shërbime të kujdesit për fëmijët. Autoritetet vendore ofrojnë "shërbime jashtëinstitucionale", ndërsa departamentet qendrore, përfshirë Ministrinë e Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të barabarta ofrojnë shërbime institucionale. Po i njëjti vendim përcakton sesi duhet të organizohen dhe funksionojnë shërbimet e kujdesit social, hierarkinë e tyre dhe detyrat që ka secili institucion. Ky vendim cakton gjithashtu mënyrën e menaxhimit të institucioneve të kujdesit social dhe funksionimin e tyre, si dhe mënyrën e financimit të tyre. Gjithashtu ky vendim përcakton zhvendosjen e institucioneve të kujdesit social nga përgjegjësia e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave dhe Ministria e Shëndetësisë në Ministrinë e Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të barabarta. Ky vendim po ashtu jep modelin për statusin e institucioneve dhe modelin për marrëveshje ndër-institucionale.

Vendimi nr. 510, datë 24 nëntor 1997, i Këshillit të Ministrave¹⁴ "Kriteret e vendosjes në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranim" vendos rregullat për pranimin në institucione, sipas grupmoshave dhe nevojës për rehabilitim. Sipas tyre të gjitha kategoritë e fëmijëve pa kujdes prindëror, ashtu siç përkufizohen në Kodin e Familjes, duhet të pranohen në shtëpitë e foshnjeve dhe të fëmijëve (pika 1.a.6 e këtij kapitulli.)

¹³ Kur të hartohen akte nënligjore në mbështetje të ligjit të ri 9355 për ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale, ky vendim bëhet i pavlefshëm. Sidoqoftë tani për tani ky vendim është ende në fuqi.

¹⁴ Vlen i njëjti shpjegim si në poshtëshënimin e mëparshëm.

Edhe fëmijët prindët e të cilëve janë përkohësisht të paaftë që të kujdesen për ta për shkak të situatës së tyre ekonomike (për të cilën gjë duhet paraqitur dokumenti përkatës si dëshmi), ose për shkaqe shëndetësore, mund të vendosen në këto institucione për një periudhë deri në 6 muaj.

Këto institucione mund të pranojnë gjithashtu fëmijë nga familje që kalojnë krizë, si dhe fëmijë prindët e të cilëve kanë emigruar.

Më 25 maj 2001 Shërbimi Social Shtetëror përgatiti Rregulloren e institucioneve të kujdesit social për fëmijët me probleme sociale.¹⁵ Rregullat e procedurës përmbajnë disa kapituj përfshirë këtu: përcaktimet e përgjithshme, administrimin dhe organizimin, pranimin e fëmijëve dhe largimin e tyre nga institucioni, programet, mjedisin, si dhe përcaktime përfundimtare. Rregullorja u hartua në mbështetje të ligjit nr. 7710 dhe akteve përkatëse nënligjore. Rregullorja përfaqëson janë aktet normative që administrojnë veprimin e institucioneve të kujdesit social për fëmijët me probleme sociale. Rregullat e procedurës u mundësojnë institucioneve kryerjen e funksioneve të mëposhtme:

- mirërritjen e fëmijës,
- kujdesin shëndetësor,
- arsimimin,
- rimëkëmbjen psiko-sociale me krijimin e një mjedisi të ngjashëm me atë familjar,
- integrimin e fëmijës në shoqëri,
- gjetjen e një familjeje të përkohshme për fëmijët, me synim kthimin e tyre në familjen përkatëse biologjike.

Rregullorja është detyruese për gjithë institucionet e kujdesit social për fëmijët me probleme sociale, pavarësisht nga statusi i tyre.

Më 25 maj 2001 Shërbimi Social Shtetëror përgatiti Rregulloren për Qendrat e Zhvillimit.

Kjo rregullore përbëhet nga disa kapituj, përfshirë dispozita të përgjithshme, administrimin dhe organizimin, pranimin e fëmijëve dhe largimin e tyre prej institucioneve, programet, ambientin dhe dispozita të fundit. Rregullorja u hartua në mbështetje të kuadrit aktual ligjor. Krahas drejtimit të shërbimeve në institucionet e kujdesit social, kjo rregullore përfaqëson aktin normativ që administron veprimin e institucioneve të kujdesit social për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore.

2.3 Komente mbi legjislacionin ekzistues

Kuadri ligjor mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror në Shqipëri është relativisht i gjerë e bashkëkohës. Sfidat më të rëndësishme janë forcimi i

¹⁵ Vlen i njëjti shpjegim si në poshtëshënimin e mëparshëm.

kapaciteteve institucionale për zbatimin e tij; fuqizimi i pushtetit vendor me qëllim identifikimin dhe referimin e rasteve; zgjerimi i shërbimeve sa më afër aplikuesit që të jetë e mundur si dhe vëzhgimi dhe raportimi për zbatimin e tyre.

Ka disa zbrazëti në kuadrin ligjor që shtrojnë nevojën për përmirësime ose për përcaktime më të qarta:

Së pari, emigracioni ka sjellë një rritje të numrit të fëmijëve pa kujdes prindëror. Kjo situatë kërkon që të bëhen përcaktime të qarta e të prera ligjore lidhur me **detyrimet e prindërve dhe të shtetit** në dhënien e fëmijëve kushte jetese e arsimimi në përputhje me parimet e "interesave më të mirë të fëmijës". Legjislacioni aktual përvijon detyrimet financiare të prindërve, por ai ka mangësi në përkufizimin e nivelit minimal të pranueshëm të jetesës dhe të standardeve të arsimimit që duhen plotësuar për fëmijët.

Së dyti legjislacioni ekzistues i ndihmës ekonomike i sheh fëmijët si "të rritur në nevojë të veçantë". Të drejtat e fëmijëve do të mund të mbroheshin më mirë në qoftë se ata kategorizohen si fëmijë. Kjo do të kërkonte hartimin dhe zbatimin e një ligji të veçantë "**Kodit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve**".

Neni 6 i ligjit 9355 përkufizon rolin e administratorëve socialë. Ata përgjigjen për identifikimin e familjeve në nevojë për asistencë, duke u siguruar atyre ndihmë, duke bërë rekomandime për vendosjen në institucione e duke përgatitur dokumentacionin kryesor. Këto përgjegjësi i caktohen pushtetit vendor (bashkive ose komunave) e në këtë pikëpamje ligji është mjaft pozitiv.

Neni 11 thekson rolin e Ministrisë së Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të barabarta në vendosjen e kriterëve të pranimit për fëmijët në institucionet e kujdesit social. Këto janë të zbatueshme si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel vendor. Ky është një aspekt pozitiv, trajtimi i të cilit zhvillohet në bazë të standardeve.¹⁶

Së treti kuadri ligjor "Për aftësinë e kufizuar" nuk është i plotë, sidomos pjesa që trajton "riintegrimin". Klasifikimi i aftësisë së kufizuar nuk është specifikuar si duhet, duke e bërë të vështirë ofrimin dhe sigurimin e shërbimeve sociale në përshtatje me nevojat; përkufizimet ligjore që ekzistojnë tanimë nuk zbatohen. E njëjta vlen për kuadrin ligjor lidhur me "riintegrimin e fëmijëve pa kujdes prindëror" (specifikim i mangët dhe zbatim i papërshtatshëm). Arsytet kryesore që shpjegojnë këto mangësi kanë të bëjnë me vështirësitë financiare të institucioneve si dhe me dobësitë institucionale, sidomos në zbatimin e atyre politikave dhe ligjeve që kërkojnë bashkërendim ndër-institucional (struktura të qeverisë qendrore, përfshirë Ministrinë e Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të barabarta, Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Brendshme.) Do të ishte me dobi **ngritja e një zyre shtetërore**¹⁷ që do

¹⁶ Grupi i ekspertëve sugjeroi gjithashtu kritere unike për pranimin në institucionet e decentralizuara.

¹⁷ Ajo mund të quhej Autoriteti kombëtar i Mbrojtjes së Fëmijëve, me departamente në nivel rajonal dhe lokal.

të përgjigjej për bashkërendimin e përpjekjeve dhe për vrojtime të përgjithshme në këto fusha.

Së katërti, neni 1 i ligjit 9355 e trajton paaftësinë zhvillimore si dukuri klinike. Duke qenë i tillë, komisionet mediko- ligjore përgjigjen për përcaktimin e paaftësisë zhvillimore. Mirëpo në vështrimin e grupit të ekspertëve, paaftësia nuk është vetëm një dukuri klinike (fizike ose mendore); ajo është gjithashtu dukuri shoqërore. Prandaj komisioni përgjegjës për vlerësimin e paaftësisë duhet të ketë natyrë shumëdisiplinore.

Më tej legjislacioni nuk parashikon **trajtim të veçantë** për ata fëmijë që janë si me aftësi të kufizuara ashtu dhe pa kujdes prindëror.

Së pesti, kuadri ligjor nuk e trajton në mënyrë të plotë e rrezikun e keqtrajtimin dhe të abuzimit të fëmijëve pa kujdes prindëror. Në këtë fushë duhet të ngrihen programe parandaluese dhe rehabilituese.

Së gjashti, legjislacioni që ka të bëjë me standardet e shërbimeve nuk është i plotë. Ai nuk mbulon shërbimet që ofrohen në institucionet e kujdesit social ose të tjera shërbime nga të cilat përfitojnë fëmijë pa kujdes prindëror. I duhet kushtuar sidomos vëmendje e veçantë **procedurave të birësimit** që zbatohen brenda dhe jashtë vendit, "**kujdestarisë të shtrirë në familje tutore**", së drejtës për mbikëqyrje dhe së drejtës për vendimmarrje lidhur me mbikëqyrjen e fëmijës. Procedura e **monitorimit të cilësisë së shërbimit** dhe respektimi i **standardeve** të miratura kanë një rëndësi të veçantë.

Së shtati, duhen bërë përmirësime dhe shtojca në Kodin e Procedurës Penale.

2.4 Drejtime prioritare për përmirësimet në legjislacion

Sistemi legjislativ dhe institucional po përmirësohet gradualisht në tri drejtime kryesore:

- Formulimi dhe hyrja në fuqi e ligjeve që mbështeten mbi Kushtetutën, përfshirë Kodin Civil, Kodin e Punës, Kodin e Familjes, Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për Ndhimën ekonomike dhe Shërbimet sociale, Ligjin për Sigurimet shoqërore dhe Ligjin për Sigurimet Shëndetësore;
- Ndryshimet në legjislacion mbështetur mbi instrumentat dhe konventat ndërkombëtare të nënshkruara nga qeveria, përfshirë këtu Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe Kartën Sociale Europiane të Rishikuar;
- Zhvillimi dhe miratimi i përcaktimeve që zbatohen drejtpërdrejtë në fushën e kujdesit social dhe veçanërisht shërbimet sociale, përfshirë ligje, vendime të ndryshme dhe udhëzime që lindin në këtë kontekst, përkah zhvillimi i një Kodi për Fëmijët.
- Kanë rëndësi zhvillimi dhe zbatimi i këtyre strategjive kombëtare:

1. **Strategjia afatmesme kombëtare për Shërbimet sociale** përvijon një reformë rrënjësore në politikën e mbrojtjes dhe zhvillimit të fëmijëve pa **kujdes prindëror**, që ka për qëllim ngritjen e efektivitetit të politikave sociale. **Krahasuar me politikën aktuale kjo strategji synon që ta udhëheqë reformën në drejtimitet e mëposhtme:**

- Të ofrojë shërbime **të integruara** për fëmijët, si në **komunitet** ashtu dhe në **familje**.
- Të sigurojë bashkërendimin dhe bashkëpunimin midis **qeveriësë qendrore, pushtetit vendor dhe rrjetit të organizatave jofitimprurëse**.
- T'i caktojë një rol thelbësor **pushtetit vendor**, për t'u bërë **identifikimi** i personave "në nevojë" ose "të rrezikuar", dhe për vendimmarrje në vështrim të shërbimeve më të mira.
- Ngritjen e sektorëve të **kujdesit social për fëmijët në nivel të pushtetit vendor** (departamentet aktuale quhen të ndihmës ekonomike dhe të përkujdesjes shoqërore dhe përgjigjen për trajtimin e të gjitha kategorive të personave në nevojë)
- Ngritjen e **qendrave të shërbimit social në qytetet më të mëdha** të Shqipërisë.
- Përmirësimin e **legjislacionit** të shërbimeve sociale duke synuar sigurimin e mbrojtjes dhe **respektimit të të drejtave** të fëmijëve në nevojë.
- Zbatimin dhe monitorimin e **standardeve të shërbimit social** për fëmijët në të gjitha institucionet publike dhe jopublike.

Strategjia përmban disa objektiva konkrete e pritmëri të rëndësishme në vështrim të parandalimit të vendosjes së fëmijëve pa kujdes prindëror nëpër institucione. Kjo pasqyron një fokusim të ri të politikave të kujdesit social ndaj këtyre fëmijëve, duke përfshirë parandalimin, një përkrahje më të mirë familjare dhe reduktimin e periudhës së qëndrimit në qendrat rezidenciale. Shih strategjinë: faqe*.

2. Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social miratuar në Nëntor 2001 dhe rishikuar çdo vit, theksojnë se harmonizimi i shërbimeve që sigurojnë ndihmën ekonomike dhe shërbimet e tjera sociale është e vetmja rrugë për të arritur një cilësi të përmirësuar të shërbimeve sociale. Rekomandimet që përmbahen në këtë strategji përputhen me politikat prioritare të paraqitura në strategjinë për shërbimet sociale. Më tej kjo strategji thekson një pjesëmarrje më të madhe të organizatave joshtetërore në financimin dhe kryerjen e shërbimeve si shumë të rëndësishme për ngritjen e cilësisë dhe për vijimësinë e shërbimeve sociale.

3. Strategjia Kombëtare për Fëmijët dhe Plani Kombëtar i Veprimit u miratuan me vendim nr.368 të Këshillit të Ministrave, datë 31 maj 2005, dhe vendim nr. 487 Këshillit të Ministrave, datë 30 qershor 2005. Kjo strategji synon

- të krijojë dhe forcojë kapacitetet institucionale që kërkohen për të vëzhguar zbatimin e legjislacionit dhe të politikave që trajtojnë të drejtat e fëmijëve në Shqipëri;
- t'i bëjë problemet e fëmijëve një shqetësim për këdo;
- të lehtësojë ngritjen e shërbimeve të reja për fëmijët, sidomos për ata që nuk kanë kujdes prindëror e për ata me aftësi të kufizuara, në mënyrë që edhe për ta të krijohen shanse të barabarta;
- t'i përfshijë fëmijët në procesin e mbrojtjes së të drejtave të tyre e të ndërtojë për ta një shoqëri të vlefshme.

Më tej kjo strategji ravigon politikat e mëposhtme përparësore (lidhur me fëmijët pa kujdes prindëror):

- të ngrejë shërbime sociale për fëmijë jetimë, të braktisur, të keqtrajtuar, të shfrytëzuar e të trafikuar, si dhe për ata që punojnë në rrugë;
- t'i aftësojë fëmijët që të jetojnë në një mjedis familjar ose, nëse kjo nuk është e mundur, t'u ofrojë atyre shërbim rezidencial;
- të ngrejë shërbime alternative jointucionale, përfshirë shtëpi familjare në institucione publike dhe jopublike rezidenciale, ndërkohë që të vijohet me çinstitutionalizimin dhe zëvendësimin gradual të qendrave rezidenciale;
- të zhvillojë e të miratojë Ligjin për Kujdestarinë, duke zgjeruar shërbimin e kujdestarisë;
- të nxisë birësimin e fëmijëve të braktisur, sidomos të atyre me probleme shëndetësore, qysh në një moshë të hershme;
- të reformojë sistemin e drejtësisë për të mitur për fëmijët që janë në konflikt me ligjin;
- të riorganizojë shërbimet shumëdisiplinore të ofruara në shkolla (mjekësore, dentale, psikosociale).

Kjo strategji tërheq gjithashtu vëmendjen për ngritjen e zyrës shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Mandati i saj do të jetë vëzhgimi, monitorimi dhe vlerësimi i ushtrimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri si dhe raportimi mbi punën dhe rezultatet e tij. Ajo do të ndihmojë gjithashtu për të bashkërenduar zbatimin e strategjisë.

2.5 Financimi, menaxhimi, administrimi dhe kryerja e shërbimeve të kujdesit social

Ekzistojnë tetë institucione që financojnë, menaxhojnë, administrojnë dhe kryejnë shërbimet sociale për fëmijët pa kujdes prindëror

2.5.1 Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta përgjigjet për zhvillimin e politikave dhe të legjislacionit; për planifikimin e ndihmës ekonomike e shpenzimeve në fonde si dhe për pagimin e personave me aftësi të kufizuara; për kryerjen e shërbimeve sociale; për zhvillimin e normave dhe të standardeve të shërbimeve; si dhe për monitorimin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet në strukturat qendrore dhe vendore si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat.

Në mënyrë që të kryejë funksionet e veta, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta i bashkërendon veprimet e saj me ministritë e institucione të tjera në nivel qendror, të cilat kontribuojnë për zhvillimin e politikave sociale lidhur me të drejtat e fëmijëve. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta punon së bashku me shërbimin shtetëror social dhe institucione të tjera në nivel ekzekutiv për

zbatimin dhe mbikëqyrjen e politikave sociale. Duke u mbështetur mbi informacione të marra nga Shërbimi Social Shtetëror, institucionet e pushtetit vendor dhe studime të ndryshme, MPÇSShB shtron propozime lidhur me politikat aktuale si dhe zhvillon politika të reja.

MPÇSShB përgjigjet për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve publike, zhvillimin e rregulloreve të tyre, trajnimin e personelit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave të tyre midis shtetit dhe agjencive shtetërore dhe joshtetërore për administrimin e institucioneve të kujdesit social.

2.5.2 Shërbimi Social Shtetëror

Shërbimi Social Shtetëror u krijua me vendim nr. 52, datë 8 janar 1996, të Këshillit të Ministrave¹⁸ "Mbi krijimin dhe funksionimin e Këshillit të Përgjithshëm të Ndihmës dhe Përkujdesit Shoqëror dhe Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale dhe ndryshuar emërtimi dhe statusi me VKM Nr.153. Datë 25.04.2002 "Miratimi i Statutit të Shërbimit Social Shtetëror".

Shërbimi Social Shtetëror përgjigjet për zbatimin e politikave të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të ndjekur në fushën e ndihmës ekonomike dhe të kujdesit social. Ky shërbim përgjigjet për:

- Planifikimin e shpenzimeve të buxhetit shtetëror për shërbime sociale dhe monitorimin e përdorimit të tyre.
- Zhvillimin e standardeve të shërbimeve dhe propozime për shërbime të reja.
- Identifikimin e dokumentacionit që kërkohet për aplikuesit dhe për përfituesit e shërbimeve sociale.
- Mbledhjen dhe analizën e informacionit lidhur me zbatimin dhe përdorimin e shërbimeve sociale.
- Analizën e nevojave për shërbime sociale, përfshirë nevojat e grupeve sociale të përjashtuara.

Shërbimi Social Shtetëror drejtohet dhe administrohet nga këshilli administrativ, i cili është organi më i lartë vendimarrës. Degët rajonale dhe lokale nëpër gjithë vendin përkrahin Shërbimin Social Shtetëror në kryerjen e detyrave të veta.

2.5.3 Prefekti

Nga këndvështrimi ligjor prefekti vëzhgon vendimet e këshillave bashkiake dhe komunave lidhur me zbatimin e ndihmës ekonomike, pagesën e përfitimeve për personat me aftësi të kufizuara si dhe shërbimet e kujdesit social. Prefekti mbikëqyr zbatimin e masave

¹⁸ Vlen i njëjti shpjegim si në poshtëshënimin nr. 13*.

administrative të propozuara nga struktura qendrore, rajonale dhe lokale, në mbështetje të legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe shërbimeve sociale.

2.5.4 Pushteti vendor (bashkia/komuna)

Në bazë të ligjit "Mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor" kryerja e shërbimeve sociale për komunitetin është pjesë e misionit të pushtetit vendor. Këshilli bashkiak dhe ai komunal përgjigjet për:

- Miratimin e fondit për pagesën e përfitimeve për personat me aftësi të kufizuara si dhe financimin e shërbimeve sociale;
- Hartimin e planit për zhvillimin e shërbimeve sociale duke u mbështetur mbi burimet lokale, mbi nevojat dhe përparësitë;
- Vendimarrjen, se cilët persona kanë nevojë e çfarë shërbimesh ofrohen në bazë të vlerësimit të nevojave individuale dhe të mundësive financiare për të ofruar shërbime;
- Autorizimin e strukturave të pushtetit vendor për lidhjen e kontratave me ofrues të licensuar të shërbimeve sociale në rastet kur shërbimet e kërkuara nuk ofrohen prej shërbimeve publike sociale;
- Zbatimin e programeve të bashkëpunimit me organizata jofitimprurëse, institucione fetare dhe përfaqësues të shoqërisë civile, në përputhje me ndihmën ekonomike kombëtare dhe rajonale si dhe planet e shërbimeve sociale.

Strukturat kryesore ngrihen në bashki e në komuna me synim administrimin e ndihmës ekonomike dhe të shërbimeve sociale, duke pasur detyrat e përgjegjësitë e mëposhtme:

- të mbledhin informacion mbi rrjetet e shërbimeve publike dhe private që veprojnë në territorin e bashkisë/komunës;
- të mbledhin informacione dhe statistika dhe të shkruajnë raporte lidhur me përfituesit e fondeve të ndihmës ekonomike, të fondeve të paaftësisë dhe të shërbimeve të kujdesit social, si dhe të mbikëqyrin përdorimin e fondeve për këto qëllime.

2.5.5 Institucionet e kujdesit social¹⁹

Institucionet e kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror janë persona juridikë të angazhuar në veprimtari jofitimprurëse nën autoritetin e Shërbimit Social Shtetëror. Funkzioni i tyre përkufizohet nga rregulla të veçanta procedure. Institucionet ofrojnë shërbime si për fëmijë jetimë ashtu dhe për kategori të tjera fëmijësh të konsideruar si "fëmijë me probleme sociale". Institucionet shtetërore të kujdesit social janë në përgjegjësinë e Shërbimit Social Shtetëror. Ndërsa institucionet joshtetërore

¹⁹ Këtu e tutje do të përdoret termi "institucion".

organizohen dhe e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjet në fuqi dhe financohen nga organizata jofitimprurëse e fondacione joshtetërore.

Si institucionet shtetërore ashtu dhe ato joshtetërore menaxhohen dhe administrohen nga Këshilli Administrativ, i përbërë nga 5-7 antarë. Këshilli Administrativ përgjigjet për analizimin e veprimtarive të institucionit, zbatimin e rregullores së brendshme, shqyrtimin e projektplanit për buxhetin dhe zbatimin e programeve që kanë të bëjnë me veprimtari në sektorë të ndryshëm të institucionit. Këshilli gjithashtu mund të largojë drejtorin e institucionit, sikurse parashikohet në rregullore.

Drejtori drejton veprimtaritë e përditshme të institucionit. Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror emëron drejtorët e institucioneve shtetërore, ndërsa Këshilli Administrativ cakton drejtorët e institucioneve joshtetërore. Kriteret e emërimit të drejtorit janë të përcaktuara në rregullat e procedurës. Drejtori është gjithashtu kryetar i Këshillit Administrativ për institucionet shtetërore. Ai përgjigjet për sigurimin e përmbushjes së misionit të institucionit dhe zbatimin e legjislacionit dhe rregullores. Ai përgjigjet për punësimin e gjithë personelit të institucionit në përputhje me kriteret e parashtruara në Kodin e Punës. Personeli i institucionit bën trajnim në mënyrë periodike e sadoherë që e shikon si të nevojshme Shërbimin Social Shtetëror.

Sipas legjislacionit aktual fëmijët e moshave 0-14 vjeç që mund të pranohen në institucione të kujdesit social kategorizohen dhe vendosen si më poshtë:

- Fëmijët 0 deri 3 vjeç vendosen në shtëpitë e foshnjës
- Fëmijët e moshën 3 deri 6 vjeç vendosen në shtëpitë e fëmijës për moshat parashkollore
- Fëmijët 6 - 14 vjeç vendosen në shtëpitë e fëmijës për fëmijë të moshës shkollore.

Për t'u pranuar në institucione kërkohen këto dokumenta

- çertifikata e lindjes së fëmijës
- fotografia e fëmijës
- çertifikata e familjes së fëmijës
- çertifikata e vdekjes së prindërve
- vendimi i gjykatës për zhvendosje të së drejtës prindërore
- historia mjekësore
- urdhëri i transferimit të fëmijës në rast se ndodh zhvendosje nga një institucion në një tjetër
- protokollin e transferimit të fëmijës nga materniteti në një shtëpi fëmije
- çertifikata e shkurorëzimit të prindërve në rast se ata janë të shkurorëzuar
- dokumenti nga shkolla që ka ndjekur fëmija
- miratimi me shkrim i prindit ose i kujdestarit ligjor për vendosjen e fëmijës në një institucion

Fëmijët vendosen në institucione në mënyrë të përkohshme ose të përhershme.

Institucionet përgjigjen për organizimin dhe dhënien e shërbimeve që ndihmojnë në mirërritjen, arsimimin, zhvillimin psikologjik dhe social, zhvillimin fizik e shëndetësor, si dhe riintegrimin social të fëmijës. Sipas legjislacionit aktual, fëmijët pa kujdes prindëror ndjekin sistemin e detyrueshëm arsimor kombëtar.

Institucionet mund të kenë një status rezidencial ose ditor. Institucionet rezidenciale janë struktura të hapura që ofrojnë strehim dhe një mjedis edukues, në përputhje me zakonet e Shqipërisë. Qendrat rezidenciale kanë status kombëtar. Disa institucione rezidenciale mund të jenë gjithashtu me bazë vendore ose komunitare dhe ofrojnë pothuajse të njëjtat shërbime, veçse për një numër më të vogël fëmijësh e duke mbuluar një territor të kufizuar. Institucione rezidenciale japin shërbime përgjatë gjithë kohës e gjithë vitit. Numri i klientëve në këto qendra varet nga kapacitetet e tyre, por në përgjithësi nuk është më i vogël se 10.

Institucionet vendore administrohen nga pushteti vendor ose organizatat jofitimprurëse. Institucionet me bazë komunitare (qendra sociale të komunës) administrohen kryesisht prej organizatash jofitimprurëse.

2.5.6 Qendrat e zhvillimit

Qendrat e zhvillimit²⁰ janë persona juridikë që kryejnë veprimtari jofitimprurëse nën autoritetin e Shërbimit Social Shtetëror. Këto qendra financohen nga shteti; ose bashkëfinancohen nga organizata jofitimprurëse, sipas legjislacionit. Funksonimi i tyre përcaktohet nga rregullore të veçanta. Qendrat shtetërore janë nën përgjegjësinë e Shërbimit Social Shtetëror, ndërsa qendrat joshtetërore ngrihen dhe e drejtojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjet në fuqi, duke u financuar nga organizata jofitimprurëse dhe fondacione joshtetërore. Qendrat e zhvillimit pranojnë fëmijë me aftësi të kufizuara mendore, fizike dhe shqisore. Veprimi i vendosjes së personave me aftësi të kufizuara në "Qendrat e zhvillimit" është përgjegjësi e një komisioni të veçantë; kriteret e pranimit dhe rregullorja për komisionin vendosen nga drejtori kryesorë në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Në shqyrtimin e pranimit komisioni merr parasysh mendimin e familjes dhe të drejtat e personit me paftësi.

Menaxhimi, administrimi dhe financimi i qendrave janë të njëjtat si për institucionet e kujdesit social. Funksonet e këshillit administrativ dhe të drejtorit janë po ashtu të njëjta.

Çdo qendër ka një profil të veçantë, në varësi nga mosha e fëmijëve që pranohen e nga tipi e shkalla e paftësisë që ato trajtojnë. "Lehtësimi i vështirësive me të cilat përballen fëmijët në procesin e integritit të tyre në jetën shoqërore dhe nxitja e autonomisë së tyre vetjake" janë parimet themelore të këtyre qendrave. Qendrat e

²⁰ Në vijim do të përdoret termi „qendër“.

zhvillimit ofrojnë shërbime mjekësore, psikologjike, sociale dhe arsimore, si dhe shërbime administrative; personeli i tyre caktohet në përputhje me këto.

Procesi i rehabilitimit zë një vend qendror. Forma kryesore e procesit të rehabilitimit është puna me personin me paaftësi sipas një plani individual arsimues. Programi individual arsimues u përshtatet nevojave të çdo fëmije dhe nivelit të zhvillimit. Fëmija mund të vendoset në një qendër të tillë deri në moshën 18-vjeçare.

Qendrat e zhvillimit mund të kenë një status rezidencial ose ditor. Ashtu si për institucionet e kujdesit social, qendrat e zhvillimit rezidenciale janë struktura të hapura që ofrojnë strehim dhe mjedis edukues, në përputhje me traditat e Shqipërisë. Qendrat rezidenciale kanë një status kombëtar. Qendrat ditore të zhvillimit nuk ndryshojnë nga qendrat rezidenciale përsa i takon legjislacionit, administrimit, programeve ose shërbimeve. Për shkak të orëve të kufizuara të hapjes, qendrat ambulante të zhvillimit kanë më shumë një klientelë të kufizuar gjeografikisht, me fëmijë që jetojnë në lagje të afërme.

Qendrat ambulante të zhvillimit mund të jenë lokale ose me bazë komunitare, dhe ofrojnë të njëjtat shërbime si institucionet rezidenciale, por ndaj një numri më të kufizuar fëmijësh e duke mbuluar një territor të kufizuar.

Qendrat e zhvillimit përfshijnë gjithashtu institucione arsimuese e rehabilituese për fëmijë me nevoja të veçanta (fëmijë që kanë të meta në shikim ose dëgjim ose me paaftësi të vogla zhvillimore). Këto institucione janë të ngjashme me shkollat përsa u takon kurrikulave dhe mënyrave se si organizohen dhe si veprojnë. Sidoqoftë ato zbatojnë edhe kurrikula të veçanta në përshtatje me nivelin e paaftësive dhe nevojave të fëmijëve. Këto institucione kanë një status kombëtar dhe rezidencial. Ato janë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencave, e cila udhëheqës si metodologjinë ashtu dhe kurrikulat e tyre.

2.5.7 Persona juridikë privatë dhe organizata jofitimprurëse

Personat privatë juridikë dhe organizatat jofitimprurëse mund të ofrojnë gjithashtu shërbime të kujdesit social. Statusi i tyre juridik drejtohet nga udhëzimi nr. 1321, datë 3 dhjetor 2003, i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Ky udhëzim ka dalë në lidhje me nenin 102, pika 4 e Kushtetutës dhe nenin 34 të ligjit nr. 8788, datë 7 maj 2001, "Për organizatat jofitimprurëse", si dhe në pikat 4/s dhe 10 të vendimit nr. 307, datë 24 maj 1994, i këshillit të ministrave, "Për shërbimet e përkujdesjes shoqërore". Në bazë të këtij udhëzimi persona privatë juridikë shqiptarë e të huaj, përfshirë organizata jofitimprurëse, mund të ofrojnë shërbime të kujdesit social pasi të kenë marrë një licencë të veçantë nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta; dhënia e kësaj licence vendoset nga një komision i veçantë.

Kërkohej licencë e veçantë për dhënien e shërbimeve të mëposhtme për fëmijët pa kujdes prindëror:

- Kujdes rezidencial për fëmijë me probleme sociale
- Qendra zhvillimi për fëmijë me paaftësi
- Kujdes ditore social për fëmijë me probleme sociale
- Këshillim psikosocial
- Kujdes në shtëpi,
- Qendra të riaftësimit

Entet aplikuese duhet të përmbushin kriteret e paraqitura në legjislacion, të cilat mbështeten mbi konventa ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë. Veprimtaria organizohet, menaxhohet dhe administrohet në përputhje me pikat e kontratës së lidhur midis entit aplikues dhe entit miratues (Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta). Veprimtaritë e entit vëzhgohen nga ministria, sipas kontratës.

Rekomandohet që misionit dhe rolit të këtyre institucioneve t'u jepet një përmasë e re. Duhet të përfshihen komuniteti dhe pushteti vendor në identifikimin e fëmijëve në nevojë, dhe këto duhet të bashkëpunojnë me institucionet në mënyrë që të sigurohet dhënia e shërbimeve për të cilat kanë nevojë më shumë fëmijët. Veçanërisht pushteti vendor dhe komuniteti si dhe faktorë të tjerë me peshë duhet të bashkëpunojnë me institucionet rezidenciale për të gjetur një familje mikpritëse për fëmijët. Në këtë kontekst emri i institucioneve mund të ndryshohet në "Shtëpi të përkohshme për fëmijët".

2.5.8 Komiteti shqiptar i birësimeve

Komiteti Shqiptar i Birësimit është organi administrativ shtetëror më i lartë i veshur me autoritetin e plotë për të trajtuar birësimin e fëmijëve të braktisur si në nivel kombëtar ashtu dhe ndërkombëtar. Ai u ngrit në bazë të ligjit nr. 7650, datë 17 dhjetor 1992, "mbi birësimet". Ky ligj njeht ngritjen dhe funksionimin e këtij komiteti si dhe përbërjen e tij si një trupë kolektive të përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencave, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, Ministrisë së Jashtme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, Fakultetit Juridik (që është autoriteti lidhur me Ligjin e Familjes) dhe një përfaqësues nga Shoqata e Jetimëve. Së bashku këta përfaqësues përbëjnë bordin e komitetit. Zhvillimi dhe zbatimi i ligjit nr. 7650, datë 17 dhjetor 1992, i parapriu hyrjes së Shqipërisë në Konventën e Hagës "Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin lidhur me birësimet ndërshtetërore". Mbi bazë të këtij ligji birësimi lejohet të bëhet vetëm kur ai është në interesat më të mirë të fëmijës. Ligji përmban përcaktime që i japin këto fuqi themelore Komitetit të Birësimit:

- Ai pranon aplikimet që bëjnë familjet shqiptare ose të huaja të cilat dëshirojnë të birësojnë fëmijë në Shqipëri dhe u jep atyre ndihmë për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm;
- Harton listat e fëmijëve që mund të birësohen brenda dhe jashtë vendit;
- Bashkëpunon me autoritetet lokale e të huaja, publike dhe private për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve;
- Përcakton dhe merr informacion lidhur me aktet ligjore dhe procedurat kryesore të organizmave private ndërkombëtare me të cilat do të bashkëpunojë në kryerjen e birësimeve.

Sipas legjislacionit në fuqi birësimi është i pakthyeshëm.

2.6 Programet ekzistuese dhe shërbimet e kryera

2.6.1 Mbrojtja, përkrahja dhe integrimi shoqëror i fëmijëve me aftësi të kufizuara

Sipas legjislacionit në fuqi fëmijët me aftësi të kufizuara marrin përfitime në të holla për paaftësitë e tyre (pagesë paaftësie) dhe shërbime të kujdesit social. Kjo pagesë u akordohet personave të lindur me aftësi të kufizuara ose atyre që janë bërë të paaftë përpara moshës 21 vjeç (24 vjeç për ata që ndjekin arsimin e lartë). Pagesa mujore është e njëjtë për të gjithë individët që kanë ligjërisht të drejtë për të: 70 për qind e rrogës minimale zyrtare. Ajo akordohet pavarësisht nga nevojat e veçanta të individëve (vendim nr. 311, datë 11 korrik 1994, i Këshillit të Ministrave, përmirësuar me VKM nr. 457, datë 21 gusht 1995 dhe udhëzimin nr. 12, datë 16 qershor 1996).

Me qëllim që të nxitet integrimi i personave me probleme zhvillimore në jetën sociale dhe ekonomike pagesa është rritur në 200 për qind për fëmijët që ndjekin arsimin e mesëm dhe 300 për qind për ata që ndjekin arsimin e lartë.

Shërbimet e kujdesit social për fëmijë me aftësi të kufizuara ofrohen në qendrat rezidenciale të zhvillimit, qendrat ditore të zhvillimit dhe në institucione arsimore për fëmijë me probleme të veçanta (paaftësi dëgjimi, shikimi dhe të foluri).

2.6.2 Mbrojtja, përkrahja dhe integrimi shoqëror i fëmijëve me probleme sociale

Konsiderohen si fëmijë me probleme sociale të gjithë ata fëmijë që përcaktohen si të tillë në Kodin e Familjes.

Fëmijët që mund të përfitojnë shërbime sociale në sistemin aktual kategorizohen si më poshtë:

- "Jetimë biologjikë - fëmijë prindët e të cilëve nuk jetojnë e të cilët nuk kanë të afërm të tjerë që të kujdesen për ta";

- "Jetimë socialë - fëmijë të lindur jashtë martesë, të cilët në rrethana të caktuara, nuk mund të rriten prej nënave të tyre; fëmijë të braktisur - kur një prind refuzon kujdesin për fëmijën e tij, duke ndërprerë kështu marrëdhëniet prind-fëmijë në një mënyrë të pakthyeshme e të vetëdijshme (fëmijët braktisen në maternitetet prej familjesh në krizë morale ekonomike e shëndetësore ose prej prindësh që ikin për në vende të tjera); fëmijë që mbeten përkohësisht pa prindër (prindët e tyre janë në spital, burg ose të sëmurë rëndë); fëmijë prej familjesh pa asnjë të ardhur, ose me të ardhura të pamjaftueshme; fëmijë prej familjesh në krizë si dhe fëmijë prindët e të cilëve kanë emigruar ose dëshirojnë të emigrojnë.

Programet për mbrojtjen, përkrahjen dhe integrimin e fëmijëve në këto kategori ofrojnë shërbime sociale në institucionet kombëtare rezidenciale, institucionet lokale rezidenciale, shtëpi, komunitet, familje birësuese dhe familje tutore.

Birësimi është më i zakonshëm në fëmijë të vegjël që kanë humbur familjet e tyre natyrore. Kuadri ligjor ka disa norma e kritere të reja që drejtojnë zgjedhjen e familjeve birësuese e që marrin parasysh kushtet e tyre ekonomike e sociale, përshtatshmërinë me fëmijën dhe harmonizimin e karaktereve të tyre. Këto norma dhe kritere janë në përputhje të plotë me KDF. Kujdesi i një familjeje të huaj është një masë alternative për fëmijë që kanë qenë të ndarë prej familjeve të tyre natyrore. Kjo formë është zhvilluar vetëm në vitet e fundit, si në vështrim ligjor ashtu edhe institucional.

2.7 Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve

2.7.1 Procesi i monitorimit dhe i vlerësimit

Monitorimi dhe vlerësimi i politikave sociale për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror synon që:

- Të identifikojë problemet më kritike dhe dobësitë institucionale që ka zbatimi i kuadrit ligjor;
- Të hartojë programe zhvillimore të përqendruara, me synim ngritjen e efektivitetit të politikave sociale;
- Të sugjerojë politika të realizueshme, bashkëkohëse e të përshtatshme sociale sipas nevojave.
- Duke u nisur nga këta objektiva, vrojtimi e monitorimi ushtrohen në fushat e mëposhtme:
 - Zbatimi i misionit dhe rregulloreve të institucioneve të shërbimeve sociale dhe përputhshmëria me legjislacionin
 - Zbatimi i standardeve të shërbimeve sociale
 - Aplikimi i kritereve për punësimin dhe nxitjen profesionale në sistemin e shërbimit social

- Hartimi i buxheteve dhe mënyra se si ato ekzekutohen
- Licencimi i personave fizikë dhe juridikë dhe i organizatave jofitimprurëse që do të kryejnë shërbimet; respektimi i termave të marrëveshjes.

Institucionet e mëposhtme mbikqyrin dhe shqyrtojnë mënyrën se si operon sistemi i shërbimit social:

Ministria e Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të barabarta përgjigjet për monitorimin dhe zbatimin e standardeve të shërbimit social. Për këtë qëllim, Ministria e Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të barabarta ka inspektoriatin e asistencës ekonomike dhe pagimit të personave me paaftësi, i cili kontrollon zbatimin e legjislacionit në strukturat e pushtetit lokal. Ajo ka gjithashtu inspektoriatin e shërbimit social, i cili përgjigjet për monitorimin dhe sigurimin e zbatimit të standardeve në të gjithë ofruesit publikë dhe privatë të shërbimeve sociale.

Shërbimi Social Shtetëror monitoron punën e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore të kujdesit social për fëmijët me probleme sociale. **Shërbimi social shtetëror** mbledh dhe analizon informacionin, statistikën dhe raportet prej njësisive të pushtetit lokal. Përfundimet e nxjerra nga këto analiza përdoren për të propozuar politika të reja që plotësojnë më mirë nevojat e individëve dhe grupeve në nevojë ose të rrezikuara.

Avokati i Popullit, ngritur në vitin 2000, është një institucion i pavarur i cili mbikqyr mënyrën se si ushtrohen e respektohen të drejtat e njeriut në Shqipëri. Nënseksioni që përgjigjet për të drejtat e fëmijëve, i ngritur kohët e fundit, vëzhgon dhe vlerëson efektivitetin e politikave sociale të hartuara për mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijëve pa kujdes prindëror. Sidoqoftë mundësitë e tij financiare dhe të burimeve njerëzore janë të kufizuara.

Kohët e fundit qeveria miratoi ngritjen e **Zyrës shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve**. Misioni i saj është të vlerësojë dhe raportojë problemet kritike që lidhen me të drejtat e fëmijëve në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve pa kujdes prindëror në veçanti; po ashtu të njoftojë vendimarrësit dhe publikun. Kjo do të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes publike dhe institucionale lidhur me detyrimet e shtetit dhe shoqërisë për të mbrojtur dhe integruar shoqërisht fëmijët pa kujdes prindëror; gjithashtu sesa i përmbush shteti dhe shoqëria këto detyrime.

2.8 Çështje kritike lidhur me thelbin dhe zbatimin e programeve të shërbimeve sociale

Shërbimet sociale nuk janë efikase në inkurajimin dhe aftësimin e përfituesve të tyre që të ndryshojnë statusin e vet; ato më shumë organizohen për të dhënë përfitime dhe shërbime bazë. Ato nuk bashkëpunojnë dhe nuk bashkërendohen me sisteme të tjera të kujdesit social. Kanë gjithashtu edhe mangësitë e mëposhtme:

- mospërputhje me nevojat për shërbimet që ka klienti
- pamjaftueshmëri e shërbimeve të përqendruara në integrimin social
- shpërdorim i burimeve njerëzore dhe financiare
- menaxhim i centralizuar, i cili lë pak hapësirë vendimmarrje për pushtetin lokal dhe komunitetin
- një burim financimi: buxhetin e shtetit.

Shërbimet sociale bëjnë pak për të parandaluar dukurinë negative që ndodh me humbjen e kujdesit prindëror. Veç kësaj është i varfër bashkëpunimi midis institucioneve arsimuese dhe atyre të kujdesit shëndetësor si dhe institucioneve që ofrojnë shërbimet sociale për fëmijët pa kujdes prindëror, duke kufizuar kështu mundësitë për zbatimin e një programi që përqendrohet në integrimin social dhe në zhvillimin e fëmijës.

Sistemi aktual ende nuk i ofron gjithë ato shërbime për të cilat kanë nevojë fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror. Më tej sasia e shërbimeve që ofrohen është e pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat, për shkak se numri i fëmijëve në nevojë e kapërcen numrin e atyre që përfitojnë aktualisht shërbime.

Shërbimet sociale në një masë të madhe kryhen nga institucionet rezidenciale, çka nuk është në përputhje me qëndrimin bashkëkohor i cili rekomandohet për trajtimin e tyre dhe integrimin në shoqëri. Ky qëndrim në institucione shpjegohet pjesërisht nga orientimi profesional i personelit të shërbimeve sociale dhe mungesa e një trajnimi profesional bashkëkohor për ta. Për shembull personeli rezidencial nuk e njeh mirë punën këshilluese, ndërmjetësuese, përdorimin e psikologjisë e punën sociale si mjete që e ndihmojnë fëmijën të kapërcejë një krizë e të riintegrohet në shoqëri. Fakulteti i Punës Sociale u ngrit mbas viteve 1990 por megjithatë punonjësit socialë dhe psikologët që diplomohen në të nuk duket se janë shumë të motivuar për t'u përqendruar tek klienti individual dhe vazhdojnë të punojnë me mënyra të kapërcyera qasjeje.

Sado që ka hapësirë ligjore për përfshirjen e pushtetit lokal në menaxhimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, sistemi mbetet i centralizuar në një masë të madhe. Ministria e Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të barabarta si dhe Shërbimi Social Shtetëror vazhdojnë të bëjnë ligjin në financimin, menaxhimin dhe administrimin. Sektori jofitimprurës ka një rol të dobët e të kufizuar, çka shpjegohet në një masë të madhe nga fakti se buxheti është ende i centralizuar. Buxhetet lokale janë të vogla, ndërsa Fondi Social ende nuk është krijuar.

Mbizotërojnë përfitimet në të holla. Kjo pasqyron faktin që asistenca ekonomike e cila ndihmon për të lehtësuar varfërinë, është bërë çështje parësore në krahasim me administrimin e asistencës sociale dhe ofrimin e shërbimeve zhvilluese e rehabilituese.

Ndërkohë që përfitimet në të holla mund të merren kudo në vend, mbulimi gjeografik i shërbimeve institucionale është i kufizuar.

Ka ende zbrazëti të mëdha informacioni lidhur me shtrirjen e shpërndarjen e individëve në nevojë dhe të rrezikuar. Ky problem pjesërisht lidhet me mungesën e një bashërendimi ndërinstytucional, çka e bën të vështirë të identifikohen e të lokalizohen individët e rrezikuar ose në nevojë, të analizohen shkaqet e vështirësive të tyre e të planifikohen ndërhyrje efikase për mbrojtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijëve pa kujdes prindëror.

2.9 Rekomandime për të ardhmen e sistemit të kujdesit social të projektuar për fëmijët pa kujdes prindëror

Sistemi aktual i ndihmës ekonomike dhe i kujdesit social i projektuar për fëmijët pa kujdes prindëror nuk arrin t'u përgjigjet nevojave të shoqërisë shqiptare në përgjithësi dhe nevojave të grupeve të përjashtuara në veçanti. Ky sistem nuk ofron ndihmë dhe shërbime për grupe të reja fëmijësh dhe familjesh të rrezikuara e në nevojë që kanë dalë gjatë tranzicionit në një ekonomi të tregut të lirë dhe të demokracisë liberale. Ai nuk arrin as të lehtësojë riintegrimin dhe zhvillimin social.

Sistemi po reformohet. Strategjia kombëtare për shërbimet sociale është përgatitur tashmë, ndërkohë që është miratuar ligji për Shërbimet Sociale. Strategjia kombëtare për shërbimet sociale, e cila përputhet plotësisht me objektivat që përmbahen në Strategjinë kombëtare për Zhvillimin Ekonomik e Social dhe në Planin kombëtar të veprimit për fëmijët, synon të ndërtojë një sistem bashkëkohës dhe efektiv të shërbimeve sociale, që ofron shërbime cilësore të mbështetura mbi nevojat.

Sistemi i ri i shërbimeve sociale do të mbështetet mbi shtrirjen e decentralizuar të shërbimeve parandaluese dhe riintegruese në komunitete, të ofruara në gjithë territorin, sa më afër individëve që të jetë e mundur e në përshtatje me nevojat e tyre. Sistemi i ri i shërbimeve sociale për fëmijët pa kujdes prindëror do të mbështetet mbi parimin e "interesave më të mira të fëmijës". Për rrjedhim do të ketë një përqendrim të fortë në kthimin e fëmijëve në familjet e tyre burimore aty ku është e mundur; ose të gjenden familje tutore apo birësuese.

Shërbimet do të rriten si numër, cilësia e tyre do të ngrihet. Ndër kategoritë përfituese do t'u kushtohet vëmendje e veçantë fëmijëve jetimë (biologjikë ose socialë); fëmijëve me paaftësi mendore dhe fizike; fëmijëve që kanë qënë trafikuar dhe/ose keqtrajtuar; dhe fëmijëve që punojnë në rrugë.

Sistemi i ri do të ketë për synim shndërrimin e institucioneve rezidenciale nga qendra të mbyllura në qendra moderne dhe të hapura. Sistemi i ri do të ofrojë forma alternative: krahas formës rezidenciale (e cila do të ketë një status të përkohshëm), shërbimet sociale

do të ofrohen gjithashtu në komunitete ose në familje (kjo formë gradualisht do të bëhet më e rëndësishme).

Ja elementet thelbësore të reformës së re:

- Klientë që çinstitucionalizohen
- Shërbime që decentralizohen
- Ofrimi i shërbimeve të integruara
- Dhënia e shërbimeve në komunitet dhe në familje
- Ngritja e efektshmërisë së bashkëpunimit dhe koordinimi i burimeve të qeverisë qendrore me ato të pushtetit vendor dhe organizatave jofitimprurëse.

Me qëllim që të përmirësohen shërbimet sociale rekomandohet që të ngrihen qendrat dhe shërbimet e mëposhtme:

- Qendra të kujdesit ditor, të cilat do të japin trajtim mbështetës dhe psikosocial, arsimim dhe këshillim për fëmijët që punojnë në rrugë për fëmijë të keqtrajtuar ose të abuzuar dhe për fëmijë që kanë braktisur ose janë gati të braktisin shkollën.
- Qendra banimi (shtëpi), të cilat do të ofrojnë strehim të përkohshëm për fëmijë që riatdhesohen, përfshirë fëmijët që kthehen pasi kanë pasë emigruar të pashoqëruar nga prindët e tyre si dhe për fëmijët viktime të prostitucionit
- Qendra rehabilitimi të cilat japin trajtim psikosocial, këshillim dhe trajnim profesional për të rinj e fëmijë viktime të drogave dhe të alkoolit, me synim riintegrimin e tyre në një jetë normale.
- Familje dhe qendra të kujdesit ditor, të cilat do t'i shtrijnë shërbimet e tyre në fëmijë me paaftësi ose jetimë që janë larguar nga institucione rezidenciale të kujdesit social dhe në fëmijë prej familjesh me probleme sociale.
- Qendra për këshillim ligjor, të cilat do të trajtojnë çështje ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve jetimë ose të fëmijëve me probleme sociale.
- Qendra shumëfunktionale, të cilat ofrojnë një spektër të gjerë shërbimesh, përfshirë këshillimin ligjor, mbështetjen psiko-sociale, asistencën nëpër familje dhe kurse të trajnimit profesional, gjithashtu dhe informacion lidhur me asistencën që jepet në raste të situatave të jashtëzakonshme ku përfshihet edhe një shkallë jo e vogël rreziku.
- Mbikëqyrja (përkujdesja nga familje tutore) është një nga zgjidhjet më të mira afatshkurtëra e afatmesme që mund t'i ofrohet një fëmije që jeton në një familje me probleme ekonomike e sociale ose një fëmije të lindur jashtë martese e që nuk dëshirohet nga familja e tij biologjike. Vendosja e këtyre fëmijëve në familje mikpritëse që janë të gatshme t'i mbajnë ata aq gjatë sa do të jetë e nevojshme, i ndihmon ata të kthehen në atmosferën e jetesës në një familje normale.
- Birësimi, që shihet si alternativa më e mirë për fëmijët e braktisur dhe për fëmijët prindët e të cilëve nuk njihen ose kanë vdekur.

Duke u mbështetur mbi rekomandimin e Komitetit të OKB për të Drejtat e Fëmijës, shihen si prioritete themelore çështjet e mëposhtme:

1. Vazhdimi i reformës ligjore krahas rritjes së përpjekjeve për zbatimin e saj;
2. Sigurimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qendror e lokal, me synim ngritjen e efektshmërisë institucionale;
3. Mbështetja e pjesëmarrjes së pushtetit vendor në zhvillimin e zbatimit e politikave sociale të hartuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
4. Ngritja e një sistemi modern të bazës së të dhënave, e cila do të maste mirëqenien sociale të fëmijëve, sidomos të atyre që u përkasin grupeve të përjashtuara shoqërisht;
5. Ngritja e vetëdijes publike lidhur me rëndësinë e pjesëmarrjes në procesin vendimmarrës.

Kapitulli 3.

Vlerësimi i standardeve dhe i cilësisë së shërbimeve që ofrohen nën programet e kujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror

- Shërbimet e kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror
- Standardet e institucioneve rezidenciale për fëmijët pa kujdes prindëror
- Kujdesi për fëmijët në familje tutore për fëmijë pa kujdes prindëror
- Përfundime

3.1 Shërbime të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror

3.1.1 Birësimi

Birësimi është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Birësimeve. Ky është organi më i lartë administrativ që ka mandatin të mundësojë birësime kombëtare dhe ndërkombëtare fëmijësh të braktisur.

Qëllimi i birësimit. Birësimi kërkon në radhë të parë të mbrojtë të drejtat e një fëmije të braktisur ose jetim për të jetuar në një familje. Ai kryhet në bashkëpunim me autoritetet kompetente publike dhe me organizma shqiptare ose të huaja private me akreditimin e duhur. Programi mundëson vendosjen e fëmijëve të braktisur në një familje të përhershme përmes institucionesh kombëtare (Komiteti Shqiptar i Birësimeve²¹ dhe institucione ndërshtetërore për birësimet.

Parimi i interesave më të mira për fëmijën. Birësimi është alternativa më e mirë për kujdesin që shtrihet në fëmijë të braktisur ose jetimë, ngaqë ai respekton plotësisht parimin e interesave më të mira të fëmijës, duke njohur të drejtën e tij për t'u rritur në një mjedis familjar. Në procesin e birësimit i kushtohet vëmendje e veçantë shëndetit të fëmijës dhe mirëqenies së tij emocionale, duke gjetur për të një mjedis familjar që të mund t'i ofrojë fëmijës sa më shumë dashuri, siguri, ushqim, kujdes mjekësor dhe arsimim që të jetë e mundur. Birësimet praktikoheshin edhe para vitit 1990; ato realizoheshin përmes gjykatave. Por një pjesë e këtyre birësimeve rezultoi problematike (si për fëmijët ashtu dhe për prindët birësues), meqë mungonte një vlerësim i vërtetë i familjes birësuese nga punonjësit socialë dhe psikologët.

Gjatë procesit të birësimit marrin përparësi nevojat e fëmijëve dhe mundësitë e familjes shqiptare. Vlerësimi i familjeve të përshtatshme birësuese kalon nëpër disa

²¹ Këtu e tutje do të përdoret për këtë termi "Komiteti"

etapa, duke përfshirë: pjesëmarrje të detyrueshme në trajnim profesional, përgatitje të dokumentave dhe intervistim i familjes aplikuese. Bëhet një listë e shkurtër e familjeve që mund të ofrojnë kushtet e nevojshme ekonomike, sociale, arsimuese e kulturore, me qëllim që të arrihet rritja dhe edukimi më i mirë i mundshëm për fëmijën. Pastaj zgjidhet familja kandidate. Numri i madh i familjeve shqiptare ose të huaja që mund të aplikojnë i japin mundësi Komitetit Shqiptar të Birësimeve të zgjedhë ato familje që janë në gjendje t'i plotësojnë më mirë nevojat e fëmijës.

Birësimet ndërshtetërore bëhen vetëm me vendet të cilat e kanë ratifikuar Konventën e Hagës. Aktualisht Shqipëria ka lidhur marrëveshje birësimesh me 5 shtete: Italinë, Francën, Kanadanë, Maltën dhe SHBA. Disa organizma janë autorizuar nga shtetet e tyre respektive që të mbulojnë veprimtari ndërshtetërore birësimesh me Shqipërinë, përfshirë *AiBi*, *Sant'Egidio* dhe *SPAI* në Itali, *Medicins du Monde* në Francë, *Bethamy Christian Services* dhe *International Children Alliance* në SHBA si dhe Departamentin e Çështjeve Sociale e Familjare në Maltë.

Birësohen fëmijët e braktisur. Deklarata e braktisjes është një akt ligjor që mbështetet mbi faktorët socialë, psikologjikë e juridikë. Aty ku gjykata e gjen të pamundur që familja e mirëfilltë të kujdeset për fëmijën, ajo e deklaron fëmijën të braktisur. Një fëmijë mund të deklarohet i braktisur me lindjen e tij kur braktiset nga nëna në maternitet ose spital e nuk mund të përcaktohet identiteti i nënës. Në këto raste foshnjat merren nën kujdes social nga institucionet e duhet të kalojnë 3 muaj derisa fëmija të deklarohet ligjërisht i braktisur. (Kodi i Familjes) Një gjykatë e shpall fëmijën e vendosur në institucionet e kujdesit për fëmijën "të braktisur ligjërisht", edhe në qoftë se familja e tij e mirëfilltë (apo së paku e ëma) njihet, kur fëmija nuk ka asnjë lloj kontakti me prindët e tij për një periudhë mbi 6-mujore dhe pasi merret kërkesa nga drejtuesi i institucionit. Kur fëmija vendoset në një institucion të kujdesit social për fëmijë nga familja e vet, fëmija mund të shpallet ligjërisht i braktisur nga familja e vet vetëm pasi të ketë kaluar një vit në institucion dhe vetëm në qoftë se gjatë kësaj kohe prindërit e tij qartazi nuk kanë treguar asnjë interes për të. (Sipas Kodit të Familjes mungesa e interesimit të prindërve për fëmijën do të thotë që prindët vullnetarisht nuk i japin fëmijës afeksionin e nevojshëm për mirërritjen dhe kanë treguar një shpërfillje serioze në ushtrimin e së drejtës së tyre prindërore.

Procesi i birësimit. Deklarata ligjore e braktisjes është hapi i parë. Pas kësaj institucioni përkatës jep një informacion të hollësishëm për zhvillimin fizik, mendor dhe emocional të fëmijës, si dhe gjendjen shëndetësore të tij për Komitetin Shqiptar të Birësimeve e pas kësaj fëmija regjistrohet në listën e birësimeve.


Komiteti Shqiptar i Birësimeve pas kësaj ka 6 muaj kohë të rregullojë birësimin e fëmijës në një familje shqiptare. Në qoftë se kjo del e pamundur atëherë mund të rregullohet një birësim ndërshtetëror. Në vitet e fundit ka pasur një reduktim të kohës që kërkohet për fëmijën që të shpallet "i braktisur" e të zhvendoset nga institucioni në një

familje birësuese. Është shumë e vështirë të gjendet një familje birësuese për fëmijë me aftësi të kufizuara. Për këtë arsye kërkohet një kohë më e gjatë për gjetjen e një familje birësuese sesa zakonisht për fëmijë të tjerë.

Me qëllim që të respektohet parimi i interesave më të mira të fëmijës, ekspertët e Komitetit Shqiptar të Birësimeve kryejnë një vlerësim psikosocial të familjes nëpërmjet intervistash dhe vizitash në shtëpi; gjejnë familjen kandidate birësuese dhe e mbajnë atë të informuar; studiojnë gjithashtu situatën e fëmijës së braktisur dhe origjinën e tij. Në bazë të gjetjeve të tyre ekspertët shkruajnë një raport të plotë mbi fëmijën e braktisur dhe familjen kandidate birësuese.

Diagrami 2 Skema e procesit të birësimit

Figure 4 Skema e procesit të birësimit



Procedurat për vendosjen e një fëmije në një familje birësuese:

1. Vendosja e fëmijës në një institucion
2. Paraqitja e dokumentacionit në gjykatë për marrjen e vendimit mbi shpalljen e fëmijës së braktisur.
3. Kalimi i vendimit të gjykatës në institucionin përkatës të kujdesit për fëmijën dhe tek Komiteti Shqiptar i Birësimeve.
4. Plotësimi i dosjes së birësimit me të dhëna dhe gjykime mbi fëmijën dhe prindin kandidat birësues; zgjedhje e familjes kandidate birësuese.
5. Paraqitja gjykatës për marrjen e vendimit e dokumentacionit të plotë (si për fëmijën ashtu dhe për familjen kandidate birësuese).
6. Vendimi i gjykatës mbi birësimin.
7. Vendimi i dorëzohet familjes birësuese.
8. Fëmija merret nga familja birësuese.
9. Kontroll i pasbirësimit.

Probleme me programin e birësimit. Fakti që 8 në çdo 10 fëmijë të birësuar nga familje shqiptare janë nën 3 vjeç dëshmon se është shumë e vështirë të gjesh një familje birësuese shqiptare për fëmijë nën moshën 3 vjeç. Po kështu familjet shqiptare i tremben birësimit të fëmijëve me probleme shëndetësore ose paaftësi, duke pasur parasysh nivelin aktual të kujdesit shëndetësor në vend dhe shërbimet rehabilituese, si dhe koston e lartë të kujdesit për fëmijë të tillë. Familjet e huaja janë më të gatshme të birësojnë fëmijë të sëmurë dhe me paaftësi: 6 në çdo 8 fëmijë që birësohen nga të huajt janë fëmijë mbi moshën 3 vjeç, me probleme shëndetësore ose aftësi të kufizuara.

Kutiza 2

Vetëm birësimi në një familje i dha atij mundësi për një jetë e për një të ardhme normale

Eltoni

Eltoni është një fëmijë që sot jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai u birësoi në një familje amerikane me 5 fëmijë. Eltoni është fëmija i tyre i gjashtë. Tre vjet më parë Eltoni jetonte në një nga institucionet rezidenciale publike. Ai ishte i sëmurë qysh përpara lindjes dhe sëmundja e tij nuk mund të kurohej në Shqipëri; kjo sëmundje kish përfaqësuar një rrezik dhe jeta e tij ishte në rrezik. Eltoni kish qenë braktisur e nuk mund të gjendej një familje shqiptare që ta birësonte për shkak të problemeve të tij serioze me shëndetin dhe të shtrenjtë. Pas një pune të madhe kërkuese e përzgjedhëse Komiteti Shqiptar i Adoptimeve dhe agjencia Aleanca Ndërkombëtare e Fëmijëve i gjetën Eltonit një familje që edhe i garantonte jetën edhe i jepte atij një të ardhme.

Bruna

Bruna, 8 vjeç, jeton gjithashtu në SHBA. Një çift amerikan e birësoi atë në vitin 2000 dhe ajo ishte afërsisht 2 vjeçe. Brunna kishte lindur nga një çift i martuar, por për shkak të deformimeve të saj të rënda prindët e braktisën kur lindi. Brunës i mungojnë gjymtyrja poshtme, ndërsa gjymtyrët e sipërme nuk ishin të zhvilluara krejt. Prindët birësues të Brunës janë në gjendje të mirë financiare, ata paguan një numër operacionesh për të marrë përshatur asaj proteza. Sot ajo shkon në shkollë dhe është në gjendje të lëvizë lirshëm pa falë protezave. Sikur të kishte ndenjur në institucion, Brunna do të ishte lidhur pas krahëve dhe jeta e saj do të varej krejt nga kujdesi i infermieres.

Përfundime Gjatë vrojtimit të kryer në institucionet e kujdesit social, grupi i ekspertëve konstatoi që këto institucione nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për të lehtësuar kthimin e fëmijëve në familjet e tyre biologjike, ose ta lehtësojnë birësimin në një periudhë të shpejtë kohore pas braktisjes ose shpërfilljes. Në shumë raste mungesa e kriterëve të qarta e të prera ka shpënë në interpretime që kanë pasoja negative mbi të ardhmen e fëmijës. Sipas ligjit një fëmijë mund të shpallet i braktisur në qoftë se familja e tij nuk interesohet për të për një periudhë njëvjeçare. Prandaj, me dëshirën për mos ta pakësuar numrin e fëmijëve, drejtuesve ose personelit të institucioneve u mjafton të marrin një telefonatë, një letër ose një vizitë nga prindi i fëmijës ose nga ndonjë i afërm tjetër përgjatë një viti, që ky të interpretohet prej tyre si "interesim" për fëmijën; në këtë mënyrë ata mund ta pengojnë procesin e birësimit.

I duhet kushtuar një vëmendje më e madhe periudhës të pasbirësimit. Vëzhgimi i pasbirësimit do të thotë që çifti birësues të mbushë formularë bashkangjitur me fotografi të fëmijës në familjen e re; gjithashtu takime ose vizita në shtëpi të fëmija dhe të familja e tij e re.

Ky proces ka mangësi. Sapo që mbaron procedura ligjore, disa çifte birësuese nuk i mbajnë më kontaktet me Komitetin Shqiptar të Birësimeve. Në shumë raste familja birësuese emigron duke e bërë të pamundur mbikëqyrjen pas birësimit. Legjislacioni aktual nuk parashikon sanksione ndaj këtyre shkeljeve të ligjit. Nuk ka agjenci të specializuara ose struktura në një nivel lokal (bashki dhe komuna) të cilat mund të bëjnë një vlerësim paraprak të familjes aplikuese dhe të vëzhgojnë integrimin e mëpasëm të fëmijës në familjen birësuese. Ngritja e tyre do ta përmirësonte ndjeshëm procesin e birësimit dhe të vëzhgimit pas birësimit.

3.1.2 Shtëpitë familjare²² (Casa Famiglia)

Shtëpitë familjare, të menaxhuara dhe financuara nga organizata jofitimprurëse, janë një alternativë tjetër ndaj shërbimeve publike që u ofrohen fëmijëve pa kujdes prindëror. Ky shërbim ka për qëllim të krijojë një mjedis sa më të afërt me familjen biologjike, dhe t'u japë fëmijëve mbështetje për një periudhë kohore relativisht të gjatë.

Parimi i interesave më të mira të fëmijës. Fshati i fëmijëve SOS në Tiranë u ofron një mjedis familjar rreth 73 jetimëve biologjikë ose fëmijëve prej familjesh që ishin të paafta të kujdeseshin për ta.

Mosha e pranimit dhe procedurat e pranimit. Fëmijët pranojnë në shtëpitë familjare deri në moshën 10 vjeç. Një personel profesional trajton me kujdes procedurat për vendosjen e fëmijëve, me qëllim që çdo fëmijë të mund të ndjehet si në shtëpi e si në familjen e vet. Vendimi për ta pranuar fëmijën në fshatin e fëmijëve SOS merret nga një bord i veçantë brenda fshatit të fëmijëve SOS. Ai merr parasysh: a) gjendjen e fëmijës (fizike ose mendore) përkundërt kritereve të pranimit dhe b) nevojën e fëmijës për një shtëpi të përhershme.

Një ekspert nga Shërbimi Social Shtetëror, i cili është anëtar i rregullt i këtij bordi, vlerëson përshtatshmërinë me politikën kombëtare sociale për fëmijët që shqyrtohen për pranim. Pas kësaj vendimi i bordit i paraqitet një bordi shtetëror për miratim ose refuzim. Bordi shtetëror është pjesë e Shërbimit Social Shtetëror dhe merret me vendosjen e fëmijëve në të gjitha institucionet e kujdesit social.

Kategoritë dhe numri i fëmijëve në një shtëpi familjare. Në fshatin e fëmijëve SOS i jepet përparësi fëmijëve jetimë biologjikë, fëmijëve nga prindër të ndarë dhe fëmijëve prindërit e të cilëve nuk janë në gjendje të kujdesen për ta. Marrin përparësi vëllezër dhe motra. Numri i fëmijëve në familjen SOS shkon nga 5 në 7 vetë e, ndryshe nga

²² Përkufizimi për "shtëpitë familjare" gjendet në kapitullin e parë.

institucionet rezidenciale, vëllezërit dhe motrat nën moshën 16 vjeç nuk ndahen nga njëri-tjetri.

Parimet që drejtojnë veprimtarinë në fshatin e fëmijëve SOS. Struktura e shtëpisë familjare në fshatin e fëmijëve SOS ngrihet mbi: (i) organizimin në njësi familjare të vogla, ku nëna e familjes është figura qendrore dhe kujdesin afatgjatë për fëmijët deri sa ata të mërrjnë moshën madhore; (ii) zgjedhjen e nënës SOS mbi bazë të kriterëve që kanë të bëjnë me moshën e saj, nivelin e arsimit, gjendjen civile, gjendjen shëndetësore, karakterin, sjelljen me fëmijët, dëshirën për të punuar me fëmijë të vështirë e për t'u dhënë atyre dashuri, si dhe gatishmërinë për t'u kujdesur për ta për një periudhë relativisht të gjatë kohore.

Çdo fëmijë ka **një nënë SOS**. Ajo është personi kyç që kujdeset për të dhe zëvendëson prindët natyrorë të fëmijës. Ajo ndan të njëjtën shtëpi me fëmijët. Së bashku ata bëjnë çdo ditë planet e jetës familjare. Nëna ndërton lidhje të qëndrueshme e të sigurt me fëmijët, duke u ofruar atyre siguri dhe mjedisin e ngrohtë e me dashuri të familjes. Nënata trajnohen përpara se të lejohen të punojnë si nëna SOS. Nënata SOS ndihmohen nga mësues asistentë dhe nënata trajnuese SOS.

Vajzat dhe djemtë, të moshave të ndryshme, rriten në familjen SOS si vëllezër dhe motra. Vëllezërit dhe motrat natyrorë nuk ndahen nga njëri-tjetri. Fshati i fëmijëve SOS pranon fëmijë prej moshës disa muajshe deri në 10 vjeç, megjithëse pranohen fëmijë edhe më të moshuar në qoftë se janë vëllezër ose motra të fëmijëve më të vegjël që kanë qenë pranuar në fshat. Çdo familje ka **shtëpinë e vet** e në çdo familje dhomat e banimit e të bukës janë të ndërthurura në një, meqë kjo dhomë është gjithashtu një mjedis i rëndësishëm për jetën shoqërore të familjes. Atmosfera që zotëron në çdo shtëpi nxit marrëdhënie dhe bashkëpunim të këndshëm midis familjeve duke futur tek fëmijët ndjenjën e përkatësisë, strehës dhe sigurisë.

Fshati i fëmijëve SOS në Tiranë përbëhet nga 13 shtëpi, duke dhënë përshtypjen e **një komuniteti të gjerë**. Kjo u ushqen fëmijëve kulturën e jetesës në grup, u jep atyre ndjenjën e përkatësisë në një komunitet. Në të njëjtën kohë fshati i fëmijëve SOS është i lidhur me fqinjësinë në vendin ku ndodhet. Krahas nxitjes së integritit të fëmijëve SOS në jetën e komunitetit fqinj, fshati i fëmijëve SOS përkrah ndërveprimin dhe shkëmbimin e përvojave me komunitetin.

E ardhmja e fëmijëve. I kushtohet një vëmendje e veçantë përgatitjes së fëmijëve për një jetë të pavarur në të ardhmen. Puna e fshatit synon integritin e fëmijës në komunitetin më të gjërë, krijimin e shanseve për të për një punësim të ardhshëm. Strukturat dytësore të parashikuara për të rinj, shkollat dhe qendrat e trajnimit profesional janë hallka shumë të rëndësishme në zinxhirin e SOS.

Libraria "Shtëpia e librit" u ngrit 6 muaj më parë me financim të SOS-Kinderdorf International. Kjo librari, krahas letërsisë që ofron në shqip dhe në gjuhë të huaja, lehtëson veprimtari rikrijuese, ku përfshihet modelimi, piktura dhe kompjuteri ose mësimet

në anglisht. Edhe këto veprimtari ndihmojnë që t'i mbajnë fëmijët larg rrugëve. Projekti me të rinjtë SOS filloi në 2001, kur kontigjenti i parë i të rinjve kaloi nga fshati i fëmijëve SOS në apartamente të marra me qira në Tiranë. Më 2005 SOS siguroi një apartament të gjerë për t'iu përgjigjur nevojat në rritje të të rinjve SOS për banim.

Programi me synim parandalimin e braktisjes. Në 2003 fshati i fëmijëve SOS filloi një program të quajtur "të hapet fshati". Ky program ofron përkrahje për familje të varfra që rrezikojnë të braktisin fëmijët e tyre.

Kutiza 3 Fshati i fëmijëve SOS në Tiranë

Puna intensive për ngritjen e fshatit të fëmijëve SOS filloi në shtator 1993, rreth 5 muaj pasi ishte vënë tulla e parë përruese në një ceremoni zyrtare. Qershori 1995 pa ngritjen e fshatit të parë SOS në Shqipëri e pak kohë pas kësaj nënat e para SOS erdhën në fshat me fëmijët e tyre në shtëpitë e reja. Ndërtimi i shkollës SOS "Hermann Gmeiner" filloi në tetor 1995 dhe mbaroi në maj 1996. Paralel me këtë shkollë ka funksionuar prej vitit 1995 kopshti SOS.

Fshati i fëmijëve SOS, kopshti SOS dhe shkolla SOS "Hermann Gmeiner" në Tiranë u përruan zyrtarisht në 18 tetor 1996. Fshati SOS dhe shkolla 9-vjeçare SOS "Herman Gmeiner" janë të hapura gjithashtu edhe për fëmijë nga Sauku. Ato kërkohen mjaft për shkak të personelit të tyre të kualifikuar dhe cilësisë së mësimdhënies, po ashtu edhe për arsye të materialeve dhe pajisjeve bashkëkohore të mësimdhënies.

Fshati i fëmijëve SOS të Tiranës është ndërtuar në Sauk, një komunë fshatare me një popullsi prej rreth 6000 vetësh, që ndodhet afër 4 kilometra në juglindje të Tiranës. Ai ndodhet në një vend me bukuri natyrore, mbrapa Parkut Kombëtar dhe liqenit artificial të Tiranës. Fshati i fëmijëve SOS përbëhet nga 13 shtëpi familjare, ndërtesa e administratës, kopshti SOS dhe Shkolla 9-vjeçare SOS "Hermann Gmeiner".

Shtëpi familjare për fëmijë dhe të rinj me paaftësi. Në qytetin e Shkodrës janë nisur dy iniciativa të suksesshme me qëllim përkrahjen për fëmijë jetimë, në radhë të parë për ata me aftësi të kufizuara. Në 8 vjetët e fundit, me financime nga donatorë të huaj, dy organizata jofitimprurëse kanë ndërtuar dhe filluar veprimtarinë e 9 shtëpive familjare. Në këto shtëpi u ofrohen banim, ndihmë emocionale e punësim afërsisht 68 fëmijëve e të rinjve në moshat 14 deri 25 vjeç, të cilët janë larguar nga institucione rezidenciale të kujdesit social (Shtëpia për fëmijë të moshës shkollore dhe Qendra e zhvillimit rezidencial). Ato janë të vetmet shërbime efikase që u ofrohen të rinjve me aftësi të kufizuara që largohen nga institucionet publike të kujdesit për fëmijët në moshën 14-vjeçare.

3.1.3 Kujdesi tutorial

Kujdesi tutorial është një alternativë relativisht e re në Shqipëri. Një marrëveshje e lidhur midis Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me European Children Trust mundësoi zhvillimin e një projekti pilot në qytetin e Tiranës më 1998. Në fund të këtij projekti 3 fëmijë ishin zhvendosur nga institucione publike rezidenciale: njëri ishte kthyer te familja e tij biologjike, ndërsa 2 të tjerë ishin vendosur në familje tutore.

Ky projekt pilot tregoi se kujdesi tutorial është i realizueshëm në Shqipëri. Ai mbështetet mbi parimin e interesave më të mira të fëmijës, është i efektshëm në shpenzime, duke u bërë kështu një alternativë e parapëlqyer ndaj institucionalizimit.

Ndër mësimet që u nxunë gjatë zbatimit të projektit pilot ishte edhe fakti që ndihma ekonomike për familjet e mirëfillta që jetojnë në varfëri të skajshme, ngritja e lidhjeve fëmijë-prind dhe aplikimi i kujdesit tutorial si një formë e ndërmjetme drejt birësimit janë ndërhyrje efikase në parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve.

Kutiza 4 Kujdesi tutorial

Në disa raste kujdesi tutorial është me rëndësi vendimtare në të ndihmuarit e fëmijëve që të largohen nga institucionet e kujdesit social. Projekti i Trustit Europian të Fëmijëve u përqendrua në një familje me 5 fëmijë. Babai i fëmijëve kishte vdekur, nëna ishte e sëmurë, familja jetonte në varfëri të skajshme. Fëmija më i vogël ishte vendosur në një institucion rezidencial të kujdesit social, ndërsa dy fëmijët e tjerë sipas gjithë gjasave do ta ndiqnin atë. Duke ndihmuar gjyshen e fëmijëve si kujdestare, ky projekt jo vetëm që ndaloi dy fëmijët e tjerë që të shkonin në atë institucion, por gjithashtu mundësoi kthimin në familje të fëmijës së larguar. Në fund të projektit tre fëmijë u rikthyen në kujdesin e nënës së tyre.

Rachel Rowlands, "Shanse të reja: përmirësimi i shërbimeve të kujdesit për fëmijët për fëmijët shqiptarë".

Mësime të tjera përfshinin edhe nevojën për të zgjeruar me kujdes shërbimet tutoriale, duke ndjekur rregullat e zhvilluara në pajtim me ligjin e veçantë mbi kujdesin tutorial. Aktualisht organizata *Shpresë dhe shtëpi për fëmijët* ofron kujdes tutorial për fëmijët në Shtëpinë e Fëmijës në Durrës. Sidoqoftë, meqë ende mungojnë rregullimet ligjore, ky shërbim është i kufizuar.

3.1.4 Institucionet rezidenciale

3.1.4.1 Institucionet rezidenciale publike

Në Shqipëri ekzistojnë 8 institucione rezidenciale publike për fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror, të cilat u shërbejnë tri grupmoshave të ndryshme: 0 deri 3, 3 deri 6 dhe 6 deri 14 vjeç. Institucionet rezidenciale publike financohen dhe drejtohen nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror.

Sado që këto institucione vazhdimisht po i përmirësojnë kushtet e jetesës dhe edukimin e fëmijëve, kujdesi rezidencial mbetet ende opsioni i fundit; ai ka një efekt të dëmshëm mbi fëmijën, për arsye se fëmijës i mungon mjedisi familjar. Efektet e dëmshme janë të qarta në sjelljen e vrazhdë të fëmijëve, mungesën e përqendrimit, konfuzionin dhe çrregullime të tjera serioze psikologjike. Kur këta fëmijë të kenë mbërritur moshën që duhet të largohen nga institucioni, ata sipas gjithë gjasave do të jetojnë rrethana të vështira, e statusi i tyre si "fëmijë nga Shtëpia e Fëmijës" do të vazhdojë të ketë pasoja negative në jetën e tyre.

Këto institucione vazhdojnë të reformohen e të përmirësohen. Të dy shtëpitë e fëmijës (në Shkodër e Tiranë) po shndërrohen gradualisht në shtëpi familjare, duke marrë fëmijë që as nuk kthehen dot në familjet e tyre natyrore, as nuk mund të birësohen.


Foshnjat e braktisura kalojnë 3 ose 4 vjet jetë në Shtëpinë e Foshnjës, e pas kësaj merren në Shtëpitë për Fëmijët Parashkollorë, ku qëndrojnë deri në moshën 6 vjeç. Pas kësaj ata zhvendosen në Shtëpitë për Fëmijët e Moshës Shkollore, ku duhet të qëndrojnë deri sa të mbushin 14 vjeç. Kështu nga 0 në 14 vjeç këtyre fëmijëve u duhet ta ndryshojnë mjedisin ku rriten së paku tri herë, çka ndonjëherë do të thotë edhe zhvendosje në një rreth tjetër. Organizimi i institucioneve publike sipas grupmoshave përherë heq shumë fëmijë nga familjet përkatëse, duke shkaktuar kështu humbjen e lidhjeve dhe kontakteve me to. E mbi të gjitha sistemi aktual ndan vëllezërit e motrat që bëjnë pjesë në grupmosha të ndryshme, duke shkaktuar kështu ndarjen përfundimtare të familjes.

Kutiza 5 Drini, motrat dhe vëllezërit e tij

Drini është fëmija më i madh i 7 fëmijëve të familjes Duri (emrat janë ndryshuar për të ruajtur privatësinë). Tani ai është 14 vjeç dhe jeton në Shtëpinë për Fëmijë të Moshës Shkollore në Tiranë. Pasi babai dhe nëna u kishin vdekur, të afërmit e tyre iu drejtuan shtetit për ndihmë. Meqë ishin në moshë të ndryshme dhe institucionet rezidenciale kishin kapacitete të kufizuara, fëmijët e familjes Duri u morën në disa institucione, nëpër qytete të ndryshme. Drini, njëri prej vëllezërve dhe njëra prej motrave të tij - të dy më të vegjël se ai - janë vendosur në të njëjtin institucion. Drini kujdeset për ta, por ai është i shqetësuar për vëllezërit dhe motrën që i sheh rrallë, pasi ata janë vendosur në institucione të tjera larg Tiranës (dy vëllezër në shtëpinë e fëmijës në Vlorë, një motër në fshatin e fëmijëve SOS). Vëllai i tij më i vogël, rreth 3 vjeç, jeton me familjen e tezes së tyre. Drini është mjaft i shqetësuar për motrat dhe vëllezërit e tij dhe dëshiron të zhvendoset sa më parë që të jetë e mundur në një shtëpi ku mund të kujdeset për to. "Sapo të bëhem 16 vjeç, do të shkoj në Greqi ku do të punoj dhe do të paguaj dikë që të kujdeset për ta në shtëpinë tonë".

Burimi i informacionit: Intervista të marra gjatë mbledhjes së të dhënave

Diagrami 3 Skema e zhvendosjes së fëmijëve nga një institucion rezidencial në tjetrin



3.1.4.2 Shkollat me konvikte

Fëmijët pa kujdes prindëror që janë rritur në institucione publike rezidenciale kanë gjithashtu të drejtë për përkujdesje edhe pas moshës 14-vjeçare. Shumë prej tyre janë vendosur në konviktet e shkollave të mesme në Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Në këto raste Ministria e Arsimit dhe e Shkencës u jep atyre bursa që mbulojnë banimin dhe ushqimin për 4 ose 5 vjet. Shumë prej tyre vazhdojnë të jetojnë në dhomat e konvikteve edhe pas mbarimit të shkollës së mesme. Fëmijët që nuk shkojnë në shkollë pas moshës 14-vjeçare vazhdojnë të jetojnë në institucione rezidenciale deri në moshën 16 ose 18 vjeç.

Në Tiranë një ndërtesë e veçantë ngjitur me Shtëpinë e Fëmijës, organizata *Shpresa për Botën* u ofron fëmijëve të moshës 14 deri 18 vjeç banim dhe përkujdesje për një periudhë 3 deri 4 vjeçare.

Më 2005 aty banonin 17 fëmijë.²³ Disa prej tyre ndjekin arsimin e mesëm ose të lartë. Zyra e Punës u siguron të tjerëve pjesëmarrjen në kurse njëvjeçare dhe gjetjen e punës.

Ky projekt në fillim u përqendrua edhe në strehimin e të rinjve që kishin mbaruar shkollën e mesme ose kurse të arsimit profesional në apartamente me qira për një periudhë trevjeçare. Ishte menduar se tre vjet do të ishin të mjaftueshëm për të rinjë që të fitonin pavarësinë. Megjithatë modeli dështoi. Asnjëri nga të rinjtë nuk arriti të bëjë jetë të pavarur e të gjithë u kthyen në konviktet e tyre të vjetra të shkollave të mesme.

3.1.4.3 Institucionet rezidenciale të drejtuara nga organizata jofitimprurëse ose subjektet private

Organizata jofitimprurëse, kryesisht të huaja, kanë ngritur institucione rezidenciale me kapacitet të vogël që strehojnë jetimë socialë dhe biologjikë. Aktualisht organizata jofitimprurëse drejtojnë 14 institucione rezidenciale që ofrojnë strehim dhe përkujdesje për fëmijë që jetojnë në lagjen pranë. Këto institucione, ndryshe nga ato të sektorit publik, ofrojnë shërbimet e tyre për një numër të kufizuar fëmijësh (10 deri 20 fëmijë), të moshave 0 deri 16 vjeç; përveç *Betania Centre* dhe *His Children* të cilat strehojnë një numër më të madh fëmijësh (përkatësisht 80 dhe 40 fëmijë).

3.2 Standardet e institucioneve rezidenciale të kujdesit social

3.2.1 Kushtet fizike

²³ Kapaciteti i projektit arrin të strehojë njëkohësisht deri në 18 fëmijë.

Dhomat e gjumit, dushet dhe banjat. Numri i fëmijëve për dhomë ndryshon nga institucioni në institucion, me një mesatare prej 4,8 fëmijësh. Në institucionet publike numri i fëmijëve për dhomë është më i lartë për foshnje apo fëmijë të vegjël dhe më i vogël për grupmoshat 6 deri 14 vjeç (shih tabelën 12).

Tabela 12 Numri i fëmijëve për dhomë, sipas tipit të kujdesit

	<i>Institucione rezidenciale</i> 0-6	<i>Institucione rezidenciale</i> 0-14	<i>Institucione rezidenciale</i> 6-14
Publike	7- 8	5	3 - 5
OJF	Nuk ka	3-4	Nuk ka

Burimi: Të dhëna të mbledhura gjatë vërtetimit²⁴

Kudo dhomat e gjumit janë të mëdha, të pajisura me krevate dhe tryeza të vogla që mundësojnë hapësirë personale për çdo fëmijë. Dhomat e gjumit janë të hapura gjatë gjithë ditës, kështu që fëmijët mund të rrijnë në dhoma kur të dëshirojnë. Në institucionet rezidenciale publike dhomat e gjumit zakonisht përdoren nga një numër fëmijësh të së njëjtës moshë. Në institucionet e drejtuara nga organizatat jofitimprurëse fëmijë të moshave të ndryshme mund të jetojnë në të njëjtën dhomë, ku fëmijët më të moshuar kujdesen për më të vegjlit, duke krijuar kështu njëfarë mjedisi familjar.

Në të gjitha institucionet rezidenciale, si publike si të drejtuara prej organizatash jofitimprurëse, fëmijët ndahen në grupe, në të cilat një ose dy kujdestarë luajnë rolin e prindit. Ata përgjigjen për mirëqenien e fëmijëve dhe për detyrat e tyre, gjithashtu që ata të jenë të veshur e të larë siç duhet. Të gjitha institucionet kanë një hapësirë të caktuar për veprimtari rikrijuese.

Furnizimi me ujë të pishëm dhe të ngrohtë. Uji i ngrohtë gjendet në kuzhinat dhe banjat e të gjitha institucioneve. Në institucionet publike, për shkak të kapacitetit të tyre të kufizuar, fëmijët 6 deri 14 vjeç nuk mund të bëjnë dush më shumë se një herë në javë gjatë periudhës së dimrit dhe 2 deri 3 herë në javë gjatë verës. Varësisht nga institucioni, ka një dush për çdo 25 fëmijë. Banjat janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e fëmijëve.

Tabela 13 Mundësia për ujë të pishëm dhe ujë të ngrohtë

	<i>Institucione rezidenciale</i> 0-3	<i>Institucione rezidenciale</i> 0-14	<i>Institucione rezidenciale</i> 6-14
Ujë i pijshëm dhe ujë i ngrohtë	po	po	po
Vetëm ujë i ftohtë	jo	jo	jo
Ujë vetëm në katin e parë	jo	jo	jo

²⁴ Të dhënat e përdorura në këtë kapitull janë mbledhur në intervista me personelin e insitucioneve të kujdesit për fëmijët.

Numri mesatar i fëmijëve për një banjë ndryshon nga 4 në 6. Në shtëpitë e fëmijës të moshave 0 deri 3 vjeç dhe shtëpitë e fëmijës 3 deri 6 vjeç, pelenat ose uturakët përdoren deri sa fëmijët të jenë në gjendje të shkojnë në banjë e të kujdesen vetë për nevojat e tyre. Të gjitha institucionet publike dhe ato të drejtuara prej organizatave jofitimprurëse kanë sistem kanalizimi.

Furnizimi me elektricitet dhe sistemi ngrohës. Të gjitha institucionet rezidenciale janë të lidhura në rrjet dhe kanë elektricitet. Sidoqoftë në dimër disa institucione kanë orar të kufizuar elektriku (Shkodra, Saranda dhe Vlora). Nuk u njoftua për rreziqe zjarri ose rreziqe të tjera për shkak sistemesh me defekt. Institucionet publike kanë sisteme ngrohjeje qendrore me djegie naftë ose përdorin ngrohës elektrik.

Lavanderitë. Të gjitha institucionet rezidenciale kanë lavanderi të përshtatshme. Sidoqoftë fondet për mbajtjen e tyre janë të pamjaftueshme. Në shumicën e rasteve janë dashur donatorë të huaj për të financuar riparimet e nevojshme e blerjen e pjesëve të këmbimit.

3.2.2 Shëndeti, ushqimi dhe edukimi

Problemet shëndetësore dhe mundësia për të pasur shërbime shëndetësore.

Tabelat 14 dhe 15 tregojnë se ndër fëmijët e vendosur në institucione janë të zakonshme 13 tipe sëmundjesh. Asnjë nga institucionet publike ose nga ato të drejtuara prej organizatash jofitimprurëse nuk ka në strukturën e përhershme të personelit një doktor. Infermieret janë pjesë të personelit të institucionit e ato mjaftojnë për të përmbushur shumicën e nevojave shëndetësore të fëmijëve. Institucionet kanë marrëveshje me një pediatër me orar të reduktuar i cili mbulon nevojat për shërbimet e specializuara mjekësore. Doktorit bën kontrole periodike dhe trajton çdo sëmundje që ndesh, kur është nevoja.

Fëmijët marrin shërbime shëndetësore edhe në ambulanca e qendra shëndetësore. Nuk ka të dhëna për frekuencën ose për mbisundim të një sëmundjeje ndër fëmijë. Informacioni i tabelave 14 dhe 15 u nxor nga intervistat me drejtuesit e institucioneve dhe ato arrijnë të japin vetëm një panoramë të përgjithshme të problemeve shëndetësore ndër fëmijët që jetojnë në institucione rezidenciale.

Tabela 14 Problemet më të shpeshta shëndetësore

<i>Problemet shëndetësore më të shpeshta</i>	<i>Institucionet rezidenciale publike</i>	<i>Institucionet e drejtuara nga OJF</i>
<i>Sëmundjet e veshëve, hundëve dhe grykëve</i>	XXX	XXX
<i>Infeksionet kronike të veshëve</i>	X	X

<i>Bajamet</i>	X	X
<i>Rinitet</i>	X	
<i>Temperatura e lartë</i>	X	X
<i>Sëmundjet e organeve të frymëmarrjes</i>	XXX	
<i>Bronkiti</i>	X	
<i>Astma</i>	X	
<i>Anemia foshnjore</i>	XXX	-

Shënim: Shenjat "X" tregon tipin e problemit shëndetësor të raportuar nga institucionet.

Arsyet kryesore për marrjen e sëmundjeve. Të dhënat në tabela tregojnë se fëmijët që jetojnë në institucione të drejtuara nga organizata jofitimprurëse kanë më pak gjasa të vuajnë nga probleme të veshëve, hundës dhe fytit sesa fëmijët që jetojnë në institucione rezidenciale publike. Kjo ndoshta ka të bëjë me faktin se në institucionet publike jetojnë më shumë fëmijë e ndaj aty është më i madh rreziku i përhapjes së sëmundjeve infektive ose virale. Veç kësaj dieta e varfër, mjedisi i ftohtë gjatë periudhës së dimrit (sidomos në korridore, mensa, banja) ndihmon në gjithashtu për një shpeshtësi më të lartë anemie dhe sëmundjesh të aparatit të frymëmarrjes ndër fëmijë të vendosur në institucione rezidenciale publike. Antarët e grupit të ekspertëve konstatuan se sidomos fëmijët në Shtëpitë e Fëmijës në Vlorë, Korçë dhe Tiranë vuanin nga anemia, rakitizmi e në përgjithësi zhvillim i pakët: ata dukeshin të dobët, apatikë, të zbehtë e mjaft të vegjël për moshën e tyre.

Tabela 15 Probleme të lëkurës, flokëve dhe aparatit gastro-intestinal

<i>Probleme të lëkurës, flokëve dhe aparatit gastro-intestinal</i>		
<i>Lëkura dhe flokët</i>	Numri i institucioneve publike që raportojnë raste me:	Numri i institucioneve të drejtuara nga OJF-të që raportojnë raste me:
<i>Zgjebe</i>	1	-
<i>Parazitë të kokës</i>	5	1
<i>Psoriasis</i>	3	3
<i>Probleme gastro-intestinale</i>		
<i>Parazitë</i>	8	6
<i>Diarre</i>	8	2
<i>Helmime</i>	4	1

Burimi: Regjistrat e institucioneve

Ujët e papastër dhe higjiena e mangët në kuzhina, banja e lavanderi shpjegojnë diarrenë, parazitët dhe të vjellat. Diarreja dhe të vjellat janë veçanërisht të rrezikshme për fëmijët e vegjël. Askush e asgjë s'mund t'i ndalojë këta fëmijë që të vënë duart në gojë. Ndaj nuk mjafton vetëm mjekimi për të kuruar problemet që lidhen me parazitët. Trajtimi i tyre kërkon gjithashtu një higjienë të rreptë. Prania e një doktori me kohë të pjeshme, i

cili përqendrohet në masa kuruese, ka çuar ndoshta në reduktim të masave parandaluese, duke e bërë të vështirë menaxhimin e problemeve që shkaktohen nga parazitë të kokës, të lëkurës ose të zorrëve. Është gjithashtu e nevojshme që të krijohet siguri ndaj ushqimeve të ambalazuara ose të kaluara afatit.

Probleme dhe kujdesi me dhëmbët. Çdo fëmijë i nënshtrohet rregullisht një kontrolli dentisti në klinikën dentare lokale publike. Pas kontrollit, që është pa pagesë, fëmijët kthehen aty për trajtim të dhëmbëve i cili është gjithashtu gratis. Kujdestarët e institucioneve tregojnë se përgjithësisht fëmijët ankohen për probleme me kavitetet, mishrat e dhëmbëve dhe dhimbje të dhëmballëve. Të gjitha institucionet u japin fëmijëve rregullisht tableta me flor. Fëmijët kanë furçat vetjake të dhëmbëve dhe pastë dhëmbësh. Fëmijët kujdesen për dhëmbët e tyre, ndërsa kujdestarët u kontrollojnë higjienën e gojës përditë.

Probleme me shikimin. Të gjitha institucionet tregojnë se shikimi i fëmijëve kontrollohet rregullisht si pjesë e kontrollit të përgjithshëm mjekësor. Një vështrim i shpejtë mbi fëmijët që rrijnë në institucione dëftën një përpjesëtim të madh fëmijësh që mbajnë syze ose që kanë strabizëm. Një numër i madh i këtyre problemeve buron nga fëmënia e hershme. Duke pasur parasysh numrin e madh të fëmijëve për një kujdestar, kur ata janë në moshë të vogël, këta fëmijë ndjekin lëvizjet e kujdestarit duke qëndruar shtrirë e duke vështruar anash për periudha të gjata kohore. Kjo gjë ua dëmton shikimin dhe shkakton strabizëm. Numri i pamjaftueshëm i kontrolleve dhe ndoshta dhe cilësia e ulët e këtyre kontrolleve bëjnë që të mos trajtohen miopia ose strabizmi në kohën e duhur. Veç kësaj institucionet nuk kanë burime të mjaftueshme për të siguruar syze të cilësisë së mirë. Për rrjedhim fëmijët mbajnë syze me cilësi të dobët që nuk kanë efekt ose kanë efekt negativ.

Imunizimi. Të gjitha institucionet për fëmijë të moshave 0 deri 6 dhe 6 deri 14 vjeç (si publike ashtu dhe të drejtuara nga organizata jofitimprurëse) raportojnë se e kanë zbatuar programin kombëtar të imunizimit. Çdo fëmijë ka një kartelë mjekësore, ku regjistrohen të gjitha sëmundjet e pësuar dhe vaksinat e bëra.

Infektive me HIV/AIDS. U tregua një rast infektimi me HIV në institucionet rezidenciale. Fëmija e kishte marrë infeksionin nga e ëma që ndodhet aktualisht në Itali. Institucioni nuk mund të përballojë trajtimin mjekësor dhe testet periodike të kushtueshme. Sot për sot të gjitha këto mjekime i mbulon shoqata *Shtëpi dhe Shpresë për Fëmijët*. Mosdeklarimi i tij fëmijë i braktisur, edhe pse nëna thajse nuk ka treguar asnjë interes serioz për të në dy vitet e fundit, po pengon procedurat që ai të dërgohet për testime në Itali e që të marrë barna retrovirale.

Trajtimet e sëmundjeve brenda institucioneve. Personeli mjekësor i institucioneve (infermierët dhe doktorët me kohë të pjesshme) dhe sistemi i shërbimeve publike ofrojnë shërbime shëndetësore për fëmijët në institucione. Në rast se ka nevojë për trajtime të veçanta, fëmijët dërgohen në spitale publike, ku shërbimet sot ofrohen falas. Nëse është

e nevojshme që fëmija të bëjë një kurë të shtrenjtë ose një ndërhyrje kirurgjikale që mund të kryhet vetëm jashtë shtetit, drejtuesit e institucionit i kërkojnë ndihmë Ministrisë së Shëndetësisë ose donatorëve e biznesmenëve.

Mjekimi duhet të jetë në varësi të kushteve konkrete. Megjithatë shumë shpesh trajtimi varet nga mjekimet që gjinden në institucion. Çdo institucion ka një furnizim themelor me barna, që përmbajnë antibiotikë të ndryshëm, vitamina, qetësues dhimbjesh, sedativë dhe tableta rehidratimi. Doktorit zakonisht jep recetën e mjekimit, sado që për raste të zakonshme ose emergjente edhe infermierja ka të drejtë të japë trajtimin mjekësor.

Fëmijët e sëmurë zakonisht izoloohen brendapërbrenda institucionit si një masë që duhet të ndalojë përhapjen e sëmundjes ndër fëmijë të tjerë. Megjithatë shtëpitë e fëmijës kanë vetëm një dhomë të sëmurësh. Në raste emergjence fëmijët dërgohen në struktura spitalore ose të shëndetit publik.

Vdekjet e fëmijëve. Në 2004 institucionet publike raportuan tri vdekje fëmijësh (2 foshnje në Shkodër e në Vlorë dhe 1 djalë 12-vjeçar në Tiranë). Përqindja e vdekjeve këtë vit ishte më e lartë në krahasim me vitet e mëparshëm, e shkak kryesor i vdekjeve ishte mosndërhyrja mjekësore në kohën e duhur.

Mundësia për arsimim, përkrahja për të mësuarit. Të gjitha institucionet rezidenciale respektojnë të drejtat e fëmijëve për arsimim. Fëmijët e moshës shkollore që banojnë në institucionet e kujdesit për fëmijët, qofshin këto shtetërore ose të drejtuara nga organizata jofitimprurëse, ndjekin rregullisht mësimet në shkolla publike jashtë institucionit. Oraret për studim e për kohën e lirë janë të ngjitura në muret e dhomave të gjumit të fëmijëve si dhe në dhomat e studimit. Është gjë e mirë për fëmijët që shkojnë në shkollë jashtë institucionit: ndjekin kështu të njëjtat lëndë si fëmijët e tjerë dhe lejohen të ndërveprojnë me moshatarët e tyre dhe me komunitetin ku jetojnë ata, duke kontribuar kështu në kapërcimin e izolimit që krijojnë qendrat e kujdesit rezidencial. " Frekuentimi i shkollave publike jashtë institucionit ndikon në mbajtjen e fëmijës mes miqve që janë bashkëmoshatarë dhe shërben si strehë mbrojtëse ndaj dramave që shoqërojnë jetën e këtyre fëmijëve " thotë një edukator nga Tirana.

Edukatorët që punojnë në institucione i ndihmojnë fëmijët në përgatitjen e mësimeve të tyre. Në institucionet publike për fëmijët e moshës shkollore çdo mësues kujdeset për një grup të caktuar fëmijësh të një grupmoshe. Një numër drejtuesish institucionesh thonë se pavarësisht nga mbështetja që japin mësuesit në institucion dhe ata në shkolla, fëmijët në përgjithësi kanë nota të dobta; vetëm pak syresh arrijnë rezultate të mira. Dihet se përgjithësisht këta fëmijë e kanë të vështirë ta vlersojnë arsimin. Për ta lojërat e veprimtari të tjera janë më tërheqëse. Mësuesit e shkollave janë tolerantë në vlerësimin e përparimit të tyre, por kjo nuk i motivon fëmijët që të përpiqen për më shumë.

Për sa i takon arsimin parashkollor, një pjesë e fëmijëve të moshave 3 deri 6 vjeç shkojnë në kopshte publike (fëmijë nga Shtëpia e Fëmijës në Durrës dhe në Shkodër). Pjesa tjetër edukohen në institucion, ku mësuesit dhe kujdestarët e tyre u bëjnë një

program të ngjashëm me atë të kopshteve. Gjatë intervistave grupi hulumtues mësoi se Ministria e Arsimit dhe e Shkencave, në bashkëpunim me organizata të huaja joqeveritare, kanë financuar trajnimin (me objektiv ngritjen e aftësive në fushën e kujdesin dhe edukimit parashkollor) për një pjesë të personelit të punësuar në institucione publike për fëmijë parashkollorë.

Përsa u takon fëmijëve me aftësi të kufizuara, një pjesë e vogël e atyre që jetojnë në institucione publike e marrin arsimin themelor në shkolla të veçanta (për fëmijë që janë të verbër dhe shurdhmemecë) në Tiranë dhe në Durrës. Pjesa më e madhe e fëmijëve me aftësi të kufizuara ndjekin programe të veçanta në qendra publike ose ditore të zhvillimit, ku arsimimi i tyre është pjesë e programit rehabilitues. Fëmijët me paaftësi mësojnë zanate që janë të përputhshme me nivelin e tyre të zhvillimit ose me aftësinë fizike dhe kjo ka një efekt pozitiv në integrimin e tyre në një jetë normale e të pavarur përmes punës.

Dieta e fëmijëve dhe plotësimi i nevojave ushqyese. Përveç vlerës thjesht ushqyese, ushqimi ka edhe një vlerë sociale, edukuese dhe emocionale. Ndaj është mjaft e rëndësishme për fëmijët pa kujdes prindëror jo vetëm që të kenë ushqim të mirë por që këtë ushqim ta kenë të përgatitur, të shërbyer e të ndarë me kujdes dhe dashuri.

Raportohet se menuja ditore është e gjerë dhe e balancuar për nga vlerat ushqyese, me synimin që të përmbushë nevojat e fëmijës. Në çdo institucion menuja përgatitet së bashku prej drejtorit, kuzhinierit dhe personelit mjekësor. Kudo menuja orientohet pas nevojave të fëmijës, sipas grupmoshave. Megjithatë në disa raste (në institucionet publike) menuja ditore përgatitet në bazë të ushqimeve që gjenden në institucion. Shumica e institucioneve (si ato publike ashtu dhe ato të drejtuara nga organizata jofitimprurëse) punosojnë kuzhinier të kualifikuar dhe me përvojë.

Fëmijëve u shërbehen vaftet në mënyrë të rregullt dhe jo kur ata duan të hanë. Fëmijët e rritur nuk hanë gjëra të vogla gjatë paradites dhe mbasdites. Për fëmijët e sëmurë përgatitet një dietë e veçantë nga doktori apo infermierja e institucionit, e cila merr parasysh edhe sëmundjen e fëmijës. Në tabelë 16 paraqitet një menu tipike ditore që ofrohet në institucionet rezidenciale publike, e cila nuk është shumë e ndryshme nga ajo që ofrohet në institucionet e drejtuara prej organizatash jofitimprurëse. Në institucionet publike shpenzimet e ushqimit ditor luhaten nga 180 lekë për fëmijë të moshave 0 deri 6 vjeç në 202 për fëmijë të moshave 6 deri 14 vjeç. Në institucionet e drejtuara nga organizata jofitimprurëse kjo shumë është më e lartë, më e diferencuar në lidhje me moshën e fëmijës dhe luhatet nga 200 në 450 lekë në ditë.

Tabela 16 Menuja tipike ditore në institucionet rezidenciale publike

	<i>Institucionet 0-6 vjeç</i>	<i>Institucionet 6-14 vjeç</i>
Mëngjesi	Qumësht (muhalebi me qumësht), vezë, gjalpë	Qumësht, gjalpë (djathë, reçel, vezë të ziera)
Paraditja	Fruta (lëng frutash, kos me fruta, biskota)	-
Dreka	Supë me lëng mishi (gjellë me perime) sallatë, fruta	Gjellë me mish, (brumëra, supë) sallatë, fruta
Zemra (mbasditja)	Biskota, qumësht, (reçel, djathë, çokokrem) fruta,	-
Darka	Pure perimesh (brumëra, pilaf me kos, syltiash)	Sallam (brumëra) pilaf, kos

Ekipi vëzhgues nuk shqyrtoi sistematikisht shëndetin e fëmijëve dhe gjendjen e tyre të ushqyerit. Përshtypja e ekipit ishte se një numër fëmijësh që jetojnë në institucionet rezidenciale publike janë të dobët e të zbehtë; kjo mund të jetë shkak i ushqimit të dobët dhe praktikave institucionale në rritjen e fëmijëve.

Në të gjitha institucionet (si publike ashtu dhe ato të drejtuara nga organizata jofitimprurëse) fëmijët përfshihen në përgatitjen dhe servirjen e vafteve por shumë rrallë në vendimmarrjen për menunë. Në institucionet publike kuzhinat dhe dhomat e ngrënies kanë pajisjet më të domosdoshme, por në disa institucione mensa është mjaft e madhe dhe pa atmosferë të ngrohtë (shtëpitë e fëmijës të moshës shkollore në Tiranë, Sarandë dhe Shkodër). Gjatë vafteve fëmijët përdorin pjata e gota të rregullta, po ashtu lugë, pirunj ose thika siç duhet. Kuzhinat dhe sallat e ngrënies kanë ujë të ngrohtë dhe materiale pastruese, pajisjet e kuzhinës, tryezat, raftet dhe dyshemetë duken të pastra.

Ushqimet mbahen në dollapë të veçantë, sipas tipit të ushqimit (p.sh. mish, produkte të bulmetit, fruta/zarzavate, ose miell dhe vaj). Të gjitha institucionet kanë frigorifer, disa kanë edhe ngrirës.

Sigurimi i ushqimit. Institucioni përgjigjet për blerjen e ushqimeve që prishen, ndërsa Shërbimi Social Shtetëror (zyrat qendrore) sigurojnë ushqimet që nuk prishen. Një numër drejtuesish të institucioneve vërejti se sendet (përfshirë veshmbathjet) të siguruar nga Shërbimi Social Shtetëror nganjëherë janë të papërshtatshme (përsa i takon cilësisë ose tipit) dhe më të shtrenjta sesa në tregun lokal. Veç kësaj detyrimi i institucioneve për të paguar për ruajtjen dhe transportimin e gjërave të blera nga shteti e bjerr në mënyrë të panevojshme buxhetin e tyre.

3.2.3 Burimet e financimit dhe kostoja për fëmijë

Buxheti shtetëror është burimi kryesor financiar për institucionet rezidenciale publike. Buxheti i caktuar për çdo institucion akordohet çdo muaj pa vonesa. Institucionet publike marrin gjithashtu grante e dhurime të ndryshme nga fondacione të huaja, persona privatë ose biznese.

Tabela 17 Burimet financiare të institucioneve sociale të kujdesit për fëmijë

	Numri Total	Burimet e financimit			
		Buxheti i shtetit	Pushteti vendor	Fondacione	Biznese lokale
Institucione rezidenciale publike	8	8	1	7	2
Institucione rezidenciale të drejtuara nga OJF	14	0	2	14	6

Burimi: Të dhëna nga vëzhgimi

Kostoja mujore për mbajtjen e një fëmije në një institucion rezidencial publik luhetet nga 17,335 në 41,500 lekë. Më e larta është në shtëpinë e fëmijës për shkak të numrit të personelit dhe të nevojave të veçanta që kanë fëmijët e kësaj grupmoshe. Shpenzimet për administratën luhaten nga 50 në 70 për qind të shpenzimit total mujor.

Tabela 18 Buxheti vjetor i institucioneve rezidenciale publike

Institucionet publike	Fondet ²⁵ vjetore në 000 lek	Numri i fëmijëve në institucion	Fondi mujor në lek për fëmijë
Shtëpitë e foshnjës	65,389	132	39,202
Durrës	13,301	23*	48,192
Korçë	9,462	19	41,500
Shkodër	12,394	23*	44,905
Vlorë	11,834	29	34,005
Tiranë	18,398	45	37,394
Shtëpitë e fëmijëve parashkollorë	13,460	41	27,357
Shkodër	13,460	41	27,357
Shtëpitë e fëmijëve shkollorë	51,641	191	22,531
Sarandë	11,974	48	20,788
Shkodër	17,266	83	17,335
Tiranë	22,401	60	31,112

Financimi nga individë. Individë të ndryshëm më së shumti të huaj, financojnë një përqindje të vogël të fëmijëve që banojnë në institucione rezidenciale. Po kështu familje shqiptare dhe personeli shqiptar i institucionit i shtrijnë ftesat e tyre për njerëz të

²⁵ Në fondet vjetore përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore, shpenzimet për ushqim, veshmbathje, kujdes shëndetësor etj., pa përfshirë investimet.

* Në Shtëpitë e Foshnjës në Durrës dhe Shkodër, përveç fëmijëve që qëndrojnë në mënyrë të përhershme, për rreth 20 fëmijë po aplikohet kthimi në familje, i cili kërkon disa shpenzime shtesë. Kjo është edhe arsyeja e kostos më të lartë mujore për fëmijë në këto dy institucione.

parapëlqyer (fëmijë me të cilët kanë vendosur kontakte të ngushta) me qëllim që të rrinë së bashku në fundjave ose në raste të veçanta (festa të Vitit të Ri, ditëlindje).

3.2.4 Personeli dhe ofruesit e shërbimeve

Struktura e personelit. Numri i personelit të punësuar varet nga madhësia dhe tipi i institucionit. Janë tri grupe të mëdha: personeli administrativ, personeli profesional dhe personeli mbështetës. Në institucionet e vogla struktura organizative është më e thjeshtë, raporti i fëmijëve me personelin më i vogël dhe anëtarët e personelit kryejnë një numër detyrash në të njëjtën kohë.

Në institucionet rezidenciale publike struktura administrative është si më poshtë:

- Personeli administrativ përfshin: drejtorin, llogaritarin dhe infermieret.
- Personeli profesional përfshin: mësuesit, kujdestarët/kujdestarët e turnit të natës dhe punonjësit socialë.
- Personeli mbështetës përfshin: pastruesit, kuzhinierët, punonjësit e mirëmbajtjes, punonjësit e lavanderisë dhe shoferin/rojen e institucionit.
- Personel me kohë të pjesshme: doktori.

Sigurimi i personelit. Nuk ka politika të caktuara ose procedura të shkruara lidhur me punësimin e personelit në institucionet rezidenciale (qoftë publike ose ato të drejtuara nga organizata jofitimprurëse). Punësimi i personelit nuk bëhet mbi bazë kompetitive dhe nuk i kushtohet ndonjë vëmendje e veçantë prirjes së të punësuarve për të respektuar të drejtat e fëmijës. Nuk ka kontrole të pavarura mbi punësimin e personelit.

Ndryshe nga institucionet e drejtuara prej organizatash jofitimprurëse, këto institucione nuk kanë fonde të mjaftueshme as për të zgjeruar numrin e personelit dhe as për t'i bërë rrogat më kompetitive. Si përfundim ato nuk mund të punësojnë personelin më të mirë profesional. Një pjesë e vogël e personelit të institucionit është e motivuar që të punojë me fëmijët, ndërsa pjesa tjetër e sheh punën e vet thjesht si një mënyrë për të marrë një rrogë.

Tabela 19 Personeli i institucioneve publike me rroga që mbulohehen ose plotësohen nga donacione

	<i>Institucione rezidenciale</i>	<i>Institucione rezidenciale</i>	<i>Institucione rezidenciale</i>
--	----------------------------------	----------------------------------	----------------------------------

	0-3	3-6	6-14
Përqindja e personelit pagesa e të cilëve plotësohet nga donatorët	32 ²⁶ %	0%	50%

Kujdestarët dhe personeli mbështetës. Raporti i personelit me fëmijët luhatet ndërmjet institucioneve, kryesisht në varësi nga moshën e fëmijëve. Raporti fëmijë kujdestar (në çdo turn) luhatet nga 3 në 4 fëmijë nëpër institucione të kujdesit për fëmijë të moshave 0 deri në 6 vjeç dhe nga 10 në 12 në institucione për fëmijë të moshave 6 deri në 14 vjeç. Ngarkesa më e madhe e punës për personelin kujdestar vjen në radhë të parë nga fondi i vogël i caktuar për rroga. Raporti i lartë kujdestar fëmijë në institucionet rezidenciale nuk bën që fëmija të jetë në qendër të vëmendjes së kujdestarëve.

Tabela 20 Raporti i personelit me fëmijët

	Institucione rezid 0-6	Institucione rezid 6-14	Institucione rezide drejtuara nga 0-14
Raporti personel administrativ/fëm	0,09	0,04	S'ka Informaci
Raporti personel profesional/fëmijë	0,6 ²⁷	0,18 ²⁸	S'ka Informaci
Raporti personel ndihmës/fëmijë	0,2	0,09	S'ka Informaci

Nuk ka teraupet të specializuar në paaftësitë e fëmijëve që të jenë caktuar në institucionet publike, sado që këto institucione kanë shumë fëmijë me paaftësi. Një numër i vogël fëmijësh më të moshuar me vonesa të lehta apo të moderuara zhvillimore shkojnë në shkolla speciale që ndodhen në qytetet ku ata banojnë (Tiranë, Durrës dhe Shkodër). Fëmijë më të vegjël me paaftësi (të moshave 1 deri në 6 vjeç) nuk kanë programe të tilla rehabilitimi. Kjo i rëndon paaftësitë e tyre, meqë rehabilitimi në moshë më të vonë është i vështirë dhe i kushtueshëm e me më pak gjasa suksesi. Personeli në Shtëpitë e foshnjës dhe të fëmijës duhet të kujdeset për fëmijët me aftësi të kufizuara, por pa pasur njohuri e aftësi themelore që kanë të bëjnë me rehabilitimin fizik dhe zhvillimor, ndaj dhe nuk janë të përshtatshëm për këtë detyrë.

Kontrolli dhe mbështetja e personelit. Në përgjithësi personeli i institucioneve publike dhe institucioneve të drejtuara nga organizata jofitimprurëse mbikëqyret dhe mbështetet. Drejtuesit e institucioneve publike kryejnë kontrole të shpeshta për të vëzhguar zbatimin e detyrave që shtrihen rëndi mujor i institucionit. Takimet mbështetëse për të rritur nivelin e komunikimit e për të siguruar një ndarje të efektshme të ngarkesës së punës, për të deleguar detyra dhe vlerësuar cilësinë e shërbimeve, janë të pakta.

²⁶ Shifrat i referohen vetëm stafit të Shtëpisë së Foshnjës në Tiranë, i cili është i vetmi institucion (ndërmjet shtëpive të foshnjës) që e përfiton këtë mbështetje nga organizata Bethany Christian Services.

²⁷ Stafi u referohet tri ndërresave

²⁸ Stafi u referohet dy ndërresave

Personeli rrallëherë konsultohet për mendimin e tij lidhur me kushtet e punës, cilësinë e shërbimit ose zgjidhjen e problemeve me të cilat përballet institucioni.

Trajnimi i personelit. Fëmijët në institucione shfaqin një numër problemesh. Disa prej tyre mund të trajtohen lehtësisht, ndërsa një numër syresh kërkon njëfarë ekspertize. Vetëm një pjesë e personelit institucional është e përgatitur siç duhet për të kuptuar e për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve. Me qëllim që ata të aftësohen për të kryer misionin e tyre, domethënë "edukimin e fëmijëve", ata duhet të trajnohen që të kuptojnë më mirë sjelljen e fëmijës dhe problemet që shkaktojnë çrregullimet psikosociale.

Në 10 vitet e fundit si në institucionet publike ashtu dhe në ato të drejtuara nga organizatat jofitimprurëse një vëmendje e veçantë i është kushtuar trajnimit të personelit. Shërbimi social shtetëror dhe organizatat e ndryshme të huaja joqeveritare, përfshirë *Bethany Christian Services, Save the Children, Madonnina della Grappa, Hope and Home for Children, Hope for World, dhe International Social Service*, kanë sponsorizuar kurse të veçanta trajnimi në institucione publike, të cilat e kanë ndihmuar personelin të përmirësojnë dituritë, sjelljet dhe praktikën e tyre. Këto kurse trajnimi janë përqendruar në personelin kujdestar dhe profesional.

Motivimi në punë. Rendimenti i punës lidhet ngushtë me dialogun midis drejtuesve dhe personelit si dhe me motivimin e tyre. Personeli në institucionet publike është më pak i motivuar se personeli që punon në institucionet e drejtuara nga organizata jofitimprurëse. Jo të gjithë drejtuesit e institucioneve publike kanë aftësitë e duhura për të ndërtuar një marrëdhënie horizontale me personelin e tyre dhe jo të gjithë kanë njohuri ose aftësi profesionale menaxhoriale. Ka dhe faktorë të tjerë që kanë efekt negativ, përfshirë këtu rrogat e ulta, ndërrimet e shpeshta të drejtuesve, mbikëqyrjen jokompetente dhe joprofesionale, shkurtime të herëpashershme në personel dhe mangësi mjetesesh për të kryer shërbime me cilësi.

Vullnetarizmi. Ka pak vullnetarizëm në ofrimin e shërbimeve për fëmijët pa kujdes prindëror. Numri i qytetarëve shqiptarë që kontribuojnë me fonde, ose kryejnë veprimtari në përfitim të fëmijëve në institucione të veçanta, si publike ashtu dhe të drejtuara nga organizata jofitimprurëse, është i vogël. Në fundjave ose gjatë pushimeve verore vullnetarë të huaj, kryesisht organizata fetare, financojnë aktivitete të ndryshme (ekskursione, udhëtime në plazh, evenimente sportive) për fëmijët.

Kutiza 6 *Tomorri, vullnetari nga Tirana*

Tomorri është një qytetar i Tiranës. Ai është punonjës civil me një rrogë modeste por me një zemër të madhe. Ai kujdeset për Bardhin, fëmijë që jeton në një institucion, në mënyrë shembullore. Bardhi e kalon çdo fundjave në shtëpi të Tomorrit, së bashku me fëmijët e tij. Bardhi shkon bashkë me këtë familje kur këta venë në plazh. Tomorri interesohet për problemet shëndetësore të Bardhit, për përparimin e tij në shkollë. Shpesh ai i blen Bardhit rroba ose paguan për kurimin e tij mjekësor. Tomorri është njëri ndër pak vullnetarët shqiptarë që e ndejnë për detyrë të japin dashuri e t'i ofrojnë të ardhme një fëmije të braktisur nga familja e vet. Në misionit e tij fisnik ai është modest. Kujdesi për fëmijët jetimë është në traditën e familjes së tij. Këtë traditë ai e ka marrë nga e ëma, e cila gjithashtu është kujdesur për dy fëmijë nga shtëpia e fëmijës.

"Jeta e Bardhit ka ndryshuar", thotë drejtori i institucionit. "Interesat e tij janë zgjeruar, ai është më i përgjegjshëm dhe ndihmon fëmijët më të vegjël. Ka ambicje që të marrë nota të mira. Në përfytyrimin e tij Tomorri është modeli ideal". "Dua të bëhem si xhaxhi Tomorri. Dua të shkoj në shkollën e lartë", thotë Bardhi.

Burim informacioni: Intervistat

3.2.5 Pranimi

Arsyet që përlligjin pranimin në një institucion rezidencial të kujdesit social përfshijnë:

a) braktisjen pas lindjeje pasi fëmija ka lindur jashtë martese; b) aftësitë e kufizuara (kryesisht raste të rënda); c) gjendjen ekonomike dhe sociale të familjes ose kushtet shëndetësore të prindërve (p.sh. prindët kanë sëmundje mendore ose të tjera, familja është prishur pas shkurorëzimit ose rimartesës, prindët janë në burg, prindët kanë emigruar, familja jeton në varfëri të skajshme); dhe d) vdekjen e njërit prej dy prindërve.

Rreth 23 për qind e 1198 fëmijëve të vendosur në kujdes social janë jetimë biologjikë, 72 për qind e tyre janë jetimë socialë dhe 5 për qind e tyre janë në kujdes tutorësh.

Procedurat për pranimin, moshën e pranimin. Fëmijët pranohen në institucionet rezidenciale të kujdesit social (dhe forma të tjera alternative të kujdesit për fëmijën, përfshirë shtëpitë familjare ose birësimin) në bazë vendimesh të *Bordit të pranimin në institucione* në Shërbimin Social Shtetëror dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve. Parimi i interesave më të mira të fëmijës nuk respektohet në të gjitha rastet. Ka shumë raste kur vëllezërit dhe motrat janë vendosur në institucione të ndryshme për shkak të rregullave që drejtojnë pranimin në këto institucione (kriteret e lidhura me moshën); kur foshnjat (të moshës 0 deri 1 vjeç) me qëllim nuk shpallen të braktisur, për të penguar birësimin e tyre;

e fëmijët prej shtëpive familjare ose prej fshatit të fëmijëve SOS nuk birësohen. Mosha e pranimit në institucionet rezidenciale jepet nga tabela e mëposhtme.

Tabela 21. Mosha e pranimit në institucione të kujdesit social dhe format alternative të kujdesit për fëmijët

<i>Lloji i kujdesit</i>	<i>Mosha e pranimit</i>	
<i>Institucionet rezidenciale publike</i>	<i>0-3 vjeç</i>	0-3 vjeç
	<i>3-6 vjeç</i>	3-6 vjeç
	<i>6-14 vjeç</i>	6-14 vjeç
<i>Kujdesi i ofruar nga OJF</i>	<i>Institucione rezidenciale</i>	0-14 vjeç

Vendosja e fëmijës në një institucion të kujdesit social fillon me një aplikim që i drejtohet Bordit të pranimit në institucione në Shërbimin Social Shtetëror. Bordi i pranimit në institucione u ngrit më 1994 dhe përbëhet aktualisht nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror dhe përfaqësues të tjerë të ShSSH që merren me institucionet e kujdesit për fëmijët dhe fëmijët. Bordi mbledhet në mënyrë mujore dhe shqyrton aplikimet e marra, pasi ka hetuar më parë me kujdes saktësinë e informacionit që përmbahet në aplikim. Aplikimi përfshin argumenta në mbështetje të tij dhe një përshkrim të gjendjes së fëmijës, bashkë me informacionet themelore mbi shëndetin e fëmijës dhe tipin e paaftësisë nëse ky ka të tilla. Bashkangjiten gjithashtu një certifikatë lindjeje dhe një fotografi. Shumica e aplikimeve miratohen, përparësi u jepen fëmijëve të braktisur. Në 2004 Bordi mori 136 aplikime dhe miratoi 119 prej tyre (88 për qind).

Anëtarët e Bordit kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me numrin në rritje të aplikimeve për pranim. Në fillim të viteve 90 aplikimet për pranim nëpër institucione kishin të bënë më së shumti me jetimë biologjikë, ndërsa tani numri më i madh ka të bëjë me fëmijë që i kanë prindët gjallë. Varfëria ka çuar në shpërbërjen e shumë familjeve. Shumë fëmijë nga familje të varfra rriten pa kujdes prindëror e pa mjedisin tradicional familjar, si jetimë social nëpër institucione.

3.2.6 Rrugët e largimit i fëmijëve nga institucionet rezidenciale të kujdesit social

Ka katër rrugë për largimin e fëmijëve nga institucionet rezidenciale të kujdesit social: a) birësimi; b) kthimi në familjen biologjike; c) largimi i fëmijëve kur ata mbërrijnë moshën 14 deri 18 vjeç dhe d) hyrja në kujdes tutorial.

Birësimi (shih 3.1.1)

Kthimi në familjen biologjike. Një studim i vitit 2000 i Trustit European të Fëmijëve erdhi në përfundimin se për afër gjysmën e fëmijëve që banonin në institucionet rezidenciale të kujdesit social nuk ka mënyrë për t'u kthyer në familjet e tyre biologjike. Këta janë fëmijë që kanë qënë braktisur ose fëmijë prindët e të cilëve kanë vdekur. Studimi theksoi gjithashtu faktin se ka edhe të tjerë fëmijë, që ende i kanë familjet e tyre biologjike por nuk mund të kthehen tek to. Arsyet përfshijnë varfërinë, e cila i ka detyruar prindët t'i vendosin fëmijët e tyre në një institucion; ky është shkaku kryesor dhe mbetet ende një problem; gjithashtu edhe periudha e gjatë e ndarjes e cila e vështirëson shumë rikthimin e lidhjes normale fëmijë-familje. Sidoqoftë duhet vërejtur se nuk ka programe ndihmëse financuese për të nxitur ribashkimin familjar.²⁹

Qendra e Familjes Burimore* në Shkodër punon për të ribashkuar fëmijët e vendosur në institucionet rezidenciale publike me familjet e tyre. Tre punonjës socialë të kësaj qendre rregullojnë takimet midis fëmijëve dhe familjeve të tyre. Nëse është e nevojshme, kjo qendër mbulon shpenzimet e udhëtimit dhe fjetjen në hotele. Ajo gjithashtu i ndjek fëmijët për një periudhë 6 mujore pas kthimit të tyre prej familjeve biologjike. Qysh prej vitit 1996 kur nisi ky program, qendra e familjes burimore në Shkodër, ka arritur të bëjë ribashkime familjare për 183 fëmijë nga tri institucione të kujdesit social të këtij qyteti.

Tabela 22. Numri i fëmijëve të vendosur në institucione rezidenciale publike, që janë kthyer te familjet e tyre

	2004
<i>Numri i fëmijëve të rikthyer në familjen e tyre biologjike</i>	30

Burimi i informacionit: Shërbimi Social Shtetëror, 2004

²⁹ Rachel Rowlands, *New Opportunities: Improving Childcare Services for Albanian Children* (Shanse të reja: Përmirësimi i shërbimeve të kujdesit për fëmijë për fëmijët shqiptarë, 2000)

Kutiza 7 Qendra Burimore e Familjes në qytetin e Shkodrës

E ngritur në vitin 1996 në qytetin e Shkodrës Qendra Burimore e Familjes u financua deri në vitin 2000 nga shoqata "Red Barnet". Prej asaj kohe këtë qendër e ka financuar UNICEF.

Veprimtaritë kryesore të sponsorizuara nga Qendra Burimore e Familjes përfshijnë:

- Kthimin e fëmijëve të braktisur në familjet e tyre biologjike;*
- Një shërbim këshillimor në maternitetin e Shkodrës për parandalimin e braktisjes në lindje;*
- Parandalimin e vendosjes së fëmijëve, të cilët e kanë një familje, në institucionet e kujdesit social, duke u dhënë atyre ndihmë ekonomike (3000 lekë në muaj); me anë këshillimesh gjatë vizitash në shtëpi; dhe duke ngritur një grup ndihmës për nënat;*
- Përhapja e përvojës në qytete të tjera të Shqipërisë.*

Aktualisht organizata "Shpresë dhe Shtëpi për Fëmijët" me qendër në Durrës, po zbaton modelin e Qendrës Burimore të Familjes të Shkodrës.

Pavarësia. Kur fëmijët, sapo kanë mbushur moshën 18 vjeç, dalin nga institucionet rezidenciale të kujdesit për fëmijë me qëllim që të bëjnë një jetë të pavarur, ata nuk marrin ndihmë tjetër përveç një pagese mujore prej 2400 lekësh.

Këta fëmijë e kanë të vështirë të jetojnë më vete e të jenë të pavarur. Shumë prej tyre nuk kanë ndonjë familje që t'u japë ndihmën fillestare. Stigma e të qenit në institut ndikon negativisht për punësimin e ardhshëm dhe shanset për martesë. Te shumë prej tyre arsimimi që kanë marrë nuk pasqyron kapacitetet dhe talentet vetjake e çka është më e rëndësishme ata kanë një vlerësim të ulët për vetveten.

Mungesa e strukturave dhe e politikave sociale të hartuara për mbështetjen dhe integrimin e tyre pas moshës 14 vjeç i ka lënë ata të shpërfillur, të diskriminuar dhe në luftë të vazhdueshme për mbijetesë. Vetëm një numër i vogël syresh marrin ndihmë përtej moshës 14 ose 18 vjeç nga projekti *Shpresa për Botën* me qendër në Tiranë dhe nga shtëpi familjare në Shkodër.

Kutiza 8 Të rinjtë në institucionet rezidenciale publike

Sidomos fëmijët që largohen nga institucionet e kujdesit social në moshën 14 vjeçare janë të pambrojtur e të lëndueshëm. Para viteve '90 shteti përgjigjej për pajisjen e tyre me banesë dhe punësim. Ky detyrim është ende ligjërish në fuqi, por praktikisht nuk ndodh një mbështetje e tillë. Për pasojë një numër gjithmonë e më i madh adoleshentësh e të rinjsh që largohen nga institucionet rezidenciale vazhdojnë të strehohen ilegalisht në konviktet e shkollave të mesme edhe pas kryerjes së shkollës. Ky problem nuk ka të bëjë vetëm me këtë kategori, pjesëtarët e së cilës çdo vit që kalon duhet të banojë në një hapësirë gjithmonë e më të vogël për shkak të vetëve të rinj që strehohen aty. Kjo situatë po shkatërron funksionimin normal dhe kushtet e jetesës në këto konvikte.

Vlerësim i nevojave të grupeve të lëndueshëm, Banka Botërore, 2000

Marrëdhëniet midis fëmijëve dhe prindërve ose të afërmve. Disa nga fëmijët e strehuar në institucionet rezidenciale (publike ose të drejtuara nga organizata jofitimprurëse) kanë kontakte me prindët ose të afërmit e tyre. Këto kontakte mund të jenë vizita gjatë pushimeve të dimrit, vizita në fundjave, vizita të prindërve në institucione 2 ose 3 herë në vit dhe letërkëmbim ose telefonata. Sado që është e vështirë të mbledhësh statistika lidhur me numrin e fëmijëve që kanë kontakte të rregullta ose të rastësishme me prindët e familjet e tyre, ekspertët e Shërbimit Social Shtetëror pohojnë se rreth 70 për qind e jetimëve socialë dhe të fëmijëve në kujdes tutorial kanë kontakte të dobëta me familjet e tyre, ndërsa 30 për qind të tjerë nuk kanë pasur asnjë lloj kontakti me prindët ose familjet e tyre në dy vitet e kaluara.

Ekspertët e Shërbimit Social Shtetëror gjithashtu besojnë se numri i fëmijëve që kanë kontakt me prindët e tyre është i mbivlerësuar. Personeli i këtyre institucioneve ka frikë se mos humbasë punën në qoftë se fëmijët që ata kanë nën kujdes birësohen, ndaj edhe e ekzagjerojnë numrin e kontakteve që fëmijët kanë në të vërtetë me familjet e tyre.

3.3 Kujdesi tutorial për fëmijët pa kujdes prindëror

3.3.1 Kujdesi për foshnjat e braktisura në maternitetet e Tiranës dhe të Shkodrës

Aktualisht maternitetet në Tiranë e në Shkodër kanë struktura të specializuara që kujdesen për fëmijët e braktisur në lindje derisa ata të vendosen në institucione të kujdesit për fëmijët ose të kthehen në familjet e tyre. Në Shkodër janë tre punonjës socialë nga Qendra Burimore e Familjes që punojnë së bashku me Shtëpinë e Foshnjës në Shkodër

për të parandaluar braktisjen e foshnjeve ose për të lehtësuar kthimin e foshnjeve të braktisura tek nënat e tyre biologjike. Në rast se kjo është e pamundur, ata plotësojnë dokumentacionin e duhur dhe sigurohen që foshnjët e braktisura të vendosen në institucione të kujdesit social (Shtëpia e Foshnjes), duke përsheptuar kështu procesin e birësimit. Më 1996 Organizata amerikane për Përkrahjen e Foshnjeve të Braktisura Shqiptare (OSSAB) ngriti një qendër të kujdesit për foshnjët e braktisura, të quajtur *Cradle of Angels (Djepi i Ëngjëjve)*, në maternitetin e Tiranës. Foshnjët e braktisura vendosen në këtë qendër, ku për ata kujdeset një ekip i përbërë nga punonjës socialë, mami dhe vullnetarë, deri sa ata të kthehen te nënat e tyre biologjike ose të vendosen në institucionet e kujdesit social. Të vetëdijshëm për rëndësinë e kontaktit trupor midis nënës dhe fëmijës dhe të stimulimit psikosocial, personeli i qendrës dhe vullnetarët punojnë që t'u japin foshnjeve dashuri dhe ngrohtësi. Qendra *Djepi i Ëngjëjve* i jep përparësi parandalimit të braktisjes dhe kthimit të foshnjes te nënat e tyre.

3.3.2 Qendra të kujdesit ditur për fëmijë të shpërfillur (lypës, fëmijë që nuk shkojnë në shkollë dhe shesin nëpër rrugë)

Ekzistojnë disa qendra të kujdesit ditur (ky studim identifikoi 12 syresh) të drejtuara prej organizatash jofitimprurëse, dhe të vendosura në qytetet kryesore. Ata merren me fëmijët që lypin dhe punojnë e që përkohësisht (gjatë ditës) janë jashtë kontrollit, vëmendjes dhe kujdesit të prindërve të tyre. Këto qendra përkrahin fëmijët që të ndjekin klasa speciale të cilat synojnë rikthimin e tyre në shkollë, po ashtu edhe adoleshentë që të ndjekin kurset e formimit profesional. Shumica e fëmijëve janë fëmijë rrugësh (lypsarë), pjesa e tyre më e madhe romë. Ndërthurja e kësaj kategorie fëmijësh në sistemin e arsimit publik është thuajse e pamundur. Varfëria e papunësia që sundojnë në familjet e tyre janë arsyet kryesore që i shtyjnë ata të lypin ose që të braktisin shkollën. Këto qendra mbajnë me ushqim rreth 180 fëmijë, të cilët i mbrojnë nga diskriminimi, abuzimi dhe shfrytëzimi, duke u ofruar mundësi për arsimim dhe për të luajtur me moshatarë. Këto programe mundësojnë gjithashtu shërbime shëndetësore, nëse është e nevojshme. Si fëmijët ashtu dhe familjet e tyre janë pjesë e programeve dhe shërbimeve që ofrojnë këto qendra. Qendra *Fëmijët e Botës* ka një strategji të ndërthurur e cila përfshin ngritjen e vetëdijes ndër prindër për përgjegjësitë e tyre, duke përmirësuar perspektivën e punësimit të fëmijëve nëpërmjet trajnimit, gjetjes së punës për familjen në ndërmarrje që janë nën varësinë e bashkisë së Tiranës e duke ofruar ndihmë mujore në ushqime e veshje, si dhe herë-herë orendi shtëpiake.

3.3.3 Riatdhesimi i fëmijëve të pashoqëruar nga prindërit

Shërbimi Social Ndërkombëtar

Një numër i madh fëmijësh janë larguar nga Shqipëria të pashoqëruar nga prindët e tyre. Natyra ilegale e kësaj dukurie, mungesa e informacionit, si nga vendet ku ata kanë shkuar ashtu dhe familjet në Shqipëri, e bëjnë shumë të vështirë që të konfirmosh shifra të sakta. Shumica e këtyre fëmijëve kanë ikur nga Shqipëria të pashoqëruar nga prindët për arsye varfërie dhe me dijeninë e prindërve të tyre. Sipas raportimeve që mbështeten mbi informacionin e Shërbimit Social Ndërkombëtar në Tiranë, është ndoshta një numër i vogël i këtyre fëmijëve që janë trafikuar për prostitim, punë të detyruar (kryesisht lypsari) dhe shpërndarje lëndësh narkotike.

Kutiza 10 Shërbimi Social Ndërkombëtar në Tiranë

Shërbimi Social Ndërkombëtar, i ngritur në Gjenevë më 1924, është një organizëm që ofron një shërbim social profesional, jopolitik, laik e jofitimprurës. Ai gëzon një status këshillimor në një numër organizmash të OKB (përfshirë ECOSUC, UNICEF, UNHCR dhe UNESCO) dhe konferencën e Hagës për të drejtat e individit. Shërbimi Social Ndërkombëtar ka zyra lokale në 21 vende dhe mban korrespondencë me 140 shtete në 5 kontinente.

Seksioni i Shërbimit Social Ndërkombëtar për Shqipërinë e filloi veprimtarinë e tij më 1992, ndërsa më 1998 ai u regjistrua në gjykatë si organizatë joqeveritare. Mandati i tij është të japë zgjidhje në mënyrë profesionale për çështje sociale që lindin përgjatë lëvizjeve migratore e t'u bëjë thirrje ndërhyrjes së dy ose më shumë shteteve.

Misioni i Shërbimit Social Ndërkombëtar konsiston në: kërkimin dhe gjetjen e fëmijëve të pashoqëruar jashtë shtetit; hetimit të arsyeve për ikjen e tyre dhe shqyrtimin e mundësisë së kthimit në familjet e tyre të mirëfillta; në planifikimin e lehtësimin e riatdhesimit të tyre. Riatdhesimi i fëmijëve shoqërohet me programe trajnimi të përqendruara mbi riintegrimin dhe mbi grante për të ngritur veprimtari prodhuese të shkallës së vogël. Gjatë periudhës 1992-2004 janë gjetur 3 mijë familje fëmijësh të tillë në Shqipëri; 728 prej këtyre fëmijëve janë riatdhesuar dhe shoqëruar te familjet e tyre; ndërsa 130 syresh janë përkrahur me bursa, në mënyrë që të mund të marrin shkollim dhe kualifikim profesional, ose u janë dhënë grante të vogla.

3.4 Përfundime

Përpara periudhës së tranzicionit Shqipëria konsiderohej si një vend me nivel të ulët braktisjeje dhe shpërfilljeje të fëmijëve. Shndërrimet ekonomike dhe sociale gjatë periudhës së tranzicionit në vitet '90 e rritën mjaft numrin e fëmijëve të rrezikuar. Varfëria,

papunësia dhe nivelet e larta të emigrimit po gërryejnë kohezionin e familjes shqiptare, duke çuar në rritje të numrit të fëmijëve të braktisur, të shpërfillur ose të abuzuar nga prindët e tyre. Mbështetja dhe kujdesi për fëmijë jetimë ose të shpërfillur nga familja e ngushtë (gjysh e gjyshe ose të afërm të tjerë) e redukton ndjeshëm numrin e fëmijëve që prindryshe do të ishin të rrezikuar. Deri në fillim të viteve '90 pjesa më e madhe e fëmijëve të vendosur në institucionet publike të kujdesit social ishin jetimë biologjikë; sot jetimët socialë përbëjnë kontigjentin më të madh.

Në 8 deri 15 vitet e fundit janë bërë një numër ndërhyrjesh që kanë ndihmuar të përmirësohen shërbimet dhe cilësia e jetës brenda institucioneve rezidenciale publike për fëmijët pa kujdes prindëror. Ka pasur gjithashtu përmirësime të tjera në sistemin e kujdesit social, përfshirë ngritjen e një numri institucioneve rezidenciale të drejtuara nga organizata jofitimprurëse dhe zhvillimin e formave alternative të kujdesit (përfshirë birësimin, rikthimin e marrëdhënieve fëmijë-prind, kthimin e fëmijëve në familjet e tyre biologjike, kujdesin e tutorëve dhe kujdesin në shtëpitë familjare).

Megjithatë institucionet rezidenciale mbeten zgjidhja më e rëndomtë për fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror, duke mbuluar rreth 80 për qind të fëmijëve të tillë.

Fëmijët pa kujdes prindëror rrezikohen të abuzohen, shfrytëzohen dhe keqtrajtohen. Dhënia e ndihmave në të holla për familjet e varfra nuk ka dalë e efektshme në parandalimin e braktisjes së fëmijëve. Po kështu kjo formë nuk ndihmon në mënyrë efikase kthimin e fëmijëve nga institucionet në familjet e tyre biologjike, në ato raste kur vështirësitë e mëdha ekonomike kanë qenë shkak për vendosjen e fëmijës në një institucion.

Janë një numër faktorësh që pengojnë realizimin e përshtatshëm të të drejtave të fëmijës për të jetuar, për t'u zhvilluar e mbrojtur, si dhe për t'u këshilluar me ta kur merren vendime që kanë të bëjnë me të ardhmen e tyre, përfshirë mungesën e një politike sociale parandaluese dhe mbështetëse, mungesën e një legjislacioni të plotë, mangësitë e shërbimeve sociale të ngritura mbi komunitet si dhe mungesën e standardeve dhe strukturave mbikqyrëse në shërbimet ekzistuese të kujdesit për fëmijët.

Janë një numër formash dhe shërbimesh të kujdesit social të drejtuara kah fëmijët pa kujdes prindëror që ofrojnë një nivel të kënaqshëm përkujdesjeje. Sidoqoftë kjo nuk mund të thuhet për të gjitha format dhe strukturat. Në institucionet rezidenciale dhe sidomos në institucionet rezidenciale publike, cilësia e shërbimeve të ofruara është nën standardet që do të siguronin mbrojtjen e zhvillimin normal të fëmijëve. Ka pasur zhvillime të shumta pozitive në politikën dhe praktikën e birësimit. Procesi drejtohet nga një administratë e besueshme dhe profesionale. Procedurat e birësimit janë të qarta dhe përqendrohen në interesat më të mira të fëmijës. Birësimi arrihet nëpërmjet një strategjie të zhvilluar individualisht dhe synon sigurimin e dashurisë, mirëqenies ekonomike, kujdesit shëndetësor, arsimimit dhe një të ardhmeje të sigurt për fëmijën, nëpërmjet zgjedhjes së kujdesshme të prindërve birësues. Gjatë periudhës 1994-2006 u birësua një numër i

madh fëmijësh (rreth 1000) pa probleme të pasbirësimit. Numri i birësimeve do të kish qënë edhe më i madh sikur legjislacioni që trajton problemet e birësimit të mos linte shteg për një keqinterpretim ligjor (që ka të bëjë me interesimin e vazhdueshëm prindëror), çka pengon ose ngadalëson birësimin për një numër të madh fëmijësh të vendosur në institucione rezidenciale.

Shtëpitë familjare strehojnë 17 për qind të fëmijëve që aktualisht ndodhen në sistemin formal të kujdesit social. Ky shërbim është një alternativë që ndihmon rritjen e shëndetëshme të fëmijëve, që u ofron atyre një mjedis familjar me një nënë, vëllezër dhe motra, një shtëpi individuale dhe një komunitet që është afër tyre. Veç këtyre shtëpitë e të rinjve, kualifikimi profesional dhe përkrahja në kërkim të punësimit, i ndihmon adoleshentët që të ndërtojnë një të ardhme të pavarur.

Edhe kujdesi tutorial doli se është efikas në kosto dhe mund të bëhet një alternativë e suksesshme ndaj institucionalizimit. Mbështetja financiare për familjet biologjike, rimëkëmbja e marrëdhënies fëmijë-prind, ose përdorimi i kujdesit tutorial si një formë e ndërmjetme drejt birësimit tregon se kujdesi tutorial mund të zbatohet me sukses në Shqipëri. Megjithatë është nevoja për një kuadër të plotë ligjor që të arrihet kjo, diçka që është në zhvillim e sipër.

Ndërsa vazhdojnë të jenë forma më e zakonshme për fëmijët pa kujdes prindëror, institucionet rezidenciale nuk janë në gjendje t'i përgatisin fëmijët për një të ardhme të sigurt. Fëmijët që rriten në institucione rezidenciale janë të privuar nga e drejta e tyre për t'u rritur në një mjedis familjar. Ata vuajnë nga pasojat e jetës në institute, çka del në pah në zhvillimin e fëmijës, në vlerësimin e ulët për vetveten, në rezultatet e dobëta në mësimet si dhe në shanset e pakta për t'u bërë të pavarur pas periudhës së adoleshencës. Abuzimi me këta fëmijë nis me braktisjen e tyre dhe vazhdon me vendosjen e tyre në botën e veçuar të institucioneve. Përpjekjet e pamjaftueshme, herë-herë të lëna pas dore për ta kthyer fëmijën në familjen e vet biologjike; problemet që lidhen me procesin e birësimit (keqinterpretim i termit "moskujdes i dukshëm"); zhvillimi ende i brishtë i shërbimeve alternative të kujdesit; mungesa e efikasitetit të programeve në ndihmë të familjeve të varfra, dhe mangësia e shërbimeve sociale që ngrihen mbi komunitetin nuk i premtojnë kësaj kategorie fëmijësh një të ardhme pozitive.

Pavarësisht nga përmirësimet në disa aspekte të jetesës në institucionet rezidenciale (përfshirë përmirësimin në kushtet e jetesës, në cilësinë dhe varietetet e ushqimit dhe në sjelljen e personelit), në thelb kjo formë kujdesi nuk ka ndryshuar. Ajo vazhdon të ketë një efekt negativ mbi zhvillimin psikosocial të fëmijës dhe të kompromentojë të ardhmen e tyre. Shumë faktorë kanë ndihmuar që të ruhen dhe të rritet numri i institucioneve rezidenciale, të cilat kanë një trashëgimi prej periudhës komuniste që duket qartazi si ndikon mbi ruajtjen dhe veprimin e tyre. Veç kësaj mungesa e një vizioni alternativash dhe përmirësimi i kushteve në këto institucione nëpërmjet kontributeve të donatorëve të ndryshëm kanë përforcuar statusin e tyre dhe mbështetjen e shtetit mbi to.

Në sistemin aktual të kujdesit formal shumë pak përpjekje bëhen për të identifikuar fëmijët që mund të rrezikohen me braktisje. Çdo bashki dhe komunë ka një sektor ekonomik dhe të kujdesit social³⁰, ndërsa asistencë në të holla për familjet e varfra është forma më e zakonshme e shërbimeve sociale që ofrojnë ato. Sado që përgjegjësit socialë³¹ përgjigjen për identifikimin e fëmijëve në nevojë e për raportimin e tyre tek shërbimet përkatëse, shumë nga këta përgjegjës nuk kanë ndjeshmërinë e duhur ose aftësinë profesionale për të kryer këto funksione. Incidenti i fëmijëve në Kukës që u përshkrua më sipër është shembulli më i skajshëm i mospërfilljes dhe mungesës së sigurisë të këtyre administratorëve socialë; konkretisht personi përkatës ishte i papërgjegjshëm dhe nuk kish dijeni se si mund ta jepte ndihmën e nevojshme. Mangësitë e strukturave të kujdesit social, mungesa e një sistemi të rregullt për kapacitetet njerëzore që të mbështetet mbi trajnimin profesional dhe paaftësia për t'u garantuar përgjegjësve socialë statusin e nëpunësve civilë³² janë pengesa për integrimin e përgjegjësve socialë në programet e kujdesit të fëmijës për fëmijë të braktisur, të shpërfillur ose të shfrytëzuar.

Kujdesi që ofrojnë institucionet ka dalë se është i kushtueshëm, ndërsa strukturat aktuale të kujdesit social për fëmijët që i drejtojnë organizata jofitimprurëse veprojnë për aq kohë sa zgjat një projekt i caktuar ose për aq sa mjaftojnë financimet e donatorit. Në qoftë se shpenzimet që bëhen në institucionet rezidenciale do të kanalizoheshin në një mënyrë më efikase drejt alternativave të kujdesit jorezidencial, një numër i madh fëmijësh në nevojë do kishin mundësi të gëzonin përkrahje dhe një të ardhme më të sigurt.

3.5 Rekomandime

Familja është mjedisi më i mirë për mbrojtjen dhe mirëritjen e fëmijës. Konventa e të Drejtave të Fëmijës sanksionon që familja është kujdestari kryesor për fëmijën; që kjo situatë mishëron interesat më të mira të fëmijës; dhe kurdo që është e mundur fëmijët duhet të rriten në familjen e tyre. Në qoftë se një fëmijë privohet përkohësisht ose përherë nga kujdesi i familjes së vet biologjike, atëherë duhet të veprojnë alternativat jointucionale, përfshirë birësimin ose kujdesin tutorial.

Respektimi i KDF kërkon që të merren masa për të parandaluar vendosjen e fëmijëve në institucione; ose për ata që janë ndërkohë në institucione, të largohen prej aty sa më shpejt që të jetë e mundur. Për këtë qëllim nevojiten një numër veprimesh afatshkurtëra e afatgjata:

Së pari: a) duhet hartuar një politikë sociale bashkëkohore për të mbrojtur interesat e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror, duke zhvilluar forma alternative të kujdesit për fëmijën të cilat u sigurojnë fëmijëve një kujdes të qëndrueshëm në një mjedis familjar dhe

³⁰ Sektori i ndihmës ekonomike është pjesë e sistemit publik të mbrojtjes sociale.

³¹ Punonjës të Zyrës së Ndhmës dhe Përkujdesjes shoqërore në 374 bashki dhe komuna.

³² Mosrespektimi lidhet me ndryshimin e shpeshtë të përgjegjësve socialë sa herë që bëhen zgjedhje për pushtetin vendor.

b) duhet reformuar kuadri ligjor me qëllim që të trajtohen problemet me të cilat përballen fëmijët pa kujdes prindëror (të përmirësohet legjislacioni për birësimin, të zhvillohet legjislacioni për shërbimin e kujdesit tutorial dhe të hartohet një legjislacion për shërbimet sociale të ngritura mbi komunitet me synim kujdesin për fëmijët).

Së dyti: duhet të ngrihet Gjykata për të Miturit, e cila do të merrej me raste që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës.

Së treti: duhet të ngrihet një sistem kombëtar i mbështetur mbi komunitetin për shërbimet sociale që u drejtohen fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror, bazuar ky në një legjislacion të aktualizuar që përfill klasifikimin e fëmijëve, vendosjen e tyre nën kujdes dhe të drejtat e tyre, gjithashtu format e financimit, të mbikëqyrjes e të vlerësimit, si dhe besueshmërinë e sistemit.

Së katërti: duhet të ngrihet e të përforcohet brendapërbrenda strukturave aktuale të shërbimit social një sistem informacioni i mbështetur mbi komunitet, me qëllim identifikimin (përfshirë identifikimin e hershëm) të fëmijëve që janë në rrezik braktisjeje ose shpërfilljeje.

Së pesti: familjet e rrezikuara duhet të përkrahen nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve sociale të mbështetura mbi komunitet për të përkrahur familjet që rrezikojnë të braktisin ose shpërfillin fëmijët e tyre (përfshirë ndihmën financiare, ndihmën ligjore, mbështetjen emocionale dhe këshillimin).

Së gjashti: mbështetja për institucionet rezidenciale duhet të reduktohet duke

- a) ndikuar mbi opinionin publik dhe politikëbërësit, se është e nevojshme të zhvillohen forma alternative të kujdesit dhe mbështetjes familjare dhe një sistem kujdesi joformal.
- b) nxitur zhvillimin e një infrastrukture të ngritur mbi komunitet, e cila ofron një gamë të gjerë shërbimesh që do të ndihmonin të përmbusheshin nevojat individuale të fëmijëve pa kujdes prindëror.
- c) konvertuar ose mbyllur strukturat rezidenciale dhe ritrajnuar personelin e tyre, gjithashtu siguruar punësimin e tyre në strukturat sociale të komunitetit.

Së shtati: cilësia e shërbimeve të kujdesit për fëmijë pa kujdes prindëror duhet të ngrihet duke:

- a) vendosur dhe respektuar standardet (standardet mjedisore; standardet e cilësisë së jetës; standardet e rezultateve, profesionalizmit dhe angazhimit).
- b) mbikëqyrur cilësinë e shërbimeve (licensimin, akreditimin dhe certifikimin, inspektimin dhe matjen e treguesve, Avokatin e Popullit, avokatin ligjor të fëmijëve).
- c) duke përmirësuar kushtet dhe proceset e punës (përmirësuar motivimin, siguruar trajnimin, zhvilluar një Kod Sjelljeje, ngritur sistemin dhe formën e menaxhimit dhe siguruar përfshirjen e përdoruesve dhe ofruesve të shërbimeve).

Kapitulli 4.

Problematika të zhvillimit psikosocial të fëmijëve pa kujdes prindëror

- Karakteri i ndryshuar i institucioneve të kujdesit social për fëmijët
- Raste të mungesës së respektimit, të keqtrajtimit ose shfrytëzimit të fëmijëve të vendosur në institucione
- Natyra e sistemit të institucioneve rezidenciale
- Ndikimi i institucionalizimit mbi fëmijën
- Administrimi i ankesave
- Profili i personelit dhe zhvillimi profesional
- Monitorimi, hetimi dhe raportimi i trajtimit të fëmijëve
- Puna me fëmijët mbi plane të zhvilluara individualisht
- Të drejtat e fëmijëve pa kujdes prindëror dhe të fëmijëve të tjerë
- Hulumtim i kujdesit alternativ ndaj fëmijëve të institucionalizuar
- Marrëdhëniet midis fëmijëve në institucione dhe familjeve/komunitetit të tyre
- Burime materiale për stimulimin e zhvillimit të fëmijëve.

Ky kapitull analizon zhvillimin psikosocial të fëmijëve të vendosur në institucionet e kujdesit për fëmijët në Shqipëri dhe rekomandon masa për përmirësimin e kushteve për zhvillimin e tyre psikosocial.

Matja e zhvillimit psikosocial të fëmijëve është një çështje mjaft e ndërlikuar³³ që ka disa përmasa, përfshirë ato fizike, mendore, gjuhësore, morale, sociale dhe emocionale. Ka një numër instrumentash për të zgjedhur për matjen e aspekteve të ndryshme të zhvillimit psikosocial e ato burojnë prej teorish të ndryshme, shpesh në kundërshti me njëra-tjetrën. Matja e zhvillimit psikosocial kërkon kohë e mjete. Zhvillimi i fëmijës është një proces i vazhdueshëm që përbëhet nga etapa zhvillimi të ndryshme për nga cilësia, të cilat hasen ndryshe nga një individ te tjetri. Zhvillimi i fëmijës është një proces që përfshin një numër faktorësh, që janë përkatësisht të ndërthurur me njëri-tjetrin dhe ndikojnë mbi njëri-tjetrin.³⁴ Zhvillimi i fëmijës është një proces dinamik që përfshin ndërveprimin mes mjedisit dhe fëmijës. Nga ana tjetër në Shqipëri ka pak përvojë lidhur me matjen e zhvillimit ose në veprimin mbi rezultatet e kësaj matjeje.

³³ Analysis of Instruments Used in Latin America to Measure Psychosocial Development in Children from 0 to 6 Years of Age (Analizë e instrumentave të përdorur në Amerikën Latine për matjen e zhvillimit psikosocial të fëmijët nga 0 në 6 vjeç), nga Lucille C. Atkin, Ph. D. Instituto Nacional de Perinatología, Mexico, prill 1989.

³⁴ Nepal: From Entry Point to Consolidation: An Assessment of Early Childhood Provision in Nepal (Nepali: nga pikënisja në konsolidim: Vlerësim i kujdesit për fëmijërinë e hershme në Nepal), me rekomandime për raportin e përfshirjes së UNICEF, në një konsultim të drejtuar nga Judith L. Evans, shtator 1992.

Kjo pjesë e studimit diskuton kushtet në të cilat ndodh zhvillimi psikosocial te fëmijët e institucionalizuar: cilësinë e mjedisit në këto institucione, sjelljen e fëmijëve dhe disa faktorë rrezikues.

4.1 Karakteri i ndryshuar i institucioneve të kujdesit social për fëmijë

Përgjatë dhjetëvjeçarit të fundit institucionet sociale të kujdesit për fëmijët kanë pësuar një ndryshim në natyrën e tyre. Dikur ato ishin institucione të caktuara për strehimin e fëmijëve jetimë. Sot këto institucione strehojnë një numër të vogël fëmijësh jetimë e një numër të madh fëmijësh që vijnë prej familjesh të cilat nuk mund të kujdesen për ta. Këta janë fëmijë që janë braktisur dhe vijnë prej familjesh të varfra apo me një prind, si dhe fëmijë prindërit e të cilëve kanë emigruar, janë shkurorëzuar ose burgosur. Një ndër tre fëmijë të vendosur në institucionet e kujdesit social gjatë viteve 2000 deri 2005 ishte braktisur pas lindjes, ndërsa dy të tjerë vinin prej familjesh me probleme sociale. (Shih *Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri*, Qendra e Zhvillimit Human, f.17, 2005.) Ndërkohë që ka ndryshuar profili i fëmijëve, ka shenja se ky ndryshim nuk është i mirëpritur. Një përgjegjës i njërit prej këtyre institucioneve thotë "Fëmijët të përmbushin kriteret, sepse ne nuk jemi institucion për rrugaçë." Aspekti psikosocial i zhvillimit të institucionalizuar të fëmijëve është bërë kësaj më i ndërlikuar dhe ka marrë më shumë peshë sesa kishte në të kaluarën e për këtë arsye ndaj tij kërkohet një qasje me koncepte dhe praktika të tjera.

4.2 Raste të mosrespektimit, keqtrajtimit apo shfrytëzimit të fëmijëve të vendosur në institucione

Mosrespektimi i fëmijëve të vendosur në institucionet e kujdesit social buron nga damka që vihet mbi ta dhe përbuzja shoqërore. Për shembull një mësues në Shkodër refuzoi të pranonte fëmijë pa kujdes prindëror në klasën e tij. Fëmijët humbën disa ditë shkolle vetëm sepse ata nuk vinin prej familjesh të rregullta por prej një institucioni kujdesi për fëmijët. Edhe mësuesit që i pranojnë fëmijë të tillë në klasat e tyre nuk janë të gatshëm të punojnë me ta siç punojnë me fëmijë të tjerë të shkollës. Përveç kësaj prindët bëjnë trusni mbi mësuesit që këta të mos i vendosin fëmijët e tyre në të njëjtën bangë me një fëmijë nga një institucion i tillë. Damka dhe përbuzja shoqërore ndeshen gjithashtu edhe brendapërbrenda institucioneve të kujdesit për fëmijët e në këtë këndvështrim shumë persona të punësuar në këto institucione mbajnë të njëjtin qëndrim si njerëzit jashtë institucioneve. Këta fëmijë shpesh shihen si "dele të zeza". Ata vështrohen me përçmim ose injorohen. Kjo zakonisht ndikon mbi mënyrën se si sillen ata, se si e shikojnë botën.

Në kohët e fundit nuk janë raportuar raste keqtrajtimi të fëmijëve të vendosur në institucione rezidenciale. Megjithatë media e shkruar dhe elektronike ka vënë re se

keqtrajtimi i fëmijëve është vërtet një çështje shqetësuese. Ka pasur në media raportime për dhunë fizike të ushtruar ndaj fëmijëve në institucione, me raste që janë regjistruar në Tiranë, Sarandë dhe Vlorë. Në vitin 2005 një nga drejtuesit e institucionit u pushua nga puna sepse kishte keqtrajtuar fëmijë. Të dhënat që përmbahen në studimin hulumtues *Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri*, të kryer në vitin 2005, tregon se:

- Dhuna fizike dhe psikologjike është më e zakonshme, më e rëndë dhe më e vijueshme në institucionet e kujdesit për fëmijën sesa në shtëpi dhe në shkollë;³⁵
- Iidetë për vetvrasje ndër fëmijë të vendosur në institucionet e kujdesit për fëmijën janë më të shpeshta sesa ndër fëmijë të tjerë.³⁶

Duke u mbështetur mbi intervistat që grupi kërkimor u mori personelit në institucione, mund të mbërrihet në përfundimin se përgjegjësit, edukatorët, kujdestarët dhe stafi teknik nuk janë të kualifikuar në përdorimin e teknikave jo të dhunshme për të disiplinuar fëmijët (përfshirë për shembull heqjen e privilegjeve, shpjegimin përse është e gabuar një sjellje e caktuar, sugjerimin e sjelljeve alternative si dhe teknika për tërheqjen e vëmendjes). Në vend të këtyre në trajtimin e fëmijëve mbizotërojnë teknika të dhunshme të disiplinimit të fëmijës.

Mundet të jetë ose të mos jetë i vërtetë shfrytëzimi i fëmijëve në institucione të kujdesit social. Studimi aktual nuk ishte në gjendje ta hetonte këtë çështje. Vitin e kaluar një fëmijë prej një institucioni të tillë në Tiranë u shfrytëzua prej personash jashtë institucionit me qëllim që të lypte për ta.

Duhet nënvizuar çështja e kontaktit fizik në moshën 0 deri 3 vjeç. Mësuesit dhe pjesa tjetër e personelit nuk janë të vetëdijshëm për rëndësinë që ka kontakti fizik për zhvillimin psikosocial sidomos te fëmijët e vegjël. Kështu kontakti fizik nuk përdoret në mënyrë sistematike për të nxitur zhvillimin e fëmijëve. Mësuesit/kujdestarët kanë ndonjë kontakt fizik me disa fëmijë; ata i përkëdhelin disa fëmijë më shumë se disa të tjerë. Kjo do të thotë se ata nuk japin dashuri duke u mbështetur në nevojat e fëmijëve por në nevojat e mësuesve: ata përkëdhelin më shumë fëmijët për të cilët kanë dobësi. Kjo i bën fëmijët e tjerë të ndihen të privuar nga kontakti fizik dhe nga ngrohtësia, gjithashtu ta ndiejnë veten të mënjanuar.

Nga përgjigjet e marra në studimin aktual doli në pah fakti se rastet e keqtrajtimit të fëmijëve nëpër institucione tregoheshin se kishin ndodhur në të kaluarën dhe se ushtruesit e tyre vazhdojnë të punojnë nëpër këto institucione. Personeli nuk shqyrtohet, nëse ka pasur përdorim dhune ose abuzimi në historinë e tij përpara se të punësohet.

³⁵ po aty f. *. Dhuna fizike përfshin pickimin, goditjen në pjesë të trupit, goditje në kokë, goditjen në trup por jo në prapnicë me një send, shqelmimin, goditjen në prapnicë me një objekt, goditjen me grusht në pjesë të tjera të trupit, kafshimin, shtrëngimin për fyti, goditje në kokë me grusht. Dhuna psikologjike përfshin: të bërtiturin, mbajtjen e mërisë, kërcënimet verbale, ngjitjen e epiteteve fyese dhe nofkave, kërcënimin me objekte, kërcënimin me përjashtim dhe kërcënimin me braktisje.

³⁶ po aty f. *

Mesa duket këto institucione e kanë të nevojshme ta kuptojnë shumë më thellë misionin e tyre.

Intervistat me personelin dhe fëmijët nxorën në dukje që fëmijët keqtrajtohen si prej personelit ashtu dhe prej fëmijëve të tjerë. Në shumë raste fëmijët më të moshuar përdorin dhunë verbale ose fizike ndaj fëmijëve më të vegjël. Përveç kësaj disa fëmijë të rritur luajnë rolin e "kapos" e duket se fëmijët e tjerë, drejtuesit e institucionit dhe mësuesit kanë të gjithë së bashku probleme me ta. Mungesa e rregulloreve të detajuara, që sanksionojnë si të drejtat e fëmijëve ashtu dhe masat ndëshkuese ndaj sjelljeve me probleme, ka ushqyer tek një numër fëmijësh të moshuar se mund të bëjnë çfarë të duan, se askush nuk mund të bëjë gjësend kundër tyre, se institucioni ua ka nevojën e se sajë tyre institucioni merr financime dhe rroga për edukatorët e vet.

4.3 Natyra e sistemit të institucioneve rezidenciale

Fëmijët në përgjithësi rrinë në institucionet e kujdesit social për periudha të shkurtra e të përcaktuara. Sidoqoftë këto institucione nganjëherë strehojnë fëmijë përtej kohës së caktuar me ligj. Deri në moshën 14 vjeç largimi i fëmijëve prej institucioneve për t'u kthyer në familjet e veta biologjike ose për t'u vendosur në një familje tutore, varet nga interesi që tregojnë familje/mësuese, po ashtu nga përgjegjësia e institucionit. Pas moshës 14-vjeçare fëmijët ose largohen nga këto institucione për të shkuar në shkolla profesionale me konvikte ose vazhdojnë të qëndrojnë aty. Në një nga institucionet e kujdesit social për fëmijët 6 deri 14 vjeç ekipi hulumtues takoi me banues që ishin 21 vjeç. Shkollat profesionale me konvikt janë zgjidhje për "fëmijët", përfshirë edhe disa 24-vjeçarë. Me sa duket nuk janë gjetur ende zgjidhje të qëndrueshme afatgjata për këta fëmijë.

4.4 Ndikimi/mosndikimi i sistemit institucional mbi fëmijën.

Është shumë e vështirë të masësh efektin që kanë institucionet mbi këta fëmijë e t'i dallosh ato prej efekteve që janë biologjike qysh në lindje ose që kanë të bëjnë me shkollën, ose me veprimtaritë jashtë mureve të institucionit. Ekipi vëzhgues vërejtë sa vijon lidhur me sjelljen dhe pamjen e fëmijëve: zëra të ashpër, vraga në fytyrë për shkak të ushqimit të keq, frikë nga të huajt, fjalor të varfër, pasivitet, izolim dhe sjellje agresive. Një numër fëmijësh u kërkoi anëtarëve të ekipit që t'i përqafojnë, çka tregon nevojën e tyre për prekje fizike dhe nevojën psikologjike për afri e përkatësi. Për këtë nuk mund të bësh fajtor vetëm pasojat e institucionalizimit, megjithëse ky institucionalizim ka përgjegjësinë e vet për një pjesë të mirë. Ekipi hulumtues këto sjellje i interpretoi si shprehje të problemeve në zhvillimin psikosocial: zërat e ashpër lidheshin me bërthim të shumta dhe me mënyrën e vrazhdë se si u drejtohen të tjerët atyre; frika nga të huajt lidhet me perceptimin që ka fëmija për botën si diçka armiqësore ndaj tij; fjalori i varfër

dhe prapambetja në aftësitë gjuhësore lidhen me stimulimin e pakët nga mjedisi; pasiviteti lidhet me faktorë të ndryshëm që shkaktojnë depresion dhe pengojnë iniciativën. Izolimi lidhet me hapësirën e ngushtë që kanë fëmijët në dispozicion; sjellja agresive lidhet me trajtimin e ashpër që marrin këta fëmijë; parregullsia e afrisë njerëzore lidhet me mungesën e një kontakti të vijueshëm me familjet e tyre; makthet e gjumit lidhen me trauma të fëmijërisë së hershme; ndërsa format e papërshtatshme për kërkim vëmendjeje lidhen me shpërfilljen dhe braktisjen që kanë pësuar ata.

Fëmijëve u ofrohen një numër shërbimesh që kanë të bëjnë me ushqimin, kujdesin mjekësor, higjienën dhe arsimimin. Sadoqë këto janë gjëra të nevojshme, mënyra se si u jepen fëmijëve përfaqësojnë për ta kërcënim: ndërkohë që i gëzojnë këto shërbime të ndryshme, ata kanë humbur pavarësinë dhe iniciativën vetjake, ata presin që gjithçka të jetë e gatshme për ta. Fëmijët duhet të inkurajohen e të aftësohen që të marrin një rol më aktiv në jetën e institucionit. Për shembull fëmijët mund të marrin në dorë shumë veprime në këto institucione. Iniciativa, pjesmarrja në vendimarrje dhe në marrje përgjegjësish do të ishin të gjithë faktorë pozitivë në zhvillimin e tyre. Vështirësitë që kanë kaluar këta fëmijë në familjet e tyre dhe në institucione duket se i kanë mbushur ata me një frikë të dukshme ndaj jetës dhe së ardhmes. Këta fëmijë gjejnë rehat në faktin se për sa kohë janë në institucion e kanë të garantuar strehimin, ushqimin, kujdesin mjekësor dhe veshmbathjen. Por nga e ardhmja kanë frikë. Në disa raste këto frikëra janë të përligjura, pasi pas një moshe të caktuar disa fëmijë i kanë transferuar në një konvikt ose gjetiu ku ata s'kanë pasur më mbështetje, ku kanë vuajtur paragjykimet e të tjerëve, e në ndonjë rast kanë rënë viktima trafikantësh e kriminelësh të tjerë. Frika nga e ardhmja bllokoi zhvillimin psikosocial të fëmijëve. Atyre u nevojitet një perspektivë më pozitive (ndoshta nëpërmjet besimit që ngjallin mundësitë e rezultateve të mira në mësim), por institucionet nuk ia kanë arritur ta ushqejnë këtë gjë.

4.5 Administrimi i ankesave


Nuk ka ndonjë sistem dhe procedura për të trajtuar ankesat e fëmijëve që jetojnë në institucione të kujdesit social. Rregulli është rutina e trashëguar nga e kaluara. Ngaqë kanë shtytjen për t'u ankuar, fëmijët ankohen te mësuesit e tyre ose te drejtuesit i institucionit. Sidoqoftë të gjitha ankesat dhe pasojat e tyre trajtohen gojarisht, nuk ekziston asnjë dokumentacion. Trajtimi i ankesave në thelb varet nga etika dhe personaliteti i njeriut që meret me to. Ndaj duket se është nevoja për rregullore të vërteta që do të hartoheshin dhe do të bëheshin të detyrueshme në mënyrë që të regjistrohet ajo që ndodh. Do të ishte gjithashtu e nevojshme të përfshihej këtu siguria e fëmijëve që të mos ketë hakmarrje për shkak ankese. Thuhet se nuk është e mundur të ndodhin akte hakmarrjeje, por kjo nuk duket e besueshme pasi tërthorazi prania e tyre dallohet në

numrin shumë të ulët të ankesave të fëmijëve. Kjo tregon frikën që kanë fëmijët nga pasojat e ankimit.

Në përgjithësi mungesa e rregulloreve për të trajtuar ankesat dhe për t'u mbrojtur ndaj hakmarrjes kanë një efekt negativ në zhvillimin psikosocial të fëmijëve, meqë fëmijët zhvillojnë një qëndrim armiqësor ndaj botës.

4.6 Profili i personelit dhe zhvillimi profesional

Diagrami 6. Përshtatshmëria e nivelit arsimor/kualifikues të personelit që punon në fushën e trajtimit të fëmijëve të institucionalizuar



Diagrami tregon se 2/3 e punonjësve të sistemit të kujdesit social për fëmijë kanë mbaruar arsimin e mesëm ndërsa 1/4 e tyre janë diplomuar në arsimin e lartë. Në tërësi raporti midis arsimit të mesëm me atë të lartë duket i përshtatshëm.

Në bazë të disa të dhënave janë gjithsej 500 vetë të punësuar në sistemin e kujdesit për fëmijë, ku secilit i takon të mbulojë përkatësisht dy fëmijë. Në qoftë se kjo shifër është e saktë, del pyetja nëse është në gjendje një shtet i varfër që të mbajë një raport kaq bujar personel:fëmijë. Siç u përmend më sipër, për çdo fëmijë të moshave 0 deri 3 vjeç shpenzohen në muaj 28 000 lekë, ndërsa për moshat 6 deri 14 vjeç shpenzimi është 41 500 lekë në muaj.³⁷ Në qoftë se këto shifra janë të sakta, çështja e shpenzimeve të shërbimit social është një çështje e mprehtë.

Mësuesit kanë arsimim të ndryshëm, përfshirë këtu edhe ekonominë e bujqësinë. Sidoqoftë të paktë janë anëtarët e personelit që janë trajnuar si punonjës social ose si psikologë. Zhvillimi psikosocial i fëmijëve të vendosur në këto institucione lidhet drejtpërdrejtë me arsimimin dhe trajnimin e personelit. Anëtarët e personelit që kanë mbaruar shkolla bujqësore dhe ekonomike mund të dinë se si rriten bimët dhe se si shumëfishohen ato, ndërkohë që në tregun e punës ka plot njerëz të tjerë të kualifikuar që do mund të punonin në fushën e rritjes dhe zhvillimit të fëmijës. Arsimimi dhe kualifikimi i shumicës së personelit i ka përgatitur ata që të ofrojnë disa shërbime të një karakteri fizik. Për këtë arsye institucionet përqendrohen në kushtet fizike të jetesës dhe jo në zhvillimin psikologjik dhe social të fëmijëve. Në këtë këndvështrim këto institucione duken më shumë si institucione mbështetëse (që japin ushqim, strehim dhe kujdes mjekësor) sesa institucione që sigurojnë zhvillimin psikosocial të fëmijëve. Për këtë arsye duhet rishikuar sistemi i punësimit të personelit. Është i nevojshëm zbatimi i kriterëve të rrepta në

³⁷ Burimi: nga intervistat me drejtuesit e institucioneve të kujdesit social në Tiranë.

punësimin e personelit të kujdesit social, po ashtu siç është përmirësimi në kualifikim e tyre profesional, me qëllim aktualizimin e cilësisë së shërbimeve.

Në dhjetëvjeçarin e fundit kanë qënë të shumta shoqatat e huaja dhe vendase, fondacionet dhe agjensitë që kanë ofruar trajnim në fushën e kujdesit social për fëmijët. Këto seanca trajnimi kanë qënë mbi bazë bamirësie dhe efekti i tyre është i dukshëm te personat që janë trajnuar. Sidoqoftë këto seanca trajnimi nuk janë ofruar për të gjithë sistemin, duke shkaktuar ndryshime në nivelet e trajnimit të personelit. Për shembull janë trajnuar shumë edukatorë por jo kujdestarët dhe personeli tjetër mbështetës; mirëpo kjo pjesë e personelit ka ndikim të fortë mbi zhvillimin psikosocial të fëmijëve.

Nuk ka pasur ndonjë shkëmbim përvojë midis institucioneve që kanë marrë trajnime me ato që nuk kanë marrë. Përveç kësaj personeli i institucioneve nuk bën trajnim periodik për të aktualizuar njohuritë dhe aftësitë e tyre në fushën e rritjes dhe kujdesit për fëmijë. Duket se ky trajnim nuk shihet si përparësi. Institucionet zhvillojnë programe të brendshme trajnimi por përgjithësisht këto nuk zbatohen për mungesë fondesh. Sido që të jetë programet e trajnimit janë të sipërfaqshme. Ato nuk mbështeten mbi një vlerësim të personelit ose të nevojave të fëmijës për trajnim. Fushat kryesore ku nevojitet trajnimi janë psikologjia e fëmijës; teknikat për stimulimin fizik, mendor dhe emocional të fëmijës; të drejtat e fëmijës dhe teknikat e disiplinimi pozitiv.

Rrogat e personelit janë të ulta dhe kjo ka pasoja mbi motivimin e tyre. Edukatorët në këto institucione paguhen më pak sesa mësuesit në shkollat publike. Përveç kësaj ka raste kur individëve që ishin caktuar si edukatorë u kërkohet të kryejnë punën e kujdestarit ose të infermierit e paguhen përkitazi më pak. Edhe kjo ndikon në cilësinë e rendimentit të tyre.

4. 7. Monitorimi, hetimi dhe raportimi i trajtimit të fëmijëve

Në nivel institucional kjo kryhet nga edukatorët dhe kujdestarët. Të dyja këto kategori të personelit merren drejtpërsëdrejti me fëmijët dhe raportojnë për problemet e tyre. Ky personel nga ana e vet monitorohet nga persona përgjegjës në institucione. Monitorimi nuk kuptohet si një sistem që jep informacionin e nevojshëm lidhur me punën në institucione. Duket se ka mangësi në sistemin e informacionit dhe punën që mbështetet mbi të.

Nga jashtë institucionit është Inspektoriati i Shërbimit Social Shtetëror ai që kryen inspektimin dhe shkruan raportin mbi problemet që identifikohen. Ka mundësi për të përmirësuar këto inspektive. Sidomos ato duhet të mbështeten mbi protokolle të detajuara e duhet të drejtohen prej personash që kanë një arsimim të përshtatshëm dhe përvojë për këtë punë.³⁸ Analiza e këtij dokumentacioni nxori se shumë raporte janë të

³⁸ Për këtë qëllim ekipi vëzhgues analizoi këtë dokumentacion: Raporti i analizës 9-mujore i Shtëpisë së Foshnjës "Hannah dhe Rozafa", Tiranë; Raport i Drejtorisë së Përkujdesit Shoqëror

mbushura me fjalë pa kuptim dhe japin përshkrime spekulative pa u mbështetur mbi fakte. Nuk ka vazhdimësi midis raporteve. Nuk ka ndonjë referencë ndaj standardeve (të cilat sidoqoftë nuk ekzistojnë). Zhvillimi psikosocial i fëmijëve trajtohet në një mënyrë të sipërfaqshme ose, më e zakonshme, nuk trajtohet fare. Nuk ka ndonjë format standard të raportimit. Raportimet rrallë e tek u referohen problemeve të mprehta që dihet se ekzistojnë në këto institucione. Raportimi i trajtimit të fëmijëve në përgjithësi është joprofesional.

Raportet e shqyrtuara nga ekipi hulumtues të lënë përshtypjen se ato nuk janë shkruar me synimin e vlerësimit të shërbimeve për fëmijët dhe për zhvillimin e fëmijëve, por për të përmbushur nevojat e institucionit, që duket se nuk kanë të bëjnë fare me fëmijët. Kujdesi që u kushtohet fëmijëve trajtohet në aspektet fizike dhe shumë pak në aspektet psikologjike dhe sociale; ndaj dhe raportimi priret që të përqendrohet në të parin.

Në mënyrë të ngjashme Shërbimi Social Shtetëror monitoron institucionet nëpërmjet Drejtorisë së Përkujdesit Shoqëror. Raportimet që i janë paraqitur kësaj drejtorie kanë të njëjtat mangësi të përmendura më lart. Në fakt vlerësimet që prodhon kjo drejtori nuk të japin ndonjë perspektivë të jashtme, meqë janë hartuar prej njerëzish që punojnë në të njëjtin sektor.

Këto raportime kanë edhe informacione të dobishme. Për shembull ka aty dokumentim për gjendjen shëndetësore të fëmijës e për zhvillimin e tij fizik, po ashtu edhe për birësimet. Këto praktika pozitive janë më të dukshme në rastin e fëmijëve të moshave 0 deri në 3 vjeç e më pak në rastin e fëmijëve më të rritur.

Natyrisht që ka një ndarje të punës midis mësuesve dhe kujdestarëve. Vërtet që kjo është e arsyeshme, por ajo nuk lejon që shërbimet e përqendruara mbi fëmijën të jepen në mënyrë të plotë. Statusi i edukatorit zakonisht shihet si më i lartë sesa statusi i kujdestarit. Ndërkohë që puna e kujdestarit është e dukshme dhe e matshme, puna e edukatorit nuk është e tillë.

4.8. Puna me fëmijët mbi bazën e planeve të zhvilluara individualisht

Institucionet e kujdesit social për fëmijët kanë plane pune, por ato kanë një natyrë globale dhe i trazojnë të gjithë fëmijët në një kosh. Nuk ka diskutime ose ka fare pak mbi raste të caktuara ose mbi probleme të ndryshme, në konferenca të rregullta dhe periodike. Nuk ka punë shumë disiplinore dhe shkëmbim të përvojave ndërmjet personelit.

në Drejtorinë e Përgjithshme, në 2004; Akt kontrolli në Shtëpinë e Fëmijës 6-14 vjeç Sarandë; Akt kontrolli në Shtëpinë e Fëmijës 6-14 vjeç Shkodër, i vitit 2003; Raporti i analizës së 6-mujorit të parë të vitit 2005 në Qendrën e Zhvillimit Shkodër; Raporti i analizës së veprimtarisë së fëmijës 0-3 vjeç në Tiranë për 8 muajt e vitit 2005; Raporti i analizës së punës së Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë, për 9-mujorin e parë të vitit 2005; Informacion mbi analizat vjetore të institucioneve të kujdesit social. Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

Vëzhgimet mbi institucionet e kujdesit social dëftojnë se kujdesi drejtohet për kah aspekti fizik: strehimi, ushqimi, higjiena dhe shëndeti. Ka shumë pak gjë në lidhje me mirëqenien psikologjike të fëmijës. Në vitet e fundit janë angazhuar aty-këtu psikologë ose punonjës socialë, por kjo nuk ka qenë e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e fëmijëve. Shumë fëmijë vazhdojnë të kenë vlerësim të ulët për vetveten, të ndihen të braktisur, të paafte që të përballin problemet e tyre psikologjike. Gjatë njërës prej vizitave të ekipit hulumtues, një fëmijë shurdhmemec, më i moshuar se të tjerët, rrinte gjithë kohën jashtë ndërtesës në afërsi të institucionit dhe duke provokuar gjuante me një top tenisi në drejtim të personelit; më në fund theu xhamin e derës së përparme të institucionit. Kjo sjellje agresive që nuk lidhej me ndonjë faktor të jashtëm, dukej se shkatohej nga burime të brendshme të cilat duhen trajtuar. Sidoqoftë personeli dhe drejtuesit e institucionit janë të paafte të ofrojnë një trajtim të tillë. Kështu mund të thuhet se nevoja të caktuara psikologjike nuk plotësohen.

Në shumicën e rasteve institucionet janë të kënaqura në rast se fëmijët nuk trazojnë të tjerët, edhe në qoftë se ata nuk ndihen mirë. Institucionet zakonisht fëmijët me probleme të rënda i drejtojnë në qendra të tjera ose organizma të jashtëm, që mund të ofrojnë shërbime të specializuara. Në një numër rastesh institucionet i kanë drejtuar fëmijët në organizma joqeveritarë për ndihma. Jo të gjitha institucionet janë në gjendje ta bëjnë këtë gjë, meqë këto organizma janë të paktë dhe të vendosur vetëm në Tiranë. Natyrisht në vend ka një numër terapeutësh që janë diplomuar në universitete.

Në këto kushte kërkesa që duhen zhvilluar plane trajtimi për fëmijët me nevoja të veçanta, është një formalitet i thjeshtë. Këto institucione nuk kanë kapacitetet e nevojshme dhe as kulturën e duhur për të bërë diagnoza profesionale, vlerësime shumëdisiplinore, për të hartuar plane trajtimi individual ose grupi, apo që të këshillohen lidhur me përparimin e trajtimit. Natyrisht që ka plane pune, por ato nuk zbatohen; ato thjesht raportohen pa arritur të zbatohen.

Shërbimi social i ofruar në institucione priret drejt përqendrimit në punën shëndetësore dhe atë arsimore, e në këtë drejtim ka pasur disa përvoja pozitive. Nuk duhet kuptuar sikur në këtë fushë s'ka shqetësime.

Në bazë të të dhënave që jep drejtorja e institucionit, fëmijët e institucionalizuar në përgjithësi nuk kanë rezultate të mira në shkollë, megjithëse ndjekin të njëjtën shkollë si dhe fëmijë të tjerë në qytet, megjithëse shkollat janë të pajisura me mjetet e nevojshme dhe fëmijët studiojnë rregullisht nën mbikëqyrje.

Mbikëqyrja e fëmijëve gjatë orëve të studimit është veprimtaria kryesore e edukatorëve të institucionit). Rezultatet e mësimave tek fëmija i institucioneve natyrisht që nuk janë një tregues i plotë i zhvillimit të tyre njohës: edukatorët dhe vëzhguesit e rastësishëm nga jashtë e vërejnë menjëherë se fëmijët e institucioneve janë të zgjuar. Kjo ngre pyetjen: përse këta fëmijë kanë rezultate të dobëta në mësim. Përparimi i tyre në shkollë përcakton në një masë të madhe shanset në jetën e ardhshme. Është nevoja që

të bëhet përqendrim në këtë problem, për të parandaluar shanset e ulta që kanë këta fëmijë në të ardhmen.

4.9 Të drejtat e fëmijëve në institucione dhe të fëmijëve të tjerë

Gjatë vizitës në institucione ekipi hulumtues vërejti se fëmijët lëvizin në zonat e zyrave dhe kanë kontakte të rralla me vizitorët. Në institucione mbretëron heshtja kur fëmijët studiojnë. Në dhomat e fjetjes zotëron rregulli. Askush nuk u pa në terrenet sportive. Fëmijët nuk lejohen të shkojnë në diskoteka, megjithëse do të mundnin. Djemtë dhe vajzat flejnë në godina të veçanta. Ndokush mund të mendonte se kufijtë që u vihen këtyre fëmijëve kanë për qëllim t'i mbrojnë ata. Kërcënimet vërtet ekzistojnë dhe institucionet janë të vetëdijshme për to. Mirëpo ajo që duhet bërë është garancia që një mbrojtje e tillë nuk e shtyp lirinë e fëmijëve.

Në qoftë se fëmija do që të dalë jashtë institucionit për të blerë ndonjë gjë, ai duhet të ketë një leje me shkrim të nënshkruar nga drejtuesi i institucionit. Mundësia tjetër është që një mënues ta shoqërojë fëmijën ku ai shkon të blejë diçka në kioskën aty afër. Kjo liri e kufizuar lëvizjeje përligjet me dëshirën për të siguruar fëmijën. Më anë tjetër mund të argumentohet se kjo i shërben izolimit të fëmijëve prej komunitetit. Një izolim i tillë ka efekt negativ mbi integrimin e tyre të ardhshëm në shoqëri.

Privatësia e fëmijëve është e kufizuar: ata nuk kanë sende personale, çdokush mund të hapë dollapet e tyre, kushdo mund të hyjë në dhomat e tyre të fjetjes pa kërkuar leje e dhomat e tyre janë pa çelës. Vihet re gjithashtu se nuk ka fotografi të të afërmeve të tyre nëpër mure. Kështu këta fëmijë janë gjithmonë të ekspozuar e të kontrolluar, ata kanë pak ose aspak hapësirë personale dhe private. Këto elemente tregojnë se ka dështuar puna për njohjen e nevojave të tyre. Po të flitet në këndvështrim psikologjik këta fëmijë kanë nevojë të kenë zotërimet e tyre, të identifikohen me të afërmit e tyre, të kenë jetën e tyre private. Në këtë drejtim mund të bëhen ndryshime të rëndësishme.

Grupi kërkimor nuk mblodhi të dhëna të veçanta lidhur me raportin midis gjetjeve që u përshkruan më sipër dhe nivelit psikologjik e zhvillimit social të fëmijëve. Megjithatë është e qartë se këto kufizime në jetën e tyre, mungesa e jetës private kanë pasoja dhe këto mund të dëmtojnë në të ardhmen aftësinë e tyre për integrim në shoqëri.

4.10 Kërkimet për kujdes alternativ për fëmijët në institucione

Ekziston një kërkesë e fortë që institucionet e kujdesit social të gjejnë mënyra për t'i vendosur fëmijët nëpër familje. Institucionet në të vërtetë bëjnë përpjekje për t'i kthyer fëmijët në familjet e tyre biologjike apo për t'i vendosur në familje tutorësh.

Gjetja e familjeve alternative lidhet me përmasën e punës së komunitetit. Porse sikurse u përmend edhe gjetiu, këto institucione nuk duket se e kanë kulturën e punës me komunitetin, nuk u kërkohet një gjë e tillë, nuk kanë as personelin dhe as buxhetin e nevojshëm për këtë. Në këto kushte kërkimi i një mjedisi familjar alternativ kufizohet në biseda me të afërmit që vijnë e kontaktojnë vetë institucionin. Në shumë raste, edhe në qoftë se këta persona kanë lidhje biologjike me një fëmijë (janë për shembull gjysh a gjyshe dhe teze), janë edhe të gatshëm ta marrin në shtëpitë e tyre një fëmijë jetim ose të braktisur, shumë prej tyre s'kanë mundësi ta bëjnë këtë gjë. Nuk ka ndihmë ekonomike për këtë qëllim e as nuk është parashikuar kjo në legjislacionin aktual.

4.11 Marrëdhëniet midis institucioneve, fëmijëve në institucione dhe familjeve/komuniteteve të tyre

Shumë fëmijë të institucioneve vazhdojnë t'i mbajnë kontaktet me familjet e tyre. Megjithatë duket se institucionet nuk bëjnë përpjekje për të ndikuar mbi familjet e fëmijëve ose, kur i bëjnë këto përpjekje, nuk janë të sigurt sa do të ketë sukses ndërhyrja e tyre. Në disa raste institucionalizimi do të thotë që fëmijët në të vërtetë janë braktisur aty përgjithmonë. Kjo lidhet më shumë me prindët sesa me punën e institucionit. Fëmijët marrin një numër shërbimesh në institucion dhe ndaj e pëlqejnë atë. Në shumë raste kushtet e jetesës në institucion janë shumë më të mira se ato që kanë në shtëpi. Me të vërtetë ekipi hulumtues u informua se fëmijët kanë frikë të madhe kur disa prej tyre kërcënohen se do t'i përjashtojnë. Një numër familjesh që i kanë vendosur fëmijët e tyre në këto institucione ndihen mjaft të lehtësuara që institucionet kujdesen për fëmijët e tyre. Sidoqoftë në shumë raste kjo çon në atë që këto familje nuk ndiejnë më asnjë përgjegjësi për fëmijët e tyre. Në anë tjetër vetë ekzistenca e institucioneve për fëmijë në nevojë i bën shumë fëmijë të mendojnë se mund të bëjnë ç'të duan dhe askush nuk mund t'i përjashtojë. Transferimi i tyre në një institucion tjetër të ngjashëm është gjëja më e keqe që mund të ndodhë. Kjo e bën zhvillimin e disa skemave për të siguruar disiplinë të nevojshme, sidomos ato forma discipline që do t'i përgatisin fëmijët për jetën jashtë institucionit. Me sa kuptohet nuk ka protokolle lidhur me disiplinën dhe mësuesit mundohen ta sigurojnë disiplinimin e fëmijëve si t'u vijë për mbarë.

Statusi i këtyre fëmijëve kthehet në një problem të mprehtë kur qëndrimi i tyre në institucion i afrohet fundit, në moshën 14 vjeç, dhe atyre do t'u duhet të përballen me jetën jashtë institucionit. Ata janë ende fëmijë dhe shteti duhet të kujdeset për ta edhe kur ata zhvendosen në një mjedis tjetër.

Shkollimi përfaqëson lidhjen më të fortë midis institucionit dhe komunitetit. Fëmijët e institucioneve duhet të trajtohen zyrtarisht njësoj si nxënësit e tjerë të shkollës. Megjithatë rezultatet e dobta në mësimet të fëmijëve të institucioneve kërkojnë që të analizohet lidhja e tyre me komunitetin. Gjatë vitit shkollor fëmijët e kalojnë shumicën e kohës së tyre

brenda mureve të institucionit dhe vetëm gjatë verës ata mund të lëvizin pak më lirshëm e të bëjnë një jetë më aktive. Drejtoria e institucionit dhe personeli kanë frikë t'i lënë fëmijët jashtë institucionit, ngaqë mund t'u ndodhë ndonjë gjë e keqe. Kjo frikë i ka reduktuar veprimtaritë jashtë institucionit në një minimum, deri në atë pikë ku mund të thuhet se është dëmtuar zhvillimi i sistemit motorik të fëmijëve.

Puna sociale që kryhet nga institucionet e kujdesit social për fëmijët ka një hap të kufizuar. Asaj i mungon sidomos përmasa e lidhjes me komunitetin. Për shembull sapo që bëhet një birësim, institucioni nuk tregon më asnjë interes për fëmijën. Kjo temë të shtyn të hetosh më tej. Buxheti i varfër institucional për punë sociale me familjen e fëmijës është një tjetër çështje. Si rrjedhojë instituti e thellon punën e vet me familjen vetëm në rastet kur familja vetë i afrohet institucionit. As pushteti lokal nuk ka marrë përsipër përgjegjësinë e monitorimit të komunitetit për mbrojtjen e fëmijëve dhe mbështetjen e familjes së tyre, ose për të gjetur mundësi alternative të kujdesit e për të bashkëpunuar me institucionet sociale të kujdesit për fëmijët. Mungesa e fondeve shpjegon deri-diku mungesën e vizionit të punës sociale me synim kah komuniteti, si dhe aspektet organizative, teknike, financiare dhe materiale.

Puna me median është gjithashtu pjesë e punës së institucionit me komunitetin. Lidhjet midis institucioneve të kujdesit social dhe medias janë delikate: këto institucione kanë frikë nga mediat. Kjo e fundit mund të zbulojë mangësi të cilat do të sillnin pasoja për drejtorinë dhe personelin e institucionit. Për rrjedhim, sipas të dhënash jo të konfirmuara, këto institucione nuk janë transparente. Raportimi kritik i medias në raste keqtrajtimesh ka kontribuar në prirjen e vendosur të këtyre institucioneve për të mos qënë të hapura. Kur u pyetën për këto gjëra gjatë intervistave, pothuajse të gjithë bënë ngërdheshje. Kjo dëftën me sa duket se bëhet kujdes që të mos zbulohen aspektet negative të trajtimit të fëmijëve të institucionalizuar, me qëllim që të mbrohen personat përgjegjës. Këto institucione duket se nuk bëjnë përpjekje për të përmirësuar marrëdhëniet e tyre me median, me qëllim që edhe kjo të përfshihet në objektivat e institucioneve dhe në mirëqenien e fëmijëve.

Lidhjet me organizatat jofitimprurëse të kujdesit social për fëmijët nuk janë shumë më të ndryshme: në një numër institucionesh publike dëgjon që organizatat jofitimprurëse ose nuk kanë interes për punën e institucioneve publike ose e vështrojnë këtë punë negativisht.

4.12 Burimet materiale për nxitjen e zhvillimit të fëmijëve

Fëmijët mund të përdorin dhomat e gjumit, dhomat e studimit, librari, terrene sportive, dhomën e televizorit, banjat dhe mensat. Kudo grupi kërkimor vërejti se mjediset e caktuara për banim dhe çlodhje ishin të mjaftueshme.

Shumica e institucioneve kanë fare pak lodra, si kukulla ose kafshë prej pelushi. Institucionet nuk kanë buxhet të veçantë për lodra, kështu që gjithçka aty është e dhuruar. Lojrat që janë në dispozicion nuk u korrespondojnë gjithmonë nevojave zhvillimore të fëmijës dhe moshës së tyre. Në përgjithësi ka mangësi materialesh për të luajtur. Fëmijët luajnë më së shumti me objekte natyrore që i gjejnë në terrenin e institucionit. Pothuajse nuk ekzistojnë fare lodra edukative ose instrumenta muzikore apo materiale për vizatim e pikturë.

Lojrat shihen nga personeli i institucionit si zbavitje për fëmijët dhe jo si një mundësi për zhvillim. Ndaj dhe në oborre mbizotëron një lojë e paorganizuar, format e organizuara janë të rralla. Kudo institucionet kanë një kapacitet më të madh për të organizuar sporte dhe veprimtari kulturore sesa bëjnë faktikisht. Për shembull terrenet sportive rrijnë bosh për periudha të gjata kohe.

Libraritë janë ose të pakta ose bosh. Ata libra që ekzistojnë aty-këtu përgjithësisht janë të vjetër dhe jo të përshtatshëm për fëmijët. Për shembull nuk ka praktikisht libra me ilustrime me ngjyra për fëmijë të vegjël. Nuk ka revista dhe as gazeta.

Për edukatorët është komode t'i lënë fëmijët të shikojnë televizion. Të intervistuarit thanë se fëmijët kënaqen kur shikojnë telenovela e ata mund të përdorin disa televizione, pastaj në kohë dimri është e vështirë të organizosh veprimtari jashtë godine për shkak të motit. Natyrisht telenovelat, sado që janë komode për edukatorët, nuk janë të përshtatshme për fëmijët, për të mos thënë që janë të dëmshme për zhvillimin e tyre psikosocial. Këto shfaqje televizive i bombardojnë fëmijët me gjithfarëlloj stimulues erotikë e informacionesh që janë si shqetësuese për fëmijët ashtu edhe të vështira për ta për t'i kuptuar siç duhet.

Aneksi 1

Lista e institucioneve të identifikuara

Institucionet Residenciale Publike

	Emërtimi	Vëndndodhja
a)	Shtëpitë e fëmijëve	
1	Shtëpia e Foshnjës « Herman Greimer »	Sauk, Tiranë
2	Shtëpia e Foshnjës « Shtëpia jonë »	Lagjia no.14 Shkozet, Durrës
3	Shtëpia e Foshnjës Shkodër	Lagjia Tom Kola, Rr. Lin Delia, Shkodër
4	Shtëpia e Foshnjës 0-6 vjec	Ujë i Ftohtë, 7 pallatet , Vlorë
5	Shtëpia e Foshnjës « Lulet e Vogla »	Rr. Fan Noli, Korçë
6	Shtëpia e fëmijëve parashkollorë, Shkodër	Shkodër
7	Shtëpia e fëmijëve Shkollorë, « Z. Hallulli »	Rr. Elbasanit, Tiranë
8	Shtëpia e fëmijëve Shkollorë, Shkodër	Rr. Migjeni, no. 58, Shkodër
9	Shtëpia e fëmijëve Shkollorë, Sarandë	Lagjia 2, Rr. Adem Sheme, Sarandë
b)	Qëndrat Residenciale të Zhvillimit	
1	Qendra e Zhvillimit Tiranë « Pëllumbat »	Rr. Stavri Vinjao, Tiranë
2	Qendra e Zhvillimit Vlorë	Ujë i Ftohtë, 7 pallatet, Vlorë
3	Qendra e Zhvillimit Berat	Lagjia Kushtrimi, Berat
4	Qendra e Zhvillimit Durrës « Valët e detit »	Lagjia 12, Rruga Koco Kazanxhi, Durrës
5	Qendra e Zhvillimit Korçë	Rr. Clirimi i Korçës, Korçë
6	Qendra e Zhvillimit Shkodër	Lagjia Skëndergeg, Rr. Tregu I ri, Shkodër

Institucionet Residenciale të drejtuara nga OJQ

	Emërtimi	Vëndndodhja
1	Vatër e ngrohtë	Lagjia Palorto, Gjirokastrë
2	Fshati i Paqes	Nënshat dhe Shkodër
3	Betania	Komuna Bubq, Krujë
4	Fëmijët e Tij	Tiranë
5	Shtëpia e shpresës	Shënvllash, Durrës
6	Brez i zgjedhur	Komuna Kodër Thunamë, Krujë
7	Fillimet e reja	Lagjia Gorrice, rr. Nikollaq Buhuri, no.36, Berat
8	Shtëpia në zemër	Rruga Frosina Plaku, no.31, Tiranë
9	Eden	Tiranë
10	Rreze dielli	Rruga Frosina Plaku,no.36, Tiranë
11	Orët fatlume	Elbasan
12	Shtëpia e shpresës	Elbasan
13	Nënë Tereza	Shkodër
14	Të rinjtë me një mision	Lagjia Pjetër Budi, Burrel
15	Eden	Rr. Arben Brozi, Tiranë

Institucionet e tipit Shtëpi - Familje

	Emërtimi	Numri i shtëpive familje	Vëndndodhja
1	Madonnina della grapa	3	Lagjia Gjuhadol, Shkodër
2	Projekti Shpresa	5	Lagjia 3 Heronjt, Rr. Ndoc Mazi, Shkodër
3	Pueri Domini	1	Tiranë
4	Fshati Fëmijëve SOS	13	Sauk, Tiranë
5.	Tjetër vision	2	Elbasan

Qendra ditore për fëmijë të neglizhuar

	Emërtimi	Vëndndodhja
1	Qendra DEA	Rruga Liri Gero, Fier
2	Qendra DEA	Tiranë
3	Qendra ditore për fëmijët Romë	Tiranë
4	Edukimi per jeten	Tiranë
5.	City of angels	Tiranë
6	Balkan sunflowers	Rr. Dom Bosko, Tiranë
7	Ferilasse	Rr. Budi, Tiranë
8	Fëmijët e Botës	Rr. Niko Avrami, Tiranë

Qendra pritëse për fëmijë të riadhesuar

	Emërtimi	Vëndndodhja
1	Qendra pritëse e viktimave të trafikut dhe fëmijëve të riadhesuar	Tiranë (Linzë)

Lista e personave të kontaktuar

Natasha Hodaj	Drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror
Gëzim Tushi	Nën/Drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror
Denada Dibra	Ekspert per fëmijet, Shërbimi Social Shtetëror
Frida Kusi	Jurist , Shërbim Social Shtetëror

Merita Beqiri	Ekspert për fëmijët, Shërbimi Social Shtetëror
Gramoz Xhangolli	Jurist, Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta
Teuta Panariti	Specialist i Statistikave, Shërbimi Social Shtetëror
Milda Broka	Drejtor i Shtëpisë së Foshnjës "Herman Greimer, Tiranë
Merita Llakaj	Drejtor i Shtëpisë së Foshnjës "Shtëpia jone", Durrë
Marita Sopi	Drejtor i Shtëpisë së Foshnjës, Shkoder
Etleva Luli	Drejtor i "Hana dhe Rozafa", Shkoder
Liljana Qejvani	Drejtor i Shtëpise se Foshnjes, Vlore
Alketa Hila	Drejtor i Shtëpisë së fëmijëve shkollorë « Zyber Hallulli »
Arjan Dushaj	Drejtor i Shtëpisë së fëmijëve shkollorë 7-14, Shkoder
Pertit Qyrku	Drejtor i Shtëpisë së fëmijëve shkollorë 7-14, Sarande
Edo Sherifi	Drejtor i Qendrës së Zhvillimit , Tiranë
Zhuljeta Nasho	Drejtor i Qendrës së Zhvillimit, Vlorë
Rajmonda Ruci	Drejtor i Qendrës së Zhvillimit, Durrë
Eglantina Shtrepi	Drejtor i Qendrës së Zhvillimit, Berat
Gjystina Haxhi	Drejtor i Qendrës së Zhvillimit, Shkodër
Arjana Skllavi	Drejtor i Qendrës së Zhvillimit, Korcë
Fatmira Cako	Drejtor i Qendrës Pritëse në Linzë
Marcel Lacej	Shërbimi Social Shtetëror, Lezhë
Petraç Konduri	Shërbimi Social Shtetëror, Durrës
Kujtim Rexha	Shërbimi Social Shtetëror, Kukës
Fadil Begu	Shërbimi Social Shtetëror, Dibër
Edmond Emini	Shërbimi Social Shtetëror, Shkodër
Xhemali Lamcellari	Shërbimi Social Shtetëror, Korcë
Eno Koleka	Shërbimi Social Shtetëror, Vlorë
Bashkim Ereqi	Shërbimi Social Shtetëror, Fier
Jolanda Dhima	Shërbimi Social Shtetëror, Elbasan
Stavri Peca	Shërbimi Social Shtetëror, Berat
Kujtim Demolli	Shërbimi Social Shtetëror, Gjirokastër
Bilbil Jaupi	Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë
Eneida Sako	Administrator of "Fillimet e reja" Berat
Marte Kola	Administratore Sociale, Bashkia Rrëshen
Përparim Demcellari	Drejtor i Fondacionit "Hope for world"
Afërdita Stefani	Presidente e Komitetit Shqiptar të Birësimeve
Lida Leskaj	Drejtor kombëtar, Shërbimi Social Shtetëror

Bibliografia

Rashel Rowlands, The European Children's Trust: "New opportunities: Improving child care services for Albania, 2000.

AiBi & Ministero per gli Affari Estero dell'Albania : Primo rapporto nazionale sull'adozione in Albania

UNICEF, Innocenti Research Centre: Changing minds, Policies and Lives, Improving protection of Children in eastern Europe and Central Asia; 2003

Shërbimi Social Ndërkombëtar, Seksioni Italian: E drejta e Fëmijës për t'u rritur në një familje.

Lucille C. Atkin, Ph.D. Instituto Nacional de Perinatologia, Mexico, "Analysis of Instruments Used in Latin America to Measure Psychosocial Development in Children from 0 to 6 Years of Age", 1989.

Judith L. Evans, From Entry Point to Consolidation: An Assessment of Early Childhood Provision in Nepal, 1992.

Qendra e Zhvillimeve Humane, Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri, 2005.

**Aneks 2 Numri I femijeve sipas grupmoshes dhe llojit te institucioneve
Institucionet Residenciale Publike**

	Emertimi	totali	0-6 vjec	6-14 vjec	Mbi 14 vjec
a)	Shtepite e femijeve				
1	Shtepia e foshnjes « Hana dhe Rozafa »	47	47	0	0
2	Shtepia e foshnjes « Shtepia jone »	16	9	7	0
3	Shtepia e foshnjes Shkoder	18	18	0	0
4	Shtepia e femijeve 0-6 vjec Vlore	31	31	0	0
5	Shtepia e foshnjes « Lulet e Vogla »	19	19	0	0
6	Shtepia e femijeve parashkollore Shkoder	41	41	0	0
7	Shtepia e femijeve Shkollore « Z. Hallulli »	60	0	39	21
8	Shtepia e femijeve Shkollore Shkoder	69	0	53	16
9	Shtepia e femijeve Shkollore Sarande	49	0	37	12
		350	165	136	49
b)	Qendrat Rezidenciale te Zhvillimit				
1	Qendra e Zhvillimit Tirane »Pellumbat «	1	0	0	1
2	Qendra e Zhvillimit Vlore	14	0	6	8
3	Qendra e Zhvillimit Berat	9	0	4	5
4	Qendra e Zhvillimit Durres « Valet e detit »	7	1	6	0
5	Qendra e Zhvillimit Korce	26	0	2	24
6	Qendra e Zhvillimit Shkoder	41	0	23	18
		98	1	41	56

Institucionet Residenciale te drejtuara nga OJQ

	Emertimi	Totali	0-6 vjec	6-14 vjec	Mbi 14 vjec
1	Vater e ngrrohte	9	9	0	0
2	Fshati i Paqes	29	4	16	9
3	Betania	85	36	42	7
4	Femijet e Tij	40	3	25	12
5	Shtepia e Shpreses (Shen Vlash , Durres)	25	4	19	2
6	Brez i zgjedhur	15	2	8	5
7	Fillimet e reja	11	1	7	3
8	Shtepia ne zemer	12	0	12	0
9	Eden	40	0	0	40
10	Rreze dielli	14	10	4	0
11	Oret fatlume	23	0	18	5
12	Shtepia e Shpreses (Elbasan)	35	0	19	16
13	Nene Tereza	36	2	10	24
14	Te rinjte me nje mision	12	0	9	3
15	City of angels	15	15	0	0
		401	86	189	126

Institucionet e tipit Shtepi - Familje

	Emertimi	Numri i shtepive familje	Totali	0-6 vjec	6-14 vjec	Mbi 14 vjec
1	Madonnina della grapa	3	18	0	0	18
2	Projekti Shpresa	5	54	2	11	41
3	Pueri Domini	1	5	3	2	0
4	Fshati I femijeve SOS	13	73	34	24	15
5.	Tjeter vision	2	19	0	9	10
			169	39	46	84

Qendra ditore per femije te neglizhuar

	Emertimi	Totali	0-6 vjec	6-14 vjec	Mbi 14 vjec
1	Qendra DEA Fier	34	0	32	2
2	Qendra DEA Tirane	20	1	18	1
3	Qendra ditore per femijet Rome	26	0	26	0
4	Edukimi per jeten	21	0	21	0
5	Balkan sunflowers	42	1	40	1
6	Ferilasse	18	0	18	0
7	Femijet e Botes	19	2	16	1
		180	4	171	5

Qendra pritese per femije te riadhesuar

	Emertimi	Vendndodhja
1	Qendra pritese e viktimave te trafikut dhe femijeve te riatdhesuar	Tirane (Linze)

Aneks 1 Lista e institucioneve te identifikuar

Institucionet Residenciale Publike

	Emertimi	Vendndodhja
a)	Shtepite e femijeve	
1	Shtepia e foshnjes « Hana e Rozafa»	Sauk, Tirane
2	Shtepia e foshnjes « shtepia jone »	Lagjia no.14 Shkozet, Durres
3	Shtepia e foshnjes Shkoder	Lagjia Tom Kola, Rr. Lin Delia, Shkoder
4	Shtepia e femijeve 0-6 vjec Vlore	Uje I Ftohte, 7 pallatet , Vlore
5	Shtepia e foshnjes « Lulet e Vogla »	Rr. Fan Noli, Korce
6	Shtepia e femijeve parashkollore Shkoder	Shkoder
7	Shtepia e femijeve Shkollore « Z. Hallulli »	Rr. Elbasanit, Tirane
8	Shtepia e femijeve Shkollore Shkoder	Rr. Migjeni, no.58, Shkoder
9	Shtepia e femijeve Shkollore Sarande	Lagjia 2, Rr. Adem Sheme, Sarande
b)	Qendrat Rezidenciale te Zhvillimit	
1	Qendra e Zhvillimit Tirane »Pellumbat «	Rr. Stavri Vinjao, Tirane
2	Qendra e Zhvillimit Vlore	Uje I Ftohte, 7 pallatet, Vlore
3	Qendra e Zhvillimit Berat	Lagjia Kushtrimi, Berat
4	Qendra e Zhvillimit Durres « Valet e detit »	Laggjia 12, Rruga Koco Kazanxhi, Durres
5	Qendra e Zhvillimit Korce	Rr. Clirimi i Korces, Korce
6	Qendra e Zhvillimit Shkoder	Laggjia Skendergeg, rr. Tregu I ri, Shkoder

Institucionet Residenciale te drejtuara nga OJQ

	Emertimi	Vendndodhja
1	Vater e ngrohje	Lagjia Palorto, Gjirokaster

2	Fshati i Paqes	Nenshat dhe Shkoder
3	Betania	Komuna Bubq, Kruje
4	Femijet e Tij	Tirane
5	Shtepia e shpreses	Shenvlash, Durres
6	Brez i zgjedhur	Komuna Koder Thuname, Kruje
7	Fillimet e reja	Lagjia Gorrice, rr. Nikollaq Buhuri, no.36, Berat
8	Shtepia ne zemer	Rruga Frosina Plaku, no.31, Tirane Tirane
9	Eden	RR. Arben Brozi, Tirane
10	Rreze dielli	Rruga Frosina Plaku,no.36, Tirane
11	Oret fatlume	Elbasan
12	Shtepia e shpreses	Elbasan
13	Nene tereza	Shkoder
14	Te rinjte me nje mision	Lagjia Pjeter Budi, Burrel
15	City of Angels	Materniteti , Tirane

Institucionet e tipit Shtepi - Familje

	Emertimi	Numri i shtepive familje	Vendndodhja
1	Madonnina della grapa	3	Lagjia Gjuhadol, Shkoder
2	Projekti Shpresa	5	Lagjia 3 Heronjt, Rr. Ndoc Mazi, Shkoder
3	Pueri Domini	1	Tirane
4	Fshati I femijeve SOS	13	Sauk, Tirane
5.	Tjeter vision	2	Elbasan

Qendra ditore per femije te neglizhuar

	Emertimi	Vendndodhja
1	Qendra DEA, Fier	Rruga Liri Gero, Fier
2	Qendra DEA	Tirane
3	Qendra ditore per femijet Rome	Tirane
4	Edukimi per jeten	Tirane
5	Balkan sunflowers	Rr. Dom Bosko, Tirane
6	Ferilasse	Rr. Budi, Tirane
7	Femijet e Botes	Rr. Niko Avrami, Tirane (prane hkolles Bajram Curri)

Qendra pritese per femije te riadhesuar

	Emertimi	Vendndodhja
1	Qendra pritese e viktimave te trafikut dhe femijeve te riadhesuar	Tirane (Linze)